



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 4 DHE 5 GUSHT 2016**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 04. I 05. AVGUSTA 2016. GODINE**

**GUSHT - AVGUST
2016**

Rendi i ditës

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme,
4. Votimi i raportit vjetor të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për vitin 2015,
5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-106 për ratifikimin e Marrëveshjes së kredisë ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe UniCredit Bank Austria AG për financimin e Projektit të modernizimit të shërbimeve të Kardiologjisë Invazive në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës,
6. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-104 për ratifikimin e Marrëveshjes përkitazi me themelimin e Fondit të Ballkanit Perëndimor,
7. Shqyrtimin i Projektligjit nr. 05/L-111 për ratifikimin e Marrëveshjes financiare ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Investime për Projektin e Rehabilitimit të Linjës Hekurudhore 10,
8. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-112 për ratifikimin e Marrëveshjes së garancisë ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për Projektin e Trafikut Urban,
9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 05/L-101 për performansën energjetike në ndërtesa,
10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 05/L-105 për mbrojtjen e fëmijës,
11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 05/L-087 për kundërvajtje,
12. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 05/L-050 për kinematografinë,
13. Shqyrtimi i dytë i Projektligji nr. 05/L-078 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-019 për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara,
14. Shqyrtimi i raportit vjetor të Qeverisë së Republikës së Kosovës për funksionimin e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm të Financave Publike në Sektorin Publik të Kosovës për vitin 2015,
15. Shqyrtimi i raportit të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për vitin 2015,
16. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 03/L-182 për mbrojtje nga dhuna në familje,
17. Propozimi i GP të PDK-së për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare.

Dnevni red

1. Vreme za izjašnjavanje van dnevnog reda,
2. Vreme za poslanička-skupštinska pitanja,
3. Usvajanje zapisnika sa prethodne sednice, 4. Glasanje o Izveštaju Centralne Banke Republike Kosova za 2015. godine,
5. Razmatranje Nacrta zakona o ratifikaciji Sporazuma o kreditu između Vlade Republike Kosova i Unicredit Bank Austria AG za finansiranje projekta modernizacije službi invazivne hirurgije KUCK-a, br. 05/L-106,
6. Razmatranje Nacrta zakona o ratifikaciji Sporazuma o osnivanju Fonda Zapadnog Balkana, br. 05/L-104,
7. Razmatranje Nacrt zakona br.05/L-111 o ratifikaciji Finansijskog Sporazuma između Vlade Republike Kosovo i Evropske Investicione Banke za Projekat rehabilitaciju železničke linije 10,
8. Razmatranje Nacrt zakona br.05/L-112 o ratifikaciji Sporazuma o garanciji između Republike Kosovo i Evropske banke za obnovu i razvoj za Projekat urbanog saobraćaja,
9. Prvo razmatranje Nacrta zakona br. 05/L-101 o energetske performansi u zgradama,
10. Prvo razmatranje Nacrta zakona br. 05/L-105 o zaštiti deteta,
11. Drugo razmatranje Nacrta zakona br. 05/L-087 o prekršajima,
12. Drugo razmatranje Nacrta zakona br. 05/L- 050 o kinematografiji,
13. Drugo razmatranje Nacrta zakona br. 05/L-078 o izmenama i dopunama Zakona br.03/L-019 o izmenama i dopunama Zakona br. 03/Z-019 o osposobljavanje profesionalno reosposoblavanje i zapošljavanju osoba sa ograničenim sposobnostima,
14. Razmatranje godišnjeg izveštaja Vlade Republike Kosova o funkcionisanju sistema unutrašnje kontrole javnih finansija u javnom sektoru Kosova za 2015.god,
15. Razmatranje izveštaja Kosovskog fonda penzijskih ušteda za 2015.god,
16. Razmatranje izveštaja Komisije za ljudska prava, rodnu ravnopravnost, nestala lica, i peticije o kontroli provedbe zakona o zaštiti od porodičnog nasilja, br. 03/L-182,
17. Predlog PG PDK o zameni članova u parlamentarnim komisijama.

Mbledhjen e drejtoi nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.

KRYESUESI: Të nderuar deputetë,
I hap punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës sipas rendit të ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 15 korrik 2016.

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Nuk është paraqitur askush. Atëherë paraqituni me dorë, Bislim Zogaj është paraqitur për fjalë. Në emër të grupit, a në emrin tënd?

BISLIM ZOGAJ: Flas në emrin tim.

I nderuar kryesues,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Dua të shpreh një shqetësim të rajonit të Drenasit që mendoj se është problem i tërë Kosovës, e në veçanti Drenasi me rrethinë. Është fjala për kompaninë “Ferronikeli”, i cili tash e 4 muaj ka ndërprerë prodhimin e xehes në Drenas dhe xehja transportohet në Kavadarc, në Shkup dhe nuk e di, pasi që disa herë thuhet që është taku menaxhmenti i kompanisë së “Ferronikelit” me Qeverinë, por deri më tani nuk kemi asgjë diçka konkrete dhe e dimë se menaxhmenti i “Ferronikelit” ka deklaruar se e kanë ndërprerë prodhimin në Drenas për shkak të çmimit. Unë besoj se nuk qëndron ajo, kur dihet se kompania neo-“Ferronikeli” transferon apo transporton xehen për në Kavadarc të Shkupit dhe sigurisht transportimi i kësaj xehe në Shkup vetëm sa e rrit koston e prodhimit.

Kështu që mendoj se kjo më shumë është diçka politike apo një problem i tyre, i kompanisë së “Ferronikelit” që e ka për qëllim ta mëkëmbë FEN-in e Kavadarcit, kurse “Ferronikelin” e Drenasit, si duket është një qëllim i caktuar që ata punëtorë të mbesim pa punë.

Prandaj, kërkoj nga Qeveria e Kosovës që të bëjë gjithçka që është e mundur që sa më parë të ndërmarrë diçka që të fillojë punën fabrika e “Ferronikelit” në Drenas.

Vetëm edhe një herë po e them, më mirë është tash të ndërmerret diçka, sepse ndoshta një ditë do të bëhet vonë, sepse tani ka ardhur pika e vlimit në rajonin e Drenasit, sepse, duke llogaritur edhe kompanitë nënkontraktuese, tani janë mbi 1 000 punëtorë të papunë.

Deri në fillim të këtij muaji punëtorët kanë pasur kontrata me 70% të pagës, kurse nga 1 gushti punëtorët janë pa kontrata.

Prandaj, kërkoj nga kabineti qeveritar që të marrë pasa sa më shpejt që të bëjë diçka apo gjithçka që është e mundur të fillojë prodhimi në shkretoren e “Ferronikelit” në Drenas.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Albin Kurti.

ALBIN KURTI: Deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Me Marrëveshjen e demarkacionit me Malin e Zi, të nënshkruar nga tash i ashtuquajtimi president Thaçi, aso kohe ministër i Punëve të Jashtme, me Malin e Zi më 26 gusht të vitit të kaluar praktikisht shpallet që Kosova nuk ka kufij, e kur nuk ke kufij, atëherë nuk ke as territor, e kur nuk ke territor, atëherë nuk ke shtet, e kur nuk ke shtet, atëherë nuk je qytetar, e kur s'je qytetar, atëherë bëhesh refugjat. Edhe refugjati qëndron në një parcelë tokësore, mirëpo ai nuk ka të drejta, refugjati është në tendë e me valixhe në dorë.

Pra, me Marrëveshjen e demarkacionit me Malin e Zi ne po vulosemi si një vend i cili s'ka kufij, e rrjedhimisht nuk ka as territor dhe pretendimet e fqinjëve ndaj nesh legjitimohen, me ç' rast ne, me të ashtuquajturit libra apo dokumentacion kadastral, duhet ta dëshmojmë se Kosova na qenka e jona.

Mirëpo, një pjesë e mirë e qytetarëve të Republikës së Kosovës, posaçërisht e shqiptarëve si popullsi, shumicë nuk i kanë librat kadastralë as për shtëpitë e për arrat e veta, e lere më për prona publike e shtetërore, për bjeshkë, për lumenj, për shtretër të lumenjve e për maja të larta të vargmaleve tona.

Kjo marrëveshje e Thaçit dhe e Hysenit me homologët e tyre malazezë është marrëveshje e kapitullimit, pas një lufte të humbur, ku ne jemi palë e mundur.

Pala fituese gjithmonë me një betejë, në një luftë, e merr kurrizin e vargmaleve, i merr kuotat e larta strategjike ushtarake dhe, pala e mundur zmbropset në brendi, bie në luginë dhe ndodhet në mëshirën e atyre që i morën majat e maleve.

Në këto vitet e fundit, pra deputetë të Kuvendit të Kosovës, ka ndodhur një luftë në bjeshkët e Rugovës. Unë di që asnjëri prej jush nuk ka dëgjuar për atë luftë, mirëpo ne tash e kemi marrëveshjen e kapitullimit të asaj lufte, për të cilën nuk kemi dëgjuar që ka ndodhur. Kjo marrëveshje është marrëveshje kapitullimi, nuk mund të shkruhet, të lexohet, të kuptohet e të përjetohet ndryshe.

Pra, paska pasur një luftë në bjeshkët e Rugovës, në të cilën ne qenkemi mundur nga Mali i Zi dhe...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: A e ke në emër të grupit? Ok-ej! Edhe dy minuta!

ALBIN KURTI: Paska ndodhur një luftë në bjeshkët e Rugovës dhe tash ky kryetari i Komisionit Shtetëror, bashkë me Thaçin, Veselin, Mustafën dhe Hysenin, neve na e sollën kapitullimin.

Pra, ne po e shohim pasojën e luftës, të cilën nuk e paskemi parë.

Kuvendi i Republikës së Kosovës së shpejti do të ftohet që ta bëjë legjitimimin e këtij akti të tradhtisë dhe këtij krimi të pashembullt në Kosovën pa shpalljes së pavarësisë. Pra, është edhe

tradhti, është edhe krim. Ndërkaq prej juve pritet që ta bëni legjitimimin, me fjalë të tjera, ta zhbëni krimin e këtyre personave.

Konferenca e djeshme e ka vërtetuar, e ka dëshmuar, e ka konfirmuar që qytetarët e Republikës së Kosovës që e kanë nënshkruar peticionin dhe posaçërisht ekspertët të cilët kanë folur dhe, opozita në përgjithësi, kanë pasur të drejtë në kundërshtimin e kësaj marrëveshjeje. Ne jemi pro demarkacionin e kufirit me Malin e Zi, mirëpo jo për këtë demarkacion. Dhe NATO-ja nuk na mbron neve prej Malit të Zi, NATO-ja na mbron prej Rusisë. Nëse ne duhet ta mbrojmë vendin tonë prej Malit të Zi, këtë duhet ta bëjmë ne. Nëse na sulmon Rusia, na mbron NATO-ja, po ndaj Malit të Zi s'na mbron NATO. Këtë duhet ta bëjmë vetë ne.

Dhe, krejt në fund, dua të protestoj, të kundërshtoj ashpër keqpërdorimin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, sepse po thuhet që na tha ambasadori, rrjedhimisht ne vetëm duhet t'ia bëjmë aminin deklaratës së tij. Mirëpo, këtë punë duhet ta shohim pak më thellë.

Unë jam i bindur që Qeveria e Republikës së Kosovës i do Shtetet e Bashkuara të Amerikës, edhe opozita dhe posaçërisht Lëvizja “Vetëvendosje” i duan Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Çështja është cilën Amerikë e doni? A e doni Amerikën e Frenklin Delano Rusveltit edhe Martin Luter Kingut, a e doni Amerikën...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Slavko Simiq. Kur të doni, thirrni debat, mund të thirrni debat, Albin, për të gjithë njësoj. Ti mundesh pa mikrofon, po fjalën e ke kryer sipas rregullores, ke mundur të vish dhe. Slavko Simiq e ka fjalën.

SLAVKO SIMIĆ: Uvaženi predsedavajući!

Poštovani narodnih poslanici,

U svojstvu šefa poslaničkog kluba Srpske liste želim da vas izvestim da je Parlamentarna grupa samnom na čelu u toku povesnoj zasjedanja Skupštine osećala potrebu da kao legalno izabrani parlamentarni predstavnici građana posetimo opštine na Kosovu kojima žive Srbi.

I o neposrednim razgovorima sa lokalnim predstavnicima vlasti i građana informišemo o njihovim potrebama i da se informišemo njihovim problemima.

S obzirom da je Parlamentarna grupa sastavni deo zakonodavne vlasti koje aktivno učestvuje u krijeranu zakonskih akata i nazire rad Vlade i ostalih javnih institucija, fokusiralismo na probleme koje možemo rešavati samostalnih i direktnim zalaganjem, a ko se tiču svih naših građana.

I ako smo u samom početku, odnosno u početnom fazi posećivali opštine sa srpskom većinom treba istaći da smo usred produktivni sastanaka o pozivanja predstavnika lokalne vlasti u koji Sebi čine znatnu manjinu.

Želim da naglasim da su posete rezultirale značajnim odzivom i podrškom građana, predstavnika lokalne vlasti, a takođe značajnu podršku dobili smo i od predstavnika međunarodne zajednice.

Identifikovanje ključnih problema koji utiču na kvalitet života građana u opštinama sa Srpskom većinom, odnosno opštinama o kojima su u znatnoj manjini kao cilj koji smo postavili pred sobom u potpunosti je ispunjen.

Sprovođenjem navedenih poseta kog građana stvorio se i stvara se osećaj da su legitimno izabrali predstavnici parlamenta da kod njih postoji volja i da kod njih postoji želja i odlučnost za rešavanje problema koji fundamentalno utiču na kvalitet života srpske i ostale manjinske zajednice

Identifikovali smo da je i pored određenih lokalno infrastrukturne problema, permanentno se navaljuju i ponavljaju problemi bez obzir da li se radi o opštinama u kojima Srbi čine većinu ili je reč opštinama u kojoj su Srbi u znatnoj manjini.

Slobodno mogu da kažem ispred Parlamentarne grupe Srpske liste da smo identifikovali nekoliko ključnih problema, koji smo prilikom poseta opštinama uočili.

Neke od tih problema su standardnih u našem društvu na Kosovu, ali ja bih izdvojilo neke od problema, to je nezaposlenost, koji je prouzrokovana o nepoštovanjem i ignorisanjem zakonskog okvira od 10% od ukupnog broja zaposlenih u organima lokalnih vlasti, a koji su rezervisano za manjinske zajednice, uzurpacija imovine, neefikasni pravni sistem bezbednost, budžetsko finansiranje na lokalnom nivou i nepoštovanje prava na upotrebu jezika i pisma.

U okolnostima koje vladaju na Kosovu, a koje se odlikuju nepovoljnim pravno ekonomskim ambijentom preduzeta aktivnost poslaničkog kluba Srpske liste predstavlja do sada neophodan iskorak ka rešavanju problema koji značajno utiču na kvalitet života srpske zajednice.

Želim da naglasim takođe da je poslanički klub u toku povesnoj zasjedanja i pored svojih obaveza i delokruga posla koja ima u Skupštini Kosova, obišao čak 14 opština u kojima žive Srbi, odnosno sredine u kojima Srbi su manjina, i učestvuju u lokalnim organima vlasti.

Posete su glavno organizovane u onim opštinama koje su potvrdile zahtev za prijem poslanika, tako su posete sa veoma korektnim i dobrim prijemom održane u opštinama Ranilug, Novog Brdo, Peć, Gračanica, Đakovica, Leposavić, Priština, Parteš, Klokot, Obilić, Vučitrn, Istog i u selima Velika Hodža i Goraždevac.

Želim da na kraju da ne bio elaborao ceo ovaj izveštaj koji je začinila poslanička klub Srpske liste, želim da se zahvalim svim gradonačelnicama i predstavnicima lokalne samouprave na prijemu i na zaradi, i nadam se da u buduće unaprediti saradnju sa opštinama koji smo posetili i unapredićemo sigurno saradnju u opština kojima nismo bili.

Takođe želim da informišem i poslanike javnost da će Poslanički klub Srpske liste dostaviti svima zvanično dokument i poslanicima, i sredstvima javnim informisanja, inače ovaj izveštaj začinio poslanici Poslaničkog kluba Srpske liste. Zahvaljujem!

KRYESUESI: Zonja Shinik e ka fjalën.

MÜFERA ŞINIK: Faleminderit, kryesues!

Përshëndetje,

Herkese sajglar sunijorum.

Bu günlere kadar gelebilmek için, çok zor dönemlerden geçen ülkemiz Kosova Cumhuriyetinin savaş öncesi, savaş döneminde ve bugüne kadar daima yanımızda olan dost ve kardeş olan Türkiye Cumhuriyetidir.

Beklentisi olmadan karşılıksız desteklerini sunan Türkiye Cumhuriyetinin Kosova'ya sunmuş oldukları desyeklerin birkaçını saymak gerekirse

Kosova'daki Nato müdahalesinin en son verimli atagını yapan yiğit Türk Piloylarıydı.

Türk askerinin konuşlandırılmasıyla savaş sonrası güvenlik sağlandı.

Kosova'nın Bağımsızlığını tanıyan ilk ülkeler arasında olarak tanınması doğrultusunda da yaptığı lobicilik çoktur.

Kosova Güvenlik Güçlerine yüksek miktarda maddi destek sunması, eğitim vermesi.

İKA'nın Kosovadaki kuruluşundan yani 2004 yılından bu yana 500-ün üzerinde Projesi,

Kosova Polisine eğitimi, maddi manevi destek sunması,

Kosova Anayasa Mahkemesine yapılan direkt destekler,

iki ülke arası Sağlık Bakanlıkları arasında yapılan anlaşmayla Kosova'lı hastaların tedavi edilmesi 1992 yılından bu yana Arnavut, Türk Boşnak olmak üzere Kosova'lı öğrencilerin Lisans ve Lisans üstü eğitimleri,

Kosova İslam birliğine her konuda % 100 desteği,

Kardeş Belediyeler Projesi çerçevesinde yapılan sayısız destekler,

Türkiye'deki Kosova'lı Derneklerin destekleriyle 600 yıllık ortak kültürümüzü paylaştığımız ve yaşattığımız bir ülkedir,

Son aylarda Türkiyede yaşanan olaylara Kosova kurum ve kuruluşlarının sessiz kalması göze batarken iki ülke arası var olan kardeşlik ve dostluğu karartmak amacıyla son zamanlarda Türkiye Cumhuriyeti'ndeki terör saldırılarını ve darbe girişimini şaka konusu edinen ve terörü teşvik etmeye çalışan Kosova'lı sözde gazeteci ve destekçilerinin davranışlarını kınıyoruz.

Bu tarz davranışları hak etmeyen dost ve kardeş ülke Türkiye Cumhuriyeti ile dostluğumuzun zarar görmesini istemeyen bir Kosova halkı var.

Kişi ve bazı kişilerin iki ülke arası, dostluğun bozulmasını istese de, ne Kosova Halkı ne de Türk Milleti buna izin vermeyecektir.

Türkiye Büyük Millet Meclisi ve Kosova Cumhuriyeti Meclisi Parlamentolar arası dostluk gurubu başkan yardımcısı olarak 6 artı PG adına yaptığım konuşmayı dostluk Grubu Başkanlığını gönüllü üstlenen LDK PG bir Milletvekilinin yapmasını bekliyoruz.

6 artı PG adına bir daha ne Türkiye Cumhuriyetinde ne de başka bir ülkede terörün böyle acı günlerin yaşanmamasını temenni eder, Türkiye Cumhuriyetinin Kosova'ya her konuda desteğinin olacağını teyit eder saygılar sunarım...

KRYESUESI: Fjalën e ka zoti Hajdar Beqa.

HAJDAR BEQA: Faleminderit, kryesues i Parlamentit të Republikës së Kosovës!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Sot do ta ngre një çështje, e cila është shqetësim i shumë qytetarëve të Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës, të cilët jetojnë nga viti 2001 në Republikën e Kosovës.

Si pasojë e gjendjes së rëndë ekonomike dhe presionit intensiv policor dhe ushtarak nga pushteti serb, nga ky presion i është imponuar të jetojnë në Republikën e Kosovës, duke braktisur vendlindjen e tyre dhe trojet e tyre.

Ata në Kosovë për shkak të mosparaqitjes me kohën e institucione gjegjëse nuk kanë arritur të pajisen me dokumente identifikimi, të cilat duhet ta gëzojnë të drejtën e dy shtetësisë, e cila në vazhdimësi po i pengon në integrimin dhe jetësimin e të drejtave të tyre elementare.

Ligji Nr. 04/L-215 e rregullon formimin se si fitohet shtetësia e Kosovës, andaj propozoj nga Ministria e Punëve të Brendshme, në këtë rast të iniciohet plotësim ndryshimi i këtij ligji dhe të parashihet mënyra e fitimit të shtetësisë së Kosovës nga shtetasit e Kosovës Lindore, të cilët e dëshmojnë qëndrimin në Republikën e Kosovës pas vitit 1999.

Si dëshmi për banimin e tyre në Republikën e Kosovës mund të merren parasysh regjistrat nga shpërngulja e tyre, përmes certifikatave të vendbanimit, dëshmitarëve nga lagjja ku jetojnë, regjistrimi i fëmijëve në shkollat fillore, në shkollat e mesme apo përfundimi i arsimit të lartë në institucionet e arsimit në Republikën e Kosovës. Kjo e drejtë e tyre duhet t'u mundësohet, sepse de fakto të gjithë këta shtetas nga këto treva i plotësojnë kushtet për të fituar shtetësinë e Kosovës, sepse jetojnë mbi 15 vjet në Kosovë.

Fakti se këta qytetarë nuk posedojnë shtetësinë e Kosovës i pengon vazhdimisht në qarkullimin e tyre, punësimin, shkollimin, marrjen e bursave dhe zhvillimin e një jete normale në shoqërinë tonë.

Krejt në fund, t'u ndihmojmë këtyre qytetarëve në integrimin e tyre deri të vijnë ditët më të mira që këta të kthehen në trojet e tyre dhe në vendin e tyre. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Konjufca e ka fjalën.

GLAUK KONJUFCA: Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Këtë javë qytetarët ishin dëshmitarë të një sërë përgjimesh tronditëse që tregojnë për skemën e kapjes së shtetit tonë.

Shefi e shefave, Adem Grabovci, është dora e zgjatur e Hashim Thaçit dhe e Kadri Veselit, të cilët janë trekëndëshi kryesor që Republikën e Kosovës e kanë kthyer në plaçkë dhe në pushtet personal.

Nëse je piun i Adem Grabovcit dhe shërbëtor i tij, mos ke gajle, se edhe punë do të gjesh gjithqysh. S'ka lidhe a ke konkurruar, edhe nëse nuk ke konkurruar, pa e ditur ti hiç, shefi i shefave të futë në konkurs. Nuk ka lidhje edhe nëse je në rend i 15-ti. Nuk është me rëndësi as a di, as a nuk di, as a je profesionalist, edhe nëse je i fundit, do të dalësh i pari.

Nuk është nevoja, bile, as ta dish ku duhet të punosh, nuk është e thënë as t'ia dish emrin institucionit ku do të punosh. Po pse t'ia dish? S'ka nevojë. E di shefi i shefave, sepse aty ka më shumë nevojë partia. Ai e di se në cilën agjenci të pavarur do të punosh, sepse kështu i kontrollon ato përmes sejmeneve që i rehaton vetë.

Adem Grabovci të bën edhe prokuror të shtetit po deshi, Adem Grabovci që e rregullon drejtësinë, me fjalë të tjera, e kënaq krejt. Këta njerëz e kanë kthyer Republikën e të gjithëve në pushtet të disave dhe për përfitime të pak njerëzve. Ky shtet aktual është privatizuar nga klani "Pronto", këta njerëz bëjnë çka të duan përtej ligjeve, përtej Kushtetutës, përtej të gjithave. Por, të njëjtën kohë janë në krye të korit politik që për çdo ditë na flasin për demokracinë, për sundimin e ligjit, për drejtësinë e pavarur, për ndarjen e pushteteve, për miqësinë me Amerikën, për integrimet evropiane dhe për zhvillimin ekonomik të Kosovës.

Njëherë zoti Veseli, që është kryetar i Parlamentit, pati thënë që gjithçka që keni për neve fakte dhe dyshime dërgoni te prokurori. Te cili prokuror të dërgohen? Te Bahri Hyseni a? Dërgimii fakteve për juve te Bahri Hyseni është sikur taqosh "çjapin te kasapi". Ju e keni paralizuar çfarëdo mundësie për ndryshim demokratik në këtë vend, ju e keni pamundësuar demokracinë dhe drejtësinë. Prandaj, ju kisha këshilluar, të mos flini të qetë!

KRYESUESI: Fjalën e ka zoti Gëzim Kelmendi.

GËZIM KELMENDI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Deputetë të nderuar,

Vërtet është mjaft e rëndë, skandaloze dhe e turpshme ky nxitim, kjo ngutje e Qeverisë që ta procedojë ratifikimin e Marrëveshjes së demarkacionit me Malin e Zi në Kuvendin e Kosovës, edhe më të rëndë e bën fakti se mbledhja e Qeverisë është thirrur mbrëmë ende pa përfunduar debati shkencor që ishte thirrur dhe lidhur me këtë proces të demarkacionit.

Prandaj, këtu nuk lë shumë për të menduar se debati i thirrur dhe nuk ka pasur kurrfarë peshe relevante për Qeverinë e Kosovës. E rëndësishme ishte që ajo marrëveshje të ratifikohet sa më shpejt në Kuvendin e Kosovës. Pa dashur të hyj në detaje, pasi nuk dua t'ju marr as juve kohë në detajet e debatit, u vërtetua dhe se Komisioni Shtetëror, i emëruar nga Qeveria e Kosovës, në mandatin e kaluar jo vetëm që i ka shkelur kompetencat e veta, por ka bërë një dëm shumë të pariparueshëm për Kosovën, ngase ka ricaktuar kufij, do të thotë sipas Komisionit Shtetëror Kosova s'ka pasur kufi, edhe nuk di si është njohur edhe si shtet, kjo e ka zbehur edhe shtetësinë e Kosovës.

Aq më e rëndë është kur edhe liderët shtetërorë vendorë kosovarë bëjnë presion se duhet të ratifikohet kjo marrëveshje me të vetmen arsye se duhet të shpejtohet procesi i liberalizimit të vizave. Ne ende nuk e kemi dëgjuar asnjë zyrtar të Bashkimit Evropian që zyrtarisht ka

kushtëzuar ratifikimin e marrëveshjes së demarkacionit me liberalizimin e vizave. Bile- bile zyrtarë të Bashkimit Evropian e kanë pohuar se Kosova në raport me disa vende të tjera të rajonit ka më shumë kërkesa për liberalizim të vizave, duhet të plotësojë më shumë kërkesa se vendet e tjera.

Në anën tjetër, kemi kërkesën e vazhdueshme për çdo vit në mënyrë të rregullt nga Komisioni Evropian, ku shqetësim kryesor për anëtarësimin e Kosovës në Bashkimin Evropian dhe liberalizim të vizave është shkalla e lartë e krimit të organizuar dhe korrupsionit dhe politizimi i drejtësisë kosovare. Prandaj, nuk është procesi i demarkacionit, por është krimi i organizuar dhe korrupsioni. Unë mendoj se nuk duhet ky proces i ratifikimit të kësaj marrëveshjeje të vijë në Kuvend, për faktin se ne si deputetë të Kuvendit të Kosovës nuk kemi përvojë të mirë me disa nga deputetët edhe në të kaluarën, edhe në një tashme të afërt. E kemi parasysh edhe faktin e presionit të madh që ushtrohet mbi deputetë, ka pasur raste shumë të rënda kur deputetët e kanë shitur votën e tyre për pozita ministore apo diplomatike si ambasadorë.

Prandaj, nuk përjashtohen të gjitha këto kalkulime, vetëm e vetëm që të ratifikohet kjo marrëveshje. Në anën tjetër, kemi edhe paralajmërimet e disa nga partive opozitare për protesta, të cilat mund të eskalojnë në dhunë dhe askush nga ne nuk ka dëshirë të shohë skenë të dhunës. Prandaj, Qeveria e Kosovës duhet të marrë një veprim burrëror dhe ta pranojë gabimin e Komisionit Shtetëror. Të gjithë jemi njerëz, të gjithë gabojmë dhe shumë më mirë dhe shumë më burrërore është që ta pranosh gabimin, se sa t'ia bësh këtë dëm, këtë tradhti vendit tonë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Adem Grabovci e ka fjalën.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, i nderuar kryesues, nënkryetar i Parlamentit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Kabinet qeverisës,

Qytetarë të dashur të Republikës së Kosovës!

Ju dhe unë tash posa e dëgjuam ripërthypjen, lirisht po them, të një incizimi që ka ndodhur në vitin 2011, që ka qenë pjesë e një hetimi të iniciuar, të udhëhequr nga prokuroria e EULEX-it, por një proces i cili është hetuar për vite me radhë dhe që ka përfunduar me një mbyllje në mungesë të provave. Edhe atëherë, edhe sot dhe gjithnjë jam deklaruar, e deklaroj se jam i gatshëm t'i përgjigjem në çdo kohë drejtësisë, respektoj shtetin tim, respektoj institucionet e mia, respektoj ligjet dhe kurrë nuk kam tentuar të dal mbi ligjin.

Mirëpo, gjithashtu jam shumë i vetëdijshëm edhe përgjegjës për përgjegjësitë e mia. Nëse është vepër penale, nëse është krim për të kontribuar për të hapur vende të punës, për të punësuar njerëz, unë atëherë kërkoj nga drejtësia: ja ku jam, edhe unë jam i gatshëm të përgjigjem. Të gjithë ne këtu pa përjashtim kemi marrë obligim dhe jemi bërë deputetë duke i premtuar elektoratit tonë, votuesve tanë hapje të vendeve të reja të punës dhe punësim.

Nëse është vepër penale pse unë kam lobuar për të kaluar ligjet, pse unë komunikoj me kolegët deputetë, bëj përpjekje të jap sqarime aty ku ka nevojë të sqarohet për votimin e një ligji apo mosvotimin e një ligji. Unë e them me përgjegjësi të plotë, ndihem shumë mirë që kam

kontribuar për të kaluar Ligji edhe i Hoçës, edhe i Prizrenit, edhe Gjykata Speciale, edhe vazhdimi i mandatit të EULEX-it dhe shumë e shumë të tjera, edhe atëherë kur këtu para jush, para qytetarëve të Republikës së Kosovës kam deklaruar hapur se janë në kundërshtim, nuk janë të drejta, por megjithatë janë në përputhje me interesin e qytetarëve të Republikës së Kosovës, janë në përputhje të plotë me fuqizimin, konsolidimin e shtetit të Kosovës.

Ju lutem, nëse dikush mund të gjejë, jo vetëm ju këtu, por edhe çdo qytetar i Republikës së Kosovës...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Në emër të Grupit e ka Ademi, po thotë.

ADEM GRABOVCI: Dhe ju bëj thirrje edhe juve, edhe qytetarëve, edhe organeve të drejtësisë le të fillojë hetimi që nga unë këtu, unë të jem objekt i hetimit, i trajtimit dhe aty ku konstatohet se kam bërë një shkelje më të vogël, që kam dëmtuar interesat e qytetarëve të Republikës së Kosovës vetëm me një veprim të mundshëm, unë jam i gatshëm të jap përgjegjësi para jush, para qytetarëve dhe para institucioneve të shtetit tim të dashur.

E di se jam fajtor vetëm për një arsye, edhe unë edhe familja ime, edhe prindërit e mi, edhe gjyshërit e mi, sepse vetëm një krim në këtë jetë e kemi bërë: se kurrë nuk jemi pajtuar me padrejtësitë që i janë bërë popullit tim dhe në vazhdimësi kemi dhënë një kontribut të paçmuar për të fituar lirinë e Republikës së Kosovës, gjë që krenohem me gjakun e familjes, të shokëve, të miqve që kanë dhënë për të arritur deri këtu.

Unë vetëm një pyetje kam për kolegun tim të nderuar që megjithatë unë e respektoj, Glauk Konjufca, kur ishim në Bruksel dhe pikërisht me këto incizime ishte shumë njerëzor, kishte një vlerësim shumë korrekt, e vlerësoi se është një shkelje e privatësisë në Bruksel para shumë kolegëve të tjerë. E dënonte atë dhe e quante vërtet një vlerësim shumë korrekt se me këtë veprim po rrezikohet siguria e qytetarëve të Republikës së Kosovës. Unë po e them me sinqeritetin më të madh, nuk më shqetëson fakti se rrezikohet Adem Grabovci, familja e Adem Grabovcit, se jemi apo mos jemi Adem Grabovci është përballë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Fjalën e ka Fikrim Damka.

FIKRIM DAMKA: I nderuar kryetar dhe anëtarë të Kryesisë,
Të nderuar deputetë!

Besoj që shumica prej nesh pajtohem me faktin që deri më tani nuk është gjetur ndonjë sistem që mund të zëvendësojë demokracinë pluraliste. Ashtu që për shumicën prej nesh e vetmja rrugë është mbrojtja e demokracisë dhe të vlerave demokratike në vend.

Dua të veçoj vetëm dy gjëra që përmbajnë elemente të rëndësishme për një sistem demokratik. E para është “liria e shprehjes”, e dyta është “parandalimi i lirisë së fyerjes, shpifjes dhe gjuhës së urrejtjes”. Në sistemet demokratike ku sundon ligji, mekanizmat e drejtësisë janë ata që e

konstaton se çfarë është kufiri i lirisë së shprehjes, si dhe në disa raste bëjnë edhe kufizime dhe parandalime, sidomos kundër dukurive që i shërbejnë nxitjes së urrejtjes dhe ekstremizmit në vend.

Prokuroritë e shteteve demokratike urgjentisht veprojnë në raste kur liria e shprehjes keqpërdoret me qëllim të krijimit të opinionit dhe perceptimit që dëmton klimën demokratike. Në vendet demokratike sanksionohen fyerjet, shpifjet dhe dukuritë e tjera që krijojnë përshtypjet negative ndaj individëve dhe grupeve të ndryshme. Sidomos, më së shumti sanksionohen qëndrimet fundamentaliste që bëhen nën maskën e lirisë së shprehjes, por në fakt që ndikojnë në prishjen e harmonisë shoqërore dhe kontribuojnë në krijimin e ekstremeve në shoqëri, me fjalët e tjera e polarizojnë shoqërinë.

Fatkeqësisht në Kosovë ekziston liria e kërcënimit dhe fyerjes në bazë etnie, fetare etj. Në Kosovë një figurë publike ka të drejtë që në mbledhjen e 21 qershorit të këtij viti, pas ndeshjes së futbollit ndërmjet Turqisë dhe Çekisë të postojë mesazhe kërcënuese ndaj komunitetit turk, t'u bëjë atyre thirrje që të mos festojnë fitoren e Turqisë, përndryshe, sipas tij, "shqiptarët janë nervozë dhe ata nuk i marrin përsipër pasojat e veprimeve të tyre". Kam shfletosur fjalorin e termave juridike në gjuhën shqipe dhe e pashë që kurrkund "kërcënime me baze etnike" nuk konsiderohet si "sarkazëm".

Me mosangazhimin në raste të tilla, Prokuroria në Kosovë lejon që "nxitja e urrejtjes" të konsiderohet si "liri e shprehjes". Duket se Prokuroria, për shkak të mbingarkesës që e ka në luftën kundër korrupsionit, kundër kërcënimeve ndaj afaristëve të huaj dhe të dukurive të tjera negative nuk gjen kohë për të vepruar në raste të gjuhës së urrejtjes.

Të nderuar deputetë!

Përveç sundimit të ligjit, një prej komponentëve të rëndësishëm në demokraci është edhe përvetësimi i vlerave të demokracisë, sidomos respektimi i të zgjedhurve të popullit. Por, qasja ndaj problemeve në Turqi të disa aktorëve në Kosovë, si një vend mik dhe partner, më ka shqetësuar shumë.

Ju lutem, merrini parasysh këto gjëra:

- Tentimi i puçit në Turqi është sulm ndaj vlerave të demokracisë. Në dinamikat e ditës së sotme një tentim të tillë nuk ka pasur gjasa që të arrijë qëllimin. Fatmirësisht...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Koha për debat është shteruar, kemi kaluar nja 4-5 minuta më shumë, kështu që po vazhdojmë me rendin e ditës siç e kemi në Rregullore.

Lidhur me një çështje, ministri i Kulturës e ka kërkuar fjalën, zoti Kujtim Shala e ke fjalën, por ta kesh parasysh që deputetët kanë të drejtë në replikë në fjalën tënde. A, nuk e ke kohën ende, por po ta mundësojmë.

MINISTRI KUJTIM SHALA: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

E kam fjalën për pikën e 12-të të rendit të ditës për Ligjin për kinematografinë.

Meqë një pjesë e mirë e njerëzve të fushës së kinematografisë mendojnë që ne ende mund të punojmë që ligji të përmirësohet dhe të jetë më i dobishëm, unë tërheq Projektligjin për kinematografinë. Faleminderit!

KRYESUESI: Atëherë, është e drejtë e Qeverisë ta tërheqë ligjin, me një ngritje formale dore besoj që e miratojmë. Në rregull! Nuk mund t'ia ndal, ani e vazhdojmë, Naiti e ka fjalën.

NAIT HASANI: Faleminderit, nënkryetar!

E përshëndes ministrin për veprimin e guximshëm dhe veç dua t'ia tregoj ministrit ligjin që e ka sjellë, edhe ndryshimet që janë bërë, edhe që ka kërkuar vetë ministri me prezencën e tij, me pyetjet e tij sa herë ka ardhur këtu e kemi pyetur cilat janë kërkesat tuaja brenda projektligjit. Gjithherë ka thënë që çfarë ju miratoni, ne jemi ok.

Tash, unë kam kërkesën e artistëve që e kanë sjellë dhe këta thonë se nuk po pajtohen dhe kërkojnë ta tërheqim ligjin për arsye se në nenin 3, pika 1.7 që unë e lexoj e që ne nuk kemi ndryshuar asgjë brenda projektligjit, të cilin e ka sjellë ministri. Në nenin 51 ministri thotë “ne kërkojmë projektligj”. Pika 3, me gjobë që kërkojnë ta sqarojë, pika 3 thotë “personi fizik ose juridik që e njeh kinemanë, ndryshon qëllimin e veprimtarisë së kinemasë, siç është përcaktuar në nenin 47 të projektligjit”. Këto janë rregulloret e brendshme të Ministrisë për gjobat që Ministria i ka brenda, ne nuk i kemi futur këto, ministria i ka nxjerrë.

Domethënë, ministria vetë i ka bërë gjobat dhe vetë tërhiqet para njerëzve të papërgjegjshëm. Pika tjetër që është këtu, po ashtu është neni 14, që i kam nënvizuar të gjithat t'ia them ministrit, le ta dijë opinionin, le ta dinë të gjithë për çka po tërhiqet projektligji. Unë i them që ministri po gabon në këtë drejtim, është dorëzuar para njerëzve të papërgjegjshëm, me këtë ministri, njëkohësisht zëvendëskryeministri, kjo është më e rëndësishme, edhe më e rëndë, tërheqja e projektligjit e formalizon krimin dhe korrupsionin.

Për mua dhe ata që kemi pasur dilema, ka qenë një nga dilemat neni 52, ku është kërkuar për çështjen e pronësisë së “Kosova Filmit” dhe ajo çështje e pronësisë është rregulluar, ashtu në marrëveshje me të gjithë dhe është votuar në mënyrë unanime nga komisioni, ndërsa ministri po kërkon përsëri ta ndryshojë.

Prandaj, në të gjitha këto pika të këtij projektligji që ata thonë ky ligj, neni 24, në lidhje me zgjedhjen e QKK-së ka paragjykime. Asnjë paragraf nuk kemi prekur, asnjë presje nuk e kemi prekur pikërisht nga ministria që e ka sjellë projektligjin. Ata neve na drejtohen, përkundrazi ministria është pajtuar. Ndërsa, Arben Zharku vjen në Kuvend para ministrit e thotë që “ky ligj ka ardhur kontrabandë”, është drejtor i QKK-së.

Unë e kam, fituesit e mjeteve...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Në rregull, Nait! Shiko, ne e votuam dhe ky ka të drejtë ta tërheqë ligjin kur të dojë. Nuk është hapur debat, i ke dy minuta të flasësh me Rregullore. E kreve, po ta jap edhe një minutë dhe përfundoje, a bën?

NAIT HASANI: Jo, jo, nuk bën!

KRYESUESI: Po, tash Rregullorja, unë nëse do, shkojmë, dalim e flasim sa duam.

NAIT HASANI: Mjetet e fituara të subvencionuara nga mashtruesit, që 90% me emra dhe mbiemra i kam këtu, 29 persona, të cilët kanë përfituar nga ministria, të cilët nuk e kanë asnjë projekt të përmbyllur ose kanë filluar, ose i kanë keqpërdorur edhe ata janë ende nënshkrues të cilët kërkojnë ta tërheqin.

Ministri me veprimin e vet e ka funksionalizuar krimin dhe korrupsionin në QKK. Është zëvendëskryeministër, e kjo i bie që Qeveria po e finalizon dhe po kërkon ta financojë krimin dhe korrupsionin. Faleminderit!

KRYESUESI: Të lutem, Nait! Ju ose ne të gjithë si deputetë, komisionet e kanë atë detyrë të shikojnë çfarë po ndodh në Qeveri, çka po ndodh kudo dhe kemi të drejtën ta thërrasim ministrin në interpelancë kur duam, edhe në debat për të gjitha çështjet. Është më mirë, në qoftë se ka argumente dikush ose edhe ti, të thirret ministri, janë rregullat kur thirret ministri, të mos hapim debat tash të papërgatitur të gjithë.

Ne e miratuam tërheqjen e ligjit, ti mundtë flasësh dy fjalë, meqenëse edhe Naiti e shkeli Rregulloren pak, ose unë ia mundësova ta shkelë.

MINISTRI KUJTIM SHALA: Faleminderit! Po, vërtet s'ka objekt, sepse e tërhoqa por u kthye në debat, vërtet versioni që ka ardhur në leximin e dytë s'është versioni burimor dhe unë për këtë arsye e tërheq. Unë s'desha të hap debat, janë së paku tri nene problematike, janë tri nene të cilat hapin mundësi për keqpërdorim dhe shpërdorime, përfshirë dhe ndryshimin e statutarit, pronarit të pronës së "Kosova Filmit".

Unë këtë s'e lejoj në asnjë rast. Çka kam thënë unë në komisionin përkatës janë të regjistruara, janë saktësisht të kundërta me atë që thotë zoti Hasani.

Tani për çështjen e QKK-së, nëse zoti Hasani ka prova për keqpërdorime të fondeve publike, sepse ato janë fonde publike dhe s'i dërgon në prokurori, kjo përbën vepër penale në vete. Duhet ta kesh parasysh.

KRYESUESI: Faleminderit! Naiti, kundër-replikë dhe e mbyllim një minutë.

NAIT HASANI: Për çështjen e "Kosova Filmit" jemi dakorduar ta zgjidhim si të kërkojnë deputetët, komisioni dhe e kemi zgjidhur. Për çështjen e zgjedhjes së drejtorit të QKK-së nuk e kemi bërë asnjë presje ndryshim.

Ndërsa për financimin, janë dokumentet, ku kanë shkruar të gjitha gazetatat për keqpërdorime. Ndërsa, për që ka ardhur ligji kontrabandë, po më vjen mirë që ministri po e pranon. Ministri po e pranon që në Kuvend ligji ka ardhur kontrabandë, domethënë ka ardhur jo ai që e ka dërguar ministri në Qeveri. Nëse ka ardhur ligji nga jo ai që e ka dërguar në Qeveri, kjo do të thotë që ligji ka ardhur kontrabandë në Kuvend, po më vjen keq që edhe Qeveria po kontrabandon ligje.

KRYESUESI: Faleminderit! Kalojmë në pikën e dytë, këtu është miratuar, pika 12 e rendit të ditës hiqet nga rendi i ditës.

2. Koha për pyetje parlamentare

Unë e bëra një lapsus, meqenëse e bëra lapsusin, u miratua dhe nuk kishte ndonjë problem. E kemi pikën e tretë të rendit të ditës kur flasim për çështje të rendit të ditës që flasim.

Kemi 11 pyetje parlamentare. Raif Qela, pyetje për kryeministrin Isa Mustafa. Kryeministri nuk është këtu po më duket, a do ta bësh pyetjen?

RAIF QELA: Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,
I nderuar Kabinet qeveritar,
Është hera e dytë me radhë që kryeministri nuk është këtu dhe unë e kam një pyetje shumë të rëndësishme për vendin.

Trepça ndodhet që më shumë se 25 vjet në agoni, në agoni për shumë rrethana specifike. Projektligji, i cili është proceduar prej Qeverisë akoma nuk ka ardhur në Kuvend dhe ky është për shqetësim, kjo çështje është për shqetësim. Desha t'ia bëj përsëri kryeministrit pyetjen: kur do ta procedoni në Kuvend Projektligjin për Trepçën dhe deri ku ka arritur procedura e përgatitjes së këtij projektligji, aq më parë kur dihet se më 2 nëntor është afati kur nëse nuk ndërmerren masa prej institucioneve të Kosovës, Trepça shkon me automatizëm në likuidim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Ismajl Kurteshi, pyetje për kryeministrin Isa Mustafa. E njëjta gjë vlen, në qoftë se dëshironi, mund ta merrni fjalën, zoti Kurteshi e ka fjalën.

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit!

Unë vetëm desha për fillim të replikoj me kolegun tim. Tha, që dy herë s'po vjen kryeministri, kur ka pyetje parlamentare.

Kryeministri është shndërruar në një nxënës të keq, që sa herë të kemi pyetje parlamentare ikë prej orëve. Po, thanë se sot është duke i lexuar argumentet e komisionit të djeshme, të cilat s'i ka ditur, kështu që mund edhe t'i arsyetohet sepse pas leximit të tyre edhe do ta tërheq Ligjin për demarkacionin. Unë megjithatë pyetjen do ta lexoj.

Në Projektligjin e rishikimit të Buxhetit për vitin 2016 nuk janë paraparë mjete për pagat e pjesëtarëve të "Civilna Zaštita", të cilët po paguhën pa punuar fare. Pyetja ime është: Nga cili fond po i merrni paratë, që po i paguani këta njerëz dhe cila është baza ligjore, mbi të cilën e keni marrë vendimin për t'i futur në listë të pagave dhe paguar 500 njerëz, që nuk janë të punësuar?

Kjo ishte pyetja për kryeministrin, të cilën do ta përsëris edhe në seancën e ardhshme. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Mexhide Mjaku, pyetje për zëvendëskryeministrin Hajredin Kuçi.

MEXHIDE MJAKU: Në seancën e radhës, në seancën tjetër, pasi ai nuk është i pranishëm.

KRYESUESI: Në rregull! Deputetja Sala Berisha-Shala, pyetje për ministrin Lutfi Zharku.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, nënkryetar!
Përsëritje për të gjithë.

Zoti ministër, pyetja ime ka të bëjë me çështjen rruga Skenderaj – Komoran është arterie e rëndësishme, që lidh pjesën veriore të Kosovës me pjesën qendrore të saj. Për shkak të kësaj rëndësie dhe të tjera, projekti për zgjerimin e kësaj rruge është i paraparë dhe i ndarë në Buxhetin e Kosovës që nga mandati i kaluar. Pyetja është:

Pse ka stagnuar ky projekt? Për momentin nuk kemi zhvillime atje.

KRYESUESI: Zoti ministër Zharku, e keni fjalën.

MINISTRI LUTFI ZHARKU: I nderuar nënkryetar,
Të nderuar deputetë,
Kolegë ministra,
E nderuar deputete Sala Shala-Berisha,
Çështjen e ndërtimit të rrugës Skenderaj - Komoran e kam sqaruar edhe një herë në pyetjen e deputetit Abdyl Ymeri. Megjithatë, unë do të vazhdoj e t'i përsëris pothuajse gjërat e njëjta.

Siç e dini, procedurat tenderuese dhe kontrata për ndërtimin e rrugës regjionale Komoran - Skenderaj, segmenti Klinë e Epërme - Skenderaj - Polluzhë në gjatësi prej 13 km janë lidhur në pjesën e dytë të vitit 2014, kurse ndërtimi i urës mbi lumin Klina është kontraktuar vitin e kaluar. Ministria e Infrastrukturës këtë segment e ka ndarë në 7 lote dhe janë 7 kompani. Kostoja totale e kontratave është 14 338 mijë.

Për pjesën e kontraktuar në gjatësi prej 13 km Ministria e Infrastrukturës e ka pranuar fillimisht projektin nga komuna e Skenderajt, në bazë të të cilit janë iniciuar procedurat e prokurimit. Megjithatë, projekti i tenderimit nga komuna e Skenderajt nuk ka pasur elaborat shpronësimi, që ka ndikuar në problemet me banorë gjatë ekzekutimit të punimeve. Po ashtu, problem tjetër ka qenë edhe ofrimi i zgjidhjeve teknike, të cilat nuk kanë qenë të përfshira në projektin zbatues.

Ministria e Infrastrukturës vitin e kaluar e ka nënshkruar kontratën për hartimin e elaboratit të shpronësimit dhe i njëjti i është dorëzuar në fillim të këtij viti, për procedura të mëtutjeshme, Ministrisë së Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor. Në përputhje me elaboratin e shpronësimit Qeveria gjatë muajit maj, po edhe gjatë muajit qershor, ka aprovuar vendime për shqyrtimin e kërkesave për shpronësim për interes publik të pronave të paluajtshme në zonat kadastrale, duke filluar nga Klina e Epërme, mos t'i përmendi të gjitha me rend, deri në Polluzhë. Me vendimin e

Qeverisë për shpronësim kompanitë e kontraktuara kanë filluar të punojnë me kapacitet më të mirë, megjithatë ky projekt pritet të përfundojë në vitin 2016, nëse paraprakisht e ndajmë, që besoj se i ndajmë, deri kah fundi i vitit edhe 2,36 milionë euro.

Më 19 maj, së bashku me nënkryetarin e komunës së Skenderajt, zotin Fadil Nura, e kam vizituar segmentin e rrugës ku janë duke u zhvilluar punimet, si dhe kemi pasur takime me disa prej banorëve, pronat e të cilëve preken nga zgjerimi i kësaj rruge, në mënyrë që me kërkua një mirëkuptim për të lejuar zhvillimin e punimeve derisa nuk përfundojnë të gjitha procedurat e shpronësimit dhe në shumicën e rasteve ky mirëkuptim nuk ka munguar. Megjithatë, ka ende disa banorë që nuk po pranojnë të punohet derisa nuk e marrin, ose nuk kryhet vendimi përfundimtar, që nënkupton kompensimin e tu jepet e drejta pastaj në procedura gjyqësore.

Sa i përket pjesës së mbetur nga fshati Morinë deri në kyçin e rrugës rajonale në rrugën nacionale Prishtinë - Pejë është hartuar projekti kryesor, i cili do të përfundojë gjatë këtij viti. natyrisht, vazhdimi prapë i këtij segmenti do të varet nga sigurimi i mjeteve financiare gjatë viteve të ardhshme, si dhe kohëzgjatjes së procedurave të shpronësimit, që natyrisht nuk janë vetëm në autoritetin e Ministrisë së Infrastrukturës, po edhe Ministrisë së Ambientit dhe Ministrisë së Financave. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë, zonja deputete?

SALA BERISHA-SHALA: Nuk kam pyetje shtesë, mirëpo ministri foli për pjesën e asnjë segment tjetër, që lidhet me regjionin kryesisht me komunën e Skenderajt. Pyetja ime ishte nga kjo pjesa Morinë e tutje, deri në kyçjen në autostradë dhe e mora përgjigjen. Shpresoj që të mos ketë zvarritje të tilla, sikurse ka ndodhur me segmentin tjetër Klinë - Skenderaj.

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Ismajl Kurteshi, pyetje për ministrin Zharku.

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit!

Zoti ministër,

Në shumë rrugë magjistrale të Kosovës mungojnë shenjat e komunikacionit, e sidomos ato horizontale, vija e bardhë në të dy anët e rrugës dhe vija e bardhë në mes të rrugës. Po ashtu, mungojnë edhe shumë tabela në hyrje dhe dalje të fshatrave, si dhe shenjat orientuese që orientojnë shoferët, se si të arrijnë në destinacionin e caktuar.

Pas reshjeve atmosferike zakonisht kalojnë disa ditë derisa nga rruga të largohet balta dhe gurët, që i hedh shiu. Edhe mbulimi i gropave nuk bëhet me kohë dhe as nuk rrafshohet arnimi si duhet. Asfaltimi i rrugëve ose riasfaltimi i tyre bëhet keq, sepse puna nuk mbikëqyret e pranimi teknik bëhet shkel e shko nga kompetentët.

Zoti ministër,

Çka planifikoni të ndërmerreni për të zgjedhur këto probleme në rrugët magjistrale të Kosovës, të cilat paraqesin probleme shumë serioze për vozitësit, mandej shkaktajnë edhe defekte në vetura, po edhe aksidente trafiku?

KRYESUESI: Ministër Zharku, e keni fjalën.

MINISTRI LUTFI ZHARKU: I nderuar nënkryetar,

Të nderuar deputetë,

Kolegë anëtarë të Kabinetit qeveritar,

I nderuar deputet Kurteshi,

E kuptojmë shqetësimin në lidhje me mungesën e disa shenjave vertikale, si dhe sinjalizimit horizontal, duke marrë parasysh rëndësinë që kanë për sigurinë e pjesëmarrësve në komunikacion.

Ministria e Infrastrukturës natyrisht është e përkushtuar për sinjalizimin sa më të mirë vertikal dhe horizontal, në kuadër të mjeteve buxhetore të alokuara për këtë çështje. Buxheti i ndarë për këtë kategori në vitin 2016 ka qenë 700 000 euro, i cili me rishikim është rritur në 860 000, megjithatë nevojat për sinjalizim në përputhje me planet tona arrijnë shumën prej afër 2 milionë euro në vit.

Në mungesë të buxhetit të mjaftueshëm gjatë këtij viti i është dhënë prioritet rrugëve nacionale, për shkak të rëndësisë dhe fluksit më të madh që kanë këto rrugë. Aktualisht, jemi duke punuar në vendosjen dhe përmirësimin nga dëmtimet eventuale të shenjave vertikale të trafikut, si dhe jemi duke bërë shënimin e vijave të mesit të rrugës, por jo të atyre anësore.

Më lejoni të theksoj, se fatkeqësisht, na është bërë pothuajse dukuri e përditshme vjedhja apo asgjësimi i shenjave të trafikut në rrugët nacionale dhe rajonale, si dhe dëmtimi i tabelave në disa venduan ime. Në vitin e ardhshëm planifikojmë që përveç vijave të mesit të rrugës të shënohen edhe ato anësore, me qëllim të rritjes së sigurisë rrugore për të gjithë pjesëmarrësit në trafik, si dhe që nga vijat e thjeshta një komponentë që të kalojmë në ato të plastifikuara për shkak të qëndrueshmërisë së tyre më të gjatë në terren.

Edhe me mirëmbajtjen e rrugëve ballafaqohemi përsëri me buxhet të pamjaftueshëm, ku shuma prej 4.7 milionë eurosh përmbush vetëm gjysmën e nevojave tona për këto aktivitete. Ashtu siç e keni cekur edhe ju, gjatë këtij viti ka pasur të reshura më të mëdha të shiut e që kanë qenë të rrëmbyeshme, që si pasojë kemi pasur edhe erodime të shumta përgjatë brezit rrugor, e të cilat kanë përfshirë edhe disa pjesë të shtresës qarkulluese të rrugës.

Kompanitë e mirëmbajtjes të kontraktuara nga Ministria e Infrastrukturës kanë bërë pastrimin e rrugëve nga materiali i eroduar duke u dhënë prioritet rrugëve nacionale prapë. Sa i përket sanimit të gropave dhe shtresimit të disa segmenteve të rrugëve, ato bëhen natyrisht sipas kushteve të kontratës, kurse cilësia e bazuar në rezultatet e analizave që i kemi nga laboratorët tanë është në kuadër të parametrave të përcaktuara me kontratë dhe standardeve teknike. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë, zoti Kurteshi?

ISMAJL KURTESHI: Zoti ministër, kjo i bie që së paku edhe këtë vit vozitësit të vozisin nëpër rrugë të pasigurta, sepse mungon buxheti, kurse në anën tjetër, secili vozitës gjatë regjistrimit të veturës paguan 40 euro për mirëmbajtje të rrugëve, kurse ata me makineri më të rëndë paguajnë edhe më tepër, që po të shfrytëzoheshin të gjitha këto mjete për mirëmbajtjen e rrugëve, jam shumë i sigurt se nuk do të bëheshin këto probleme që janë.

Është e mundur që ndonjë shenjë vertikal edhe të vidhet, por askush nuk e vjedh ngjyrën e bardhë prej rrugëve, e në shumë rrugë magjistrale kjo mungon, jo për një kohë të shkurtër, mungon shumë gjatë. Konkretisht po ju them, unë për çdo ditë udhëtoj Prishtinë - Gjilan. Aty mungon me vite tamam si duhet dhe fund e krye rrugës, ndonjë pjesë edhe ka shenja të tilla që mungojnë dhe asgjë nuk po ndërmerret. Nëpër rrugë është...

KRYEMINISTRI: Zoti ministër, e keni fjalën. Në rregull! Zonja Puhie Demaku, pyetje për ministrin Enver Hoxhaj.

PUHIE DEMAKU: Faleminderit, kryesues!

Zoti ministër,

Bashkatdhetarët tanë që jetojnë në Norvegji na kanë informuar se Drejtoria e Policisë në Ministrinë e Punëve të Brendshme në Norvegji ka marrë një vendim mbi pasaportat norvegjeze, në bazë të të cilit shtetasit norvegjez të lindur në shtetet tjera, ku informatat janë vështirë të verifikueshme, nga tash e tutje në rubrikën vendi i lindjes t'u shënohet i panjohur. Ky vendim përfshin 31 shtete, kryesisht në Azi e Afrikë, por për fat të keq e prek edhe Kosovën.

Do të thotë, shqiptarëve të Kosovës që mbajnë nënshtetësi norvegjeze, sipas këtij vendimi, në pasaportë vendlindja nuk do t'u shënohet me, për shembull: Prishtinë, Gjilan apo Pejë, por do t'u shënohet "e panjohur". Ky vendim do t'ua pamundësojë udhëtimin, marrjen e vizave apo dhe hyrjen në shtete me kontrolle restriktive, siç janë për shembull SHBA-të dhe për pasojë do t'i dëmtojë ata padrejtësisht. Unë e kam ngritur këtë pyetje tash e një kohë, po bëhen gati dy muaj. e di që ministria është në dijeni, por më tregoni se cilat masa i keni ndërmarrë në këtë drejtim. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti ministër Hoxhaj e keni fjalën.

MINISTRI ENVER HOXHAI: Faleminderit!

I nderuar zoti nënkryetar,

Shumë e respektuara zonja Demaku,

Të nderuar deputetë,

Të nderura zonja dhe zotërinj,

Unë ju falënderoj shumë për këtë pyetje që ju keni ngritur. Të them të drejtën, unë nuk kam qenë i informuar në përputhje me kohën kur ju e keni ngritur këtë pyetje dhe është e vërtetë që pyetja është ngritur para dy muajsh. Mirëpo, për shkak të vizitave që kam pasur në disa vende, s'kam mundur të jem në Kuvend e të ju informoj me kohë.

Jam mirënjohës që e keni ngritur këtë temë dhe mandej kemi bërë përpjekje që ta ndjekim në detaje.

Çfarë mund të ju them sot, është se është një problem që i takon të së kaluarës, që është zgjidhur në ndërkohë dhe që në bazë të komunikimeve që unë kam pasur me ambasadën tonë në Suedi, e që mbulon edhe Norvegjinë dhe me ambasadën e Norvegjisë në Kosovë, duket se qasja e parë ka qenë teknike e motivet kanë qenë më shumë të natyrës teknike, por dhe të natyrës së sigurisë, që ndoshta tejkalon. Këtë përgjigje mund t'ua jap kështu, të dhëna më të detajshme, se çfarë ka ndodhur dhe si ka ndodhur.

Por, kam një obligim para jush, zonja deputete, dhe para deputetëve të tjerë dhe para qytetarëve të Kosovës, që ta jap një kronologji se çfarë ka ndodhur dhe ku jemi.

Më 8 qershor, në kohën kur ju e keni bërë pyetjen, në mediet norvegjeze ka pasur një lajm për një vendim të Drejtorisë së Policisë së Norvegjisë, ku thuhej që shtetasve norvegjez në 31 vende, duke përfshirë edhe Kosovën, do të duhet të shënohet si vendlindje e tyre nocioni “i panjohur”. Duket se ka pasur në vitet e ‘90-ta keqpërdorime nga disa qytetarë nga Shqipëria, të cilët janë paraqitur si qytetarë të Kosovës, por duket se ka pasur edhe motive tjera të rrethanave të sigurisë së kohëve të fundit, të cilat e kanë shtyrë Drejtorinë e Policisë së Norvegjisë, që të veprojnë në këtë drejtim. Me këtë nuk po dua ta arsyetoj, po vetëm po bëj përpjekje që ta jap një informatë të saktë.

Ambasada e Republikës së Kosovës në Stokholm ka marrë kontakt menjëherë me shtetin norvegjez, por edhe ka pasur reagime të diasporës sonë, ka pasur reagime të organizatave të të drejtave të njeriut dhe, më datën 10 qershor, do të thotë dy ditë më vonë, Drejtoria e Policisë së Norvegjisë ka konfirmuar që është i gatshëm, që ta rishqyrtojë këtë çështje. Më 16 qershor, Drejtoria e Policisë norvegjeze ka njoftuar se ka sjellë një vendim të ri, i cili vendim duket në këtë formë dhe duket në...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Vazhdojeni edhe pak, që ta sqarojë deri në fund çështjen e ngritur.

MINISTRI ENVER HOXHAI: Vendimi do të thotë, duhet të kuptohet në dy nivele. Për çdo person i cili vërtet mund ta verifikojë vendlindjen e tij do të shënohet vendlindja e tij, që ai vjen nga qytetet e Prishtinës, Prizrenit, Gjilanit, Mitrovicës, e kudo tjetër. Për personat tjerë, kur nuk mund të verifikohet vendlindja e tij, në kuptimin e zonës urbane të komunës, do të shënohet vetëm Kosova, si shtet i prejardhjes së tij.

Mendoj se kjo zgjidhje që është ofruar është zgjidhja më e mirë e mundshme, mirëpo ne si Ministri e Punëve të Jashtme, ambasada jonë është duke monitoruar situatën. Nëse ka individë, nëse ka qytetarë, nëse ka njerëz nga Kosova që jetojnë dhe punojnë në këtë vend dhe kanë shqetësime të kësaj natyre, ne jemi të gatshëm ta ndjekim çdo rast dhe ta sqarojmë çdo rast, me qëllim që të mos humbet prejardhja e tyre dhe ata të mos kenë probleme, siç thatë edhe ju, që nëse në të ardhmen marrin ndonjë vizë, ose bëjnë kërkesë për marrjen e ndonjë vize nga Amerika ose ndonjë vend tjetër, të ballafaqohen me situata të tilla absurde.

KRYESUESI: Pyetje shtesë?

PUHIE DEMAKU: Faleminderit, zoti ministër!

Megjithatë, unë jam e shqetësuar edhe më tutje për këtë problematikë, sepse e di që nuk do të ndalet tek Norvegjia, duke qenë se kanë filluar restriksionet në këtë drejtim, mirëpo a ka ndërmarrë Ministria e Punëve të Jashtme ndonjë iniciativë, qoftë përmes ambasadave tona në vendet tjera, që të parandalohet mundësia që të merret ndonjë iniciativë e tillë edhe në vendet tjera, ku kemi një diasporë të koncentruar? Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI ENVER HOXHAI: Prej pyetjes suaj parlamentare dhe prej lajmit që ka dalë në mediet norvegjeze më 8 qershor, ne në Ministri të Jashtme e kemi formuar një grup, i cili do të duhej ta mbikëqyrë situatën në çdo vend evropian dhe në çdo vend perëndimor. Meqë, është një situatë e re dhe meqë është një situatë, e cila për Diasporën po edhe për Kosovën do ta ketë një çmim shumë, shumë të lartë. Kështu që do ta monitorojmë por edhe sa i takon Norvegjisë do të bëjmë përpjekje maksimale, që të jemi në kontakt me çdo qytetar dhe të shohim për çdo rast veç e veç, të luftojmë që nëse dikush ka lindur në një qytet të caktuar të Kosovës t'i shënohet vendlindja dhe të mos i shënohet vetëm shteti prej nga vjen, do të thotë të mos shënohet vetëm emri "Kosovë", po të shënohet vendlindja e saktë.

Kemi bashkëpunim të ngushtë edhe me Ministrinë e Brendshme të Kosovës, por edhe me Ministrinë e Brendshme të Norvegjisë.

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Shqipe Pantina pyetje për ministrin Abdullah Hoti. Nuk është Shqipja a? Deputetja Salihe Mustafa pyetje për ministrin Imet Rrahmani.

SALIHE MUSTAFA: Faleminderit, kryesues!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Në muajin qershor nga mediet u njoftuam, që Ministria e Shëndetësisë ka filluar rilicencimin e profesionistëve shëndetësorë. Licencimi dhe rilicencimi është një procedurë që konfirmon, se profesionistët shëndetësorë i plotësojnë kushtet për të ushtruar profesionin e tyre. Në Kosovë licencat për punëtorët shëndetësorë që nga viti 2006 janë vazhduar me një vendim të përbashkët nga Ministria e shëndetësisë, për të gjithë profesionistët shëndetësor.

Zoti ministër, sa janë të informuar profesionistët shëndetësor për kushtet dhe kriteret që duhet t'i plotësojnë, për t'u rilicencuar?

KRYESUESI: Ministër, e keni fjalën.

MINISTRI IMET RRAHMANI: Faleminderit!

I nderuar kryesues,

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

E nderuar deputete zonja Mustafa,

Ju falënderoj për shqetësimin e ngritur.

Ne e dimë se licencimi dhe rilicencimi i profesionistëve shëndetësorë është segment shumë me rëndësi në aktivitetet dhe përgjegjësit e Ministrisë së Shëndetësisë dhe licenca e parë është dhënë në muajin maj 2001 dhe si rrjedhojë edhe përfundimi i validitetit të licencave të para ka ndodhur në maj 20016, ashtu siç e thatë edhe ju.

Pas kësaj periudhe gjithnjë vazhdimi i validitetit dhe licencave, respektivisht rilicencimi është bërë me një vendim të ministrit, për çdo vit deri më sot. Meqenëse shpeshherë kjo çështje është ngritur si shqetësim, jo vetëm në qarqe profesionale, nga komiteti koordinues i trupave profesionale në Ministrinë e Shëndetësisë kemi marrë kërkesën për lejimin e fillimit të procesit

për licencim të profesionistëve shëndetësorë, pas valorizimit të dëshmimeve për programet e përcjella në fushën e edukimit të vazhduar profesional.

Kjo fushë është e rregulluar me Udhëzim Administrativ 1/16, edukimi i vazhduar mjekësor, ku janë rregulluar akreditimi i programeve dhe vlerësimi, respektivisht poentimi i tyre. Duke u nisur nga përvoja e përditshme dhe nga informatat nga institucione shëndetësore, ne e dimë se një numër shumë i madh i profesionistëve kanë qenë shumë të kujdesshëm dhe të angazhuar në arritjen e njohurive të reja dhe ndjekjen e të gjitha aktiviteteve profesionale, të organizuara në Kosovë dhe jashtë saj. Dhe, do të ishte shumë korrekte që ato të njihen, vlerësohen dhe zyrtarizohen me një proces rilicencimi, me kritere dhe standarde të përcaktuara sipas Udhëzimit Administrativ.

Duke u nisur nga nevoja e zhvillimit të një procesi të mirëfilltë të rilicencimit dhe detyrimit tonë të njohjes së angazhimit dhe përkushtimit të profesionistëve për ngritje profesionale, ne kemi filluar procesin dhe më datë 9 qershor të këtij viti e kemi lansuar publikisht.

Në fazën e parë të këtij procesi do të rilicencohen të gjithë ata që aplikojnë dhe përmbushin pikët e domosdoshme me dokumentacione që ofrojnë, deri në qershor të vitit të ardhshëm. Në ndërkohë, do të pranohen programe të ndryshme nga institucione shëndetësore për akreditim dhe do të krijojmë mundësi për arritjen e kredive të domosdoshme. Duhet cekur, se planifikohen edhe mundësi për trajnime shtesë, për ata që nuk arrijnë pikët e nevojshme deri në qershor të vitit 2017.

Dhe, faza e fundit do të jetë faza e provimeve profesionale, për ata që nuk kanë plotësuar kushtet për rilicencim. Besojmë se numri i profesionistëve shëndetësorë, që do të kenë nevojë të dëshmojnë kompetencën profesionale përmes provimit, do të jetë shumë i vogël. Ne urojmë, që të jetë zero.

Përzgjedhja e të rilicencuarve të parë është e rastësishme dhe rezultat i përgjigjes pozitive në kërkesën e Ministrisë së Shëndetësisë, dërguar profesionistëve shëndetësorë përmes institucioneve ku punojnë ata. Do të thotë, që informimi ka qenë i duhur, por kemi filluar edhe një riinformim. Jemi kujdesur që ky proces fillimisht të përfshijë të gjitha profilet e profesionistëve, si simbolikë e ftesës së përbashkët për aplikim dhe dokumentim të të gjitha aktiviteteve që kanë ndjekur.

I tërë ky proces nga 1 korriku 2016 u është bartur odave të profesionistëve shëndetësorë dhe ka mbështetjen e plotë të trupave profesionale të Ministrisë së Shëndetësisë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë, zonja deputete?

SALIHE MUSTAFA: Faleminderit, kryesues!

Faleminderit ministër, për përgjigjen!

Realisht, nuk kam pyetje shtesë, por nga përgjigja që mora prej jush, profesionistët shëndetësorë deri në vitin kanë mundësi që të informohen, por kërkoj nga odat e profesionistëve shëndetësorë me marrjen e kompetencave të informojnë më shumë profesionistët shëndetësorë për kushtet dhe

kriteret, në mënyrë që në vitin e ardhshëm të kenë mundësi të rilicencohen të gjithë profesionistët shëndetësorë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Mexhide Mjaku-Topalli, pyetje për ministrin Arsim Bajrami.

MEXHIDE MJAKU-TOPALLI: Faleminderit, kryesues!

I nderuar ministër,

Ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar ministër,

Arsimi për të gjithë është një lëvizje shpresëdhënëse ndërkombëtare për të krijuar mundësinë e arsimimit për të gjithë personat pa dallim. Parimi kryesor i arsimimit për të gjithë, është që të gjithë personat të kenë të drejtën në arsim, e cila e drejtë është e potencuar në nenin 26 të deklaratës universale të të drejtave të njeriut të vitit 1948.

Synimi i Republikës së Kosovës për t'u bërë pjesë e Bashkimit Evropian dhe organizatave të tjera ndërkombëtare kanë nxitur ndryshime dhe reforma në sistemin e arsimit.

Koncepti gjithëpërfshirje, parim në politikat ndërkombëtare dhe vendore të arsimit, ndërlidhet me ofrimin e mundësive për qasje të barabartë bazuar në nevojat individuale.

Atëherë, në të vërtetë po i parashtroj disa pyetje:

- A janë të formuara ekipet profesionale për vlerësim në komuna?
- A e parashihni punësimin e koordinatorëve për arsim gjithëpërfshirës nëpër komuna?
- Sa janë të themeluara shërbimet këshillimore dhe shëndetësore për nevojat speciale nëpër shkolla për mbështetje specifike? Për shembull: terapi e të folurit, interpretues i gjuhës së shenjave e tjerë, si dhe
- A do të zvogëlohet numri i nxënësve në klasat gjithëpërfshirëse?

Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Për përgjigje, zoti Bajrami e ka fjalën.

ARSIM BAJRAMI: I nderuar zoti nënkryetar,

Të nderuar deputetë,

Të nderuara deputete,

Ju falënderoj shumë për pyetjen dhe më lejoni t'ju jap një përgjigje.

Projekti Arsimi i Përgjithshëm është një projekt global dhe është tani edhe një detyrim ndërkombëtar dhe Republika e Kosovës duhet të marrë masa të nevojshme për gjithëpërfshirje dhe për ofrimin e kushteve të barabarta për secilin, pa marrë parasysh gjendjen shëndetësore të fëmijëve.

Më lejoni t'ju informoj se Ministria e Arsimit ka marrë masa dhe tani kemi formuar në 28 komuna, 28 ekipe profesionale-pedagogjike që shqyrtojnë nevojat e nxënësve me nevoja të veçanta dhe po ashtu kemi emëruar 28 koordinatorë në komuna, të cilët do të merren me këtë

çështje. Pranë Ministrisë së Arsimit ekziston Divizioni për nevoja të veçanta dhe çdo 3 muaj këta koordinatorë takohen me Divizionin tonë dhe marrin udhëzime për ofrimin e kushteve të barabarta për mësim.

Natyrisht se ne kemi bërë edhe veprime të tjera, duke përgatitur tanimë 15 instruktorë apo 15 asistentë për përdorimin e gjuhës së shenjave, por në të ardhmen ne do të promovojmë projektin e shkollës humane që nënkupton se secila shkollë do të pajiset, krahas pedagogut, i cili tani është i siguruar dhe me grandin specifik, edhe me psikologun dhe me punëtorin social për të ofruar ndihmë.

Natyrisht, për këtë na duhet edhe ndihma e ministrive të tjera, në radhë të parë e Ministrisë së Shëndetësisë dhe e Ministrisë së Punës e Mirëqenies Sociale për të themeluar edhe qendra këshillimore, në mënyrë që ne me kohë të krijojmë këso qendrash për të bashkëpunuar me prindër e nxënës dhe për t'u këshilluar me ta për trajtim të veçantë.

Siç e dini, e nderuar deputete, Ministria menaxhon qendrat burimore – shkollat për fëmijët me nevoja të veçanta dhe ne jemi të vetëdijshëm se numri po zvogëlohet dhe shumica e këtyre fëmijëve do të integrohen në shkolla të rregullta, por akoma brenda rregullave dhe legjislacionit kemi të mjaftueshëm nxënës për t'i mbajtur këto klasa.

Dëshiroj t'ju siguroj se do t'i qasemi në mënyrë proaktive kësaj problematike për të ngritur kapacitete edhe në nivelin lokal, por edhe në nivel të Ministrisë së Arsimit për t'u ofruar gjasa të barabarta të gjithë fëmijëve dhe për të siguruar gjithëpërfshirje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk doni pyetje shtesë? Atëherë, deputeti Salih Salihu, pyetje për kryeministrin Isa Mustafa.

SALIH SALIHU: Meqë s'është kryeministri këtu, nuk po e lexoj fare, e kam lexuar herën e kaluar, s'ka qenë këtu, prapë s'ka ardhur dhe nuk e shoh të arsyeshme ta lexoj edhe një herë pa qenë ai prezent.

KRYESUESI: Para se të vazhdojmë me pikat e tjera të rendit të ditës, lidhur me pikën e rendit të ditës janë paraqitur deputetët zoti Konjufca, ishte i paraqitur më parë. Tash paraqitet edhe Muhamet Mustafa. Urdhëroni, zoti Muhamet Mustafa.

MUHAMET MUSTAFA: I nderuar kryesues i kësaj seance, Të nderuar përfaqësues të Qeverisë dhe kolegë deputetë, E keni marrë një shkresë nga Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë dhe Tregti, i cili ka propozuar që në rend dite të hyjnë edhe dy pika të rendit të ditë. Pra, të shqyrtohet edhe:

1. Projektligji nr. 05/L-110, për kamatë-vonesat dhe transaksionet tregtare dhe
2. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për rregullat e komunikacionit rrugor.

Propozimi është për procedurë të rregullt, sepse kanë kaluar, brenda afateve dhe në kuadër të procedurave të rregullt nuk ka shmangie nga Rregullorja.

Arsyeja pse propozojmë të hyjnë në rend dite këto pika është që të radhiten në këtë seancë dhe është me rëndësi që të votohen sa më shpejt. Për Ligjin për siguri në komunikacionin, e dimë problemin, me amendamentet që janë bërë dhe me diskutimet e gjëra, shpresojmë që do t'i kontribuojë një siguri më të madhe, prandaj edhe është me interes ta aprovojmë sa më shpejt.

Edhe Ligji për kamatë-vonesat është shumë i rëndësishëm, sepse përmirëson edhe më tutje mjedisin biznesor dhe kushtet e të bërit biznes dhe financimit të bizneseve.

Prandaj, lus deputetët që ta përkrahin këtë propozim.

Materialet i keni marrë dhe gjithçka është në kuadër të Rregullores dhe lus deputetët që të pajtohen për të hyrë këto dy pika sot. Nuk është me rëndësi cila pikë e rendit të ditës, por të futen në rend dite.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Nait Hasani e ka kërkuar fjalën.

NAIT HASANI: Faleminderit, nënkryetar!

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport, në mbledhjen e mbajtur më 2 gusht 2016 e ka shqyrtuar Projektligjin për ratifikimin e Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Prishtinë dhe Ministrisë së Arsimit të Republikës së Kosovës, për Programin Fulbrajt i shkëmbimit akademik dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

(Ndërprerje e incizimit)

Prandaj, kërkojmë që si pikë e parë e rendit të ditës të futet për miratim kjo marrëveshje në mes Ambasadës së SHBA-së dhe Ministrisë së Arsimit, e cila është në bazë të nenit 84 të Rregullores së Kuvendit që propozon shqyrtimin e projektligjit dhe nenit 56, paragrafi 1.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Flora Brovina e ka kërkuar fjalën.

FLORA BROVINA: Lidhur me pikën 4, a do të ketë forum, meqenëse janë 4 marrëveshje në rend të ditës, ratifikime dhe a do të ketë kuorum. Është fjala për pikën 4, 5, 6, 7 dhe 8.

KRYESUESI: Zonja Izmaqu, a doni të merrni fjalën?

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, nënkryetar!

Unë e kam një vërejtje lidhur me procesverbalin, por për këtë do të diskutoj pastaj.

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, meqë ka propozime për plotësimin e rendit të ditës, në pajtim me nenin 42, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit kemi 3 propozime me shkrim për plotësimin e rendit të ditës të seancës plenare, njëren nga Komisioni për Arsim dhe dy nga Komisioni për Zhvillim Ekonomik.

Propozimet për plotësimin e rendit të ditës do t'i votojmë një nga një.

Kryetari i Komisionit, zoti Naiti, lidhur me këtë e arsyetoi propozimin.

Tani vazhdojmë me votimin.

Në sallë i kemi 69 deputetë. Ju lutem, zini vendet!

Siç e dini, sipas Rregullores, propozimi duhet të votohet dhe duhet t'i ketë 2/3 e votave të pranishëm. Në sallë i kemi tani 75 deputetë.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Edhe një herë, po e përsëris. Tash do të votojmë propozimin e zotit Nait Hasani për plotësimin e rendit të ditës, sipas nenit 84 të Rregullores së Kuvendit, për t'u shmangur nga Rregullorja vendosin 2/3 e deputetëve të pranishëm në mbledhje.

Prandaj, lus regjinë e deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tani:

KADRI VESELI: Mund të votoni, se 68 deputetë janë të pranishëm.

KRYESUESI: 68 deputetë kanë votuar, 67 janë për, 1 kundër dhe miratohet propozimi i zotit Hasani propozimi shtesë për rend të ditës.

Ka vërejtje se s'po funksionon teknika, prandaj lus regjinë të shohin ku është problemi.

Këtu, në ekranin tonë, po dalin votat. Juve s'po ju funksionon atje.

Tani e kemi propozimin e dytë, zotit Muhamet Mustafa që para deputetëve të Kuvendit e sqaroi propozimin.

Kërkohet deklarimi i grupeve parlamentare për propozimin në fjalë. Edhe këtu, sipas nenit 84 të Rregullores së Kuvendit kërkohet shmangie nga Rregullorja me 2/3 e deputetëve prezentë.

A është në rregull teknika? Atëherë, edhe një herë, zoti Mustafa e ka kërkuar fjalën.

MUHAMET MUSTAFA: Kërkesa jonë për të dy këto projektligje është brenda afatit me Rregullore, prandaj nuk di a ka nevojë për shmangie nga Rregullorja. Lidhur me këtë, ju e dini më mirë...

KRYESUESI: Brenda afatit, sipas Rregullores, duhet miratuar Kryesia.

MUHAMET MUSTAFA: Në rregull është.

KRYESUESI: Ne këtë propozim tuajin mund ta bëjmë.

Atëherë, votojmë propozimin për pikën e dytë të rendit të ditës që e ka propozuar zoti Mustafa.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani!

Faleminderit! 64 deputetë kanë votuar, 63 kanë votuar për, 1 abstenim, prandaj miratohet propozimi për pikën e dytë.

Tani kemi propozimin e zotit Mustafa si pikë e tretë, për të cilin më parë e elaboroi.

Tani kërkohet vetëm votimi, me të njëjtën procedurë dhe votojmë tani:

E përsëris votimin edhe një herë, sepse ekziston një defekt te regjia, dhe ju lus të votoni.

Është fjala për shmangie nga Rregullorja.

Edhe një herë po ju them, patëm defekte me teknikën.

Edhe një herë po e përsëris. Zoti Mustafa ka prezantuar dy ligje në emër të Komisionit për Zhvillim Ekonomik që nga deputetët e Kuvendit të miratohet propozimi i tij.

Atëherë, nëse është në pyetje defekti në elektronikë, do të votojmë me dorë.

Atëherë, votojmë me dorë propozimin e zotit Mustafa për pikën e tretë të propozuar dhe votojmë tash:

Ju lutem, të numërohen votat.

Janë 84 deputetë të pranishëm në sallë.

Sa janë për? Kundër, a ka?

Kundër nuk ka! Atëherë, konstatoj se me shumicë votash u miratua propozimi i zotit Mustafa për shmangie nga Rregullorja.

(Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, zoti Kadri Veseli.)

KRYETARI: Faleminderit! Vazhdojmë me pikën e rendit të ditës:

Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Prishtinë dhe Ministrisë për Arsim, Shkencë dhe Teknologji të Republikës së Kosovës, Programi Fulbrajt i shkëmbimit akademik.

Shqyrtimi i këtij Projektligji do të bëhet në pajtim me vendimin e seancës së sotme plenare.

Komisioni FunkSIONAL për Arsim e ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim, me 3 amendamente të propozuara.

E ftojme ministrin e Arsimit, zotin Arsim Bajrami, që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe ta arsyetojë projektligjin.

MINISTRI ARSIM BAJRAMI: I nderuar kryetar i Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Më lejoni të prezantoj Projektligjin për ratifikimin e Memorandumit të Mirëkuptimit mes Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës e Teknologjisë për Projektin Fulbrajt - Shkëmbimi akademik.

Projekti Fulbrajt është ndër projektet më të rëndësishme të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në sferën e shkëmbimeve akademike dhe kulturore në arsimin e lartë dhe Kosova ka pasur një traditë të gjatë të bashkëpunimit.

Sivjet Ministria e Arsimit i ka bërë përgatitjet e nevojshme dhe para një kohe ne kemi nënshkruar me ambasadorin amerikan memorandumin për krijimin e një fondi të Qeverisë së Kosovës, i cili do të mbështetet nga fondet amerikane për fillimin e shkëmbimeve të reja akademike dhe ky projektligj parasheh miratimin e këtij memorandum, i cili do të fillojë të zbatohet nga ky vit akademik, nga viti akademik 2016-2017 deri në vitin akademik 2020-2021, në mënyrë që ne të krijojmë hapësirë për studiuesit tanë, për profesorët tanë, për asistentët tanë që të bëhen pjesë e shkëmbimit akademik në universitetet më prestigjioze amerikane, në mënyrë që të marrin shkathtësi në arsimin e lartë dhe ata do të kthehen në Kosovë për të kontribuar qoftë në jetën akademike, qoftë në administratën publike, në ndërmarrje apo biznese ku punojnë.

Ky memorandum parasheh faktin se Ministria e Arsimit qysh tani ka siguruar dhe ka zotuar mjetet e nevojshme për realizimin e këtij projekti në vlerë prej 1.5 milionë në një periudhë pesëvjeçare dhe këto fonde do të rriten edhe me kontributet e Qeverisë Amerikane dhe kontributet e universiteteve të ndryshme, në mënyrë që vërtet t'u japim këtë mundësi shumë të domosdoshme të rinjve tanë për të përsosur përvojat e tyre akademike dhe për të përcjellë sa më shumë përvojën e institucioneve të arsimit të lartë në Amerikë, qoftë në aspektin e metodologjisë së mësimdhënies, qoftë te segmente të tjera të menaxhimit modern të universiteteve tona.

Menjëherë pas miratimit të këtij projektligji, Ministria e Arsimit në bashkëpunim me Shtetet e Bashkuara të Amerikës do ta bëjë planin operativ, planin e implementimit të këtij memorandum dhe me kohë do të hapen konkursat e nevojshme në mënyrë që nga ky vit akademik të dërgojmë grupet e para të studiuesve. Është bursa më e mirë që e jep Qeveria Amerikane, një bursë që nuk është vetëm individuale, por është edhe familjare, një bursë e cila do të mundësojë vërtet ngritjen e cilësisë në arsimin e lartë, dhënien e mundësisë sa më shumë asistentëve të rinj, profesorëve të rinj e hulumtuesve të rinj dhe kjo do të përfshijë të gjitha universitetet publike, të gjitha institucionet private të arsimit të lartë, të gjitha institutet kërkimore e shkencore, por do të jepet edhe mundësia e aplikimit individual.

Andaj, të nderuar deputetë, ju ftoj që të mbështesim këtë projektligj, i cili do ta fuqizojë këtë marrëveshje shumë të rëndësishme ndërshtetërore, në mënyrë që ne t'i bëjmë të gjitha përgatitjet e nevojshme për fillimin e zbatimit të tij të plotë nga ky vit akademik.

KRYETARI: Faleminderit, i nderuar ministër! Tani radhën e ka kryetari i Komisionit Funkcional për Arsim, zoti Nait Hasani.

NAIT HASANI: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje për Kabinetin qeveritar,

Komisioni për Arsim, në mbledhjen e mbajtur më 2 gusht ka rekomanduar të miratohet Projektligji për ratifikimin e Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Prishtinë dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës, Programi Fulbrajt i shkëmbimit akademik, me amendamentet e propozuara.

Prandaj, kërkojmë nga deputetët ta miratojnë këtë memorandum të bashkëpunimit të fushës së arsimit ndërmjet Ambasadës së Amerikës dhe Ministrisë së Arsimit, e cila është për ngritjen e profesionalizmit të arsimit në Kosovë.

Amendamentet që i kemi bërë janë dy: është amendamenti 2 në tekstin Fushëveprimi i ligjit. Ky ligj vlen për të gjitha institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Kosovës dhe për autoritetet e tjera kompetente që janë përgjegjëse në fushën e arsimit të lartë. Prandaj, nuk kemi autoritete të tjera në fushën e arsimit përveç Ministrisë së Arsimit, e cila është e përgjegjshme për të gjitha veprimet e veta në fushë të arsimit. Prandaj,...

KRYETARI: Zoti kryetar, a bën të ndërhyj vetëm diçka. Derisa ju po flisni për dy amendamente, për hir të deputetëve, ne i kemi këtu tri amendamente për t'i votuar.

NAIT HASANI: Amendamenti dy, amendamenti një është Dispozitat e përgjithshme, është veç fjala “ndërrimi”, amendamenti 2 është “Fshirja dhe për autoritetet e tjera kompetente që janë përgjegjëse në fushën e arsimit të lartë”.

Amendamenti 3 i bashkëngjitet Memorandumit të Bashkëpunimit.

KRYETARI: Faleminderit! Tani është radha e përfaqësuesve të grupeve parlamentare. Nga Partia Demokratike e Kosovës, Bekim Haxhiu, në emër të grupit.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka analizuar marrëveshjen dhe e përkrah këtë marrëveshje. Faleminderit!

KRYETARI: Nga Lidhja Demokratike e Kosovës, deputeti Salih Morina.

SALIH MORINA: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje për zëvendëskryeministrin dhe Kabinetin qeveritar!

Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike e ka shqyrtuar këtë marrëveshje të bashkëpunimit mes Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Kosovës. Mendojmë që ky është një program, i cili afron mundësi të mira për studentët dhe studiuesit e të dyja vendeve, ku qytetarët e Kosovës do t'i kenë mundësi të vijojnë studime dhe punë kërkimore në universitetet amerikane dhe të bëhen pjesë e komunitetit prestigjioz të përfituesve të këtij programi Folbrajt.

Ky program ka filluar në vitin 2009, deri tash kemi 84 studentë, studiues, hulumtues dhe specialistë që janë përfitues të këtij programi direkt.

Prandaj, edhe unë i ftoj edhe Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike dhe të gjithë deputetët e Parlamentit të Kosovës që ta miratojnë këtë Memorandum Bashkëpunimi mes Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Ismajl Kurteshi, e ka fjalën në emër të Lëvizjes “Vetëvendosje”.

ISMAJL KURTESHI: Edhe Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe bazuar në shqyrtimet tona ne do ta përkrahim projektligjin dhe i ftoj të gjithë deputetët që ta përkrahin. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Slavko Simiq, e ka fjalën në emër të Listës serbe.

SLAVKO SIMIĆ: Hvala predsedniče!

I Poslanička grupa Srpske liste razmatrala Nacrt zakona o ratifikaciji memoranduma razumevanja između Sjedinjenih Američkih Država i Kosova, i mi ćemo dati podršku ovog ratifikaciji sporazuma. Hvala.

KRYETARI: Faleminderit! Zoti, Qerim Bajrami, në emër të “6+”, e ka fjalën.

QERIM BAJRAMI: Zahvaljujem predsedniče!

I parlamentarna grupa “6+” je razmatrala ovaj sporazum između Sjedinjenih Američkih Država, odnosno ambasade i Ministarstvo obrazovanja nauku i tehnologije i uzimajući u obzir da i mi kao pripadnici najvećih zajednica pripadamo Kosovu i obrazujemo se u sistemu Republike Kosova.

Nadamo se da ćemo i od ovoga imati koriste ne sumnjam u to i svakako ćemo podržati ovaj sporazum. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit, i nderuar Bajrami! Nuk kemi deputetë të paraqitur për fjalë. Zoti ministër, a dëshiron fjalën. Nuk ka nevojë.

Atëherë vetëm të bëjë një sqarim procedura, se kemi tre amendamente, të cilat do t’i votojmë një nga një dhe duhen dy të tretat e deputetëve, njëjtë si ratifikimi.

Do të shkojmë amendament për amendament të votojmë, lus deputetë të kthehen në sallë para se të fillojmë.

Atëherë kërkoj mirëkuptimin, vetëm kryetarët e grupeve janë duke i thirrur kolegët e tyre në sallë për përgatitje në votim.

Administrata, në qoftë se ka mundësi, ta dimë gjendjen. 83 deputetë janë në sallë, të evitohen problemet teknike. Po votojmë me dorë.

Të keni parasysh për është kryesore, abstenim, unë pyes edhe kush është kundër. Le të evidentohen.

83 deputetë janë në sallë.

Kush është për amendamentin 1?

Kush është për? A ka kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Kalon.

Amendamenti 2

A ka abstenim, a ka kundër, të gjithë jemi për.

Amendamenti 3

A ka abstenim? A ka kundër? Të gjithë jemi për.

Shkojmë te votimi i tekstit të Projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara, përgatitemi për votim, votojmë tash:

Kush është kundër? Kush ka abstenim? Kush është për, t'i ngrenë duart? Administrata, ju lutem, kush është për?

86 deputetë jemi në sallë, me aq sa po e shoh, edhe një, konstatoj 87 deputetë janë në sallë.

Kuvendi e miratoi Ligjin për ratifikimin e Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Ambasadës të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Prishtinë, Kosovë dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të Republikës së Kosovës, programi Fulbrajt i shkëmbimit akademik, pa asnjë votë kundër, pa asnjë abstenim me të gjitha votat për.

3. Miratimi i procesverbaleve nga seancat e mëparshme

Pyes, të nderuar kolegë, nëse keni vërejtje në procesverbalet e seancave plenare të mbajtura më 7, 8 e 11 korrik 2016 dhe më 14 korrik 2016, urdhëroni.

Xhevahire Izmaku e ka kërkuar fjalën, ka vërejtje.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, kryetar!

Vërejtja ime nuk është për këtë procesverbal, mirëpo të seancës së parafundit, ku është vërejtur mungesa e evidentimit të katër deputetëve me fjalimet e tyre në Projektligjin për vazhdimin e mandatit të EULEX-it. Pra, duhet të evidentohen fjalimet e Hajdar Beqës, Mexhide Topallit, Blerta Deliut dhe fjalimi im, Xhevahire Izmakut. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Regjia t'i ketë parasysh dhe t'i protokollojë këto çështje.

Konstatoj se me këtë vërejtje Kuvendi i miratoi procesverbalet e seancave plenare të mbajtura më 7, 8 e 11 korrik 2016 dhe më 14 korrik 2016.

4. Votimi i raportit vjetor të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për vitin 2015

Të nderuar deputetë,

Ju njoftoj se diskutimet për këtë pikë kanë përfunduar në seancën plenare të mbajtur më 14 korrik 2016. Tani procedojmë me votim.

Vazhdojmë me votimin vjetor të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për vitin 2015.

Po ashtu do të vazhdojmë me votimin me dorë.

Shumë është me rëndësi të evidentohen votat abstenim edhe kundër, të keni parasysh.

Do të nisem nga kjo, për arsye se pjesa tjetër merret për.

Kush është kundër? A ka abstenim? Atëherë me 89 vota, Kuvendi e miratoi raportin vjetor të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për vitin 2015.

5. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e marrëveshjes së kredisë ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe UniCredit Bank Austria AG për financimin e projektit të modernizimit të shërbimeve të Kardiologjisë Invazive në Qendrën Klinike Universitare

Komisioni për Buxhet dhe Financa dhe Komisioni për Shëndetësi e ka shqyrtuar Projektligjin për ratifikimin e marrëveshjes dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin.

Ftoj ministrin e Financave, zoti Abdullah Hoti, të paraqesë dhe të arsyetojë projektligjin.

MINISTRI ABDULLAH HOTI: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

Projektligjit për ratifikimin e marrëveshjes së kredisë së Kosovës dhe UniCredit Bank Austria buron nga marrëveshja për bashkëpunim financiar me Qeverinë e Austrisë së datës 12. 7. 2012.

Ajo marrëveshje parasheh financimin e projekteve deri në 20 milionë euro përmes kushteve të kredive të buta, nëpërmjet Qeverisë së Austrisë.

Deri më tani janë shfrytëzuar 4,5 milionë euro nga kjo marrëveshje për një projekt në fushën e arsimit që është në implementim e sipër.

Kjo është marrëveshja e dytë në kuadër të kësaj shume të kredisë.

Janë edhe disa marrëveshje të tjera, të cilat janë duke u përgatitur kryesisht në nivel lokal.

Ministria e Financave ka zhvilluar negociatat me palën austriake në përputhje me Ligjin për borxhet publike dhe Ligjin për marrëveshje ndërkombëtare dhe ka nënshkruar marrëveshjen financiare.

Projektligjin që po e diskutojmë sot parasheh ratifikimin e kësaj marrëveshjeje në shumë prej 2,6 milionë euro në maksimum për projektin e modernizimit të shërbimeve të Kardiologjisë invazive në QKUK.

Kredia do të merret nga UniCredit Bank Austria dhe është e garantuar nga Banka Austriake e kontrollit si kredi eksportuese.

Tërheqja bëhet me valutën euro, pra nuk ka rrezik valutar, ka maturitet afatgjatë prej 15,5 vjetëve, me 3,5 vjet “greis periudhë” dhe 12 vjet amortizim.

Norma e interesit është 0% me një kosto vjetore të kredisë prej 1,1%.

E gjithë kostoja që do të paguhet deri në fund të periudhës së kthimit të kredisë është në total 273 mijë euro.

Unë ju falënderoj për vëmendje dhe ju ftoj të aprovoni këtë projektligj.

KRYETARI: Faleminderit, zoti ministër! Kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa, zoti Naser Osmani, e ka fjalën. Zonja Besa Gaxherri e ka fjalën.

BESA GAXHERRI: Të nderuar kolegë deputetë!

Edhe Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar Projektligjin për ratifikimin e marrëveshjes së kredisë ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe UniCredit Bank Austria AG për financimin e projektit të modernizimit të shërbimeve të Kardiologjisë Invazive në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës.

Marrëveshja e kredisë e nënshkruar në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe UniCredit Bank Austria ka për qëllim financimin e projektit për modernizimin e shërbimeve të Kardiologjisë Invazive në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës.

Ashtu siç tha edhe ministri Hoti, në bazë të marrëveshjes së Qeverisë së Republikës së Kosovës do të huazojë shumën e kredisë prej 2,6 milionë euro nga UniCredit Banka austriake. Tërheqja e mjeteve bëhet me valutë që nuk paraqet rrezik valutor. Kredia jepet në normë fikse dhe norma e interesit është zero. Ndërsa tarifa e angazhimit është 0,50%, tarifa e menaxhimit është 0,50% e pandryshueshme ndaj shumës së kredisë, kredia ka maturinë afatgjate prej 15 vjet e gjysmë, ku 3 vjet e gjysmë janë “greis periudhë” dhe 12 vjet amortizim.

Në bazë të vlerësimit të ndikimit buxhetor të Ministrisë së Financave për financimin e projektit të modernizimit të shërbimeve të Kardiologjisë Invazive në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, me Ligjin e buxhetit 2016 është aprovuar buxheti në vlerë prej 2 milionë euro në kategorinë investime kapitale.

Ndërsa shumë prej 600 mijë euro Ministria e Shëndetësisë do ta mbulojë nga buxheti ekzistues i kësaj ministrie.

Komisioni për Buxhet dhe Financa në mbledhjen e mbajtur më 6 korrik 2016, pasi shqyrtoi projektligjin vlerësoi rëndësinë dhe kushtet e favorshme të marrëveshjes për financimin e projektit për modernizimin e shërbimeve të Kardiologjisë Invazive në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës në funksion të modernizimit të shërbimeve Kardiologjisë Invazive në QKUK.

Unanimisht i ka rekomanduar Kuvendit ratifikimin e kësaj marrëveshjeje.

Andaj, i ftoj të gjithë deputetët e Kuvendit që të aprovojnë këtë marrëveshje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! E ftoj kryetaren e Komisionit për Shëndetësi, zonjën Flora Brovina, të marrë fjalën.

FLORA BROVINA: Faleminderit!

Edhe Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale e ka shqyrtuar këtë projektligji për ratifikimin e marrëveshjes për kredi në mes të Qeverisë së Kosovës dhe UniCredit Bank Austria për financimin e projektit të modernizimit të shërbimeve të Kardiologjisë Invazive në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës.

Ne gjithashtu, për shkak të debatit që u zhvillua më herët në Kuvendin e Kosovës, kemi pasur nevojë të takohemi rishtazi me ministrin për Shëndetësi dhe të sqarohemi deri në fund si dhe me ministrin e Financave dhe në përfundim vijmë se duke e vlerësuar rëndësinë dhe kushtet e kredidhënies që realisht ka 0%, domethënë shumë të favorshme për Kosovën, gati janë falas, në interesin e modernizimit të shërbimit të Kardiologjisë Invazive, duke u konsultuar edhe me përfituesin, natyrisht vijmë në përfundim se duhet të votohet pa tjetër ky projektligji.

Komisioni merr përsipër në vazhdimësi të bëjë monitorimin e zbatimit të këtij ligji deri në finalizimin e tij. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zonja Brovina! Tani është radha e grupeve parlamentare. Nga Partia Demokratike e Kosovës, doktori Fadil Beka e ka fjalën.

FADIL BEKA: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe në parim i japim mbështetje.

Ne si grup parlamentar konsiderojmë që marrëveshje të tilla që kanë për qëllim modernizimin dhe shërbimet dhe investimet në shërbime shëndetësore të Kosovës konsiderojmë që janë shumë të rëndësishme dhe janë të mirëseardhura.

Gjithashtu ne si grup parlamentar e mbështesim propozimin e Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale që të bëhet monitorimi i implementimit të kësaj marrëveshjeje.

Prandaj, ne si grup parlamentar do të japim mbështetje dhe ne kërkojmë nga deputetët që ta mbështesin këtë marrëveshje. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Doktori po ashtu Hatim Baxhaku e ka kërkuar fjalën nga Lidhja Demokratike e Kosovës.

HATIM BAXHAKU: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar këtë projektligj për ratifikimin e marrëveshjes lidhur me modernizimin e shërbimit të kardiologjisë dhe e mbështet në tërësi, sepse një modernizim i shërbimeve të Kardiologjisë Invazive dhe kardiokirurgjisë mundëson shërbime cilësore për pacientët dhe siguri për pacientët, po ashtu edhe për mjekë.

Dilema që ka qenë për shtesën prej 500 mijë euro të kësaj kredie është zgjidhur në Komisionin Shëndetësor dhe është vërtetuar dhe është marrë qëndrimi që Komisioni për Shëndetësi do ta monitorojë implementimin e kësaj kredie dhe nuk ka asnjë dyshim që këtu ka keqpërdorim të mjeteve.

Prandaj, Grupi Parlamentar i LDK-së e përkrah këtë projektligj dhe fton të gjithë deputetët që ta përkrahin, ta votojnë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Radha e doktorëve, zonja Besa Baftija, nga Lëvizja “Vetëvendosje” e ka fjalën.

BESA BAFTIJA: Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Herën e parë ky projektligj që ka të bëjë me marrëveshjes e kredisë ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe UniCredit Bank Austria për financimin projektit të modernizimit të shërbimeve të Kardiologjisë Invazive nuk është miratuar, edhe pse ka qenë një kredi e favorshme.

Ka pasur debate të shumta, e diskutabile ka qenë shuma prej 500 mijë eurove që ka qenë e dedikuar për trajnimin e stafit si dhe për rregullimin e hapësirave ku do të vendosen aparaturat.

Më pas, Qeveria e ka ngarkuar Komisionin për Shëndetësi që të trajtojë këtë projektligj.

Komisioni ka ftuar ministrin Rrahmani që të japë sqarime më të detajuara për shfrytëzimin e këtyre mjeteve. Me që Komisioni Shëndetësor do të monitorojë si do të shpenzohen këto mjete, atëherë ne si komision e mbështesim. Por brenga ime është prapë se si do të shfrytëzohen, a do të përfundojnë edhe këta milionë e milionë euro siç kanë përfunduar ato më parë, sepse e dimë se në Kardiologjinë invazive janë investuar miliona euro, e tani e dimë se kardiologjia është pothuajse në kolaps, është me aparaturë të stërvjetëruar.

Prandaj, ne si Lëvizje “Vetëvendosje” do ta votojmë këtë projektligj, sepse është në të mirë të pacientëve. Mirëpo, siç thashë, kemi dyshime se si do të shfrytëzohen këto mjete, e kur e them këtë po e nisi nga fakti.

Është dashur fillimisht që të kërkojnë llogari nga ata që kanë keqpërdorur mjete të shumta që janë investuar në kardiologji.

Prandaj, brenga jonë është se paratë e kredisë rrezikojnë të zhduken sërish nëpër tenderë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Lista serbe, nuk është lajmëruar askush. Zoti Damka, a je doktor?

FIKRIM DAMKA: Teşekkür ederim sayın Başkan,

“6+” Parlamenter Grubu da bu iki anlaşmayla Avusturya ile sağlık bakanlığı arasında yapılacak olan ikili anlaşmanın desteklediğini irade etmek isteriz. Özellikle merkez hastanede kardiologji

bölümünün yeniden onarılması ile ilgili gerekliliği ortadadır. Umut ederim ki bu ayrılan 2.6 milyon euroluk paranın gerekli ve isabetli yerlere harcanmasıdır.

Teşekkür ederim.

KRYETARI: Faleminderit! Nuk ka deputetë të lajmëruar për diskutim, përveç Bekim Haxhiut.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë!

Kjo marrëveshje po na kthehet edhe një herë në Kuvend, edhe pse e pandryshuar pa pikë e presje, është e njëjta marrëveshje, të cilën Kuvendi i Kosovës e ka refuzuar muaj më parë për shkak të dyshimeve për rritjen e shumës së kredisë, dyshime të cilat unë i kam ngritur në fillim kur është debatuar kjo marrëveshje. Sot e kësaj dite, kur kjo marrëveshje ka ardhur sërish në Kuvend, mbetet ende e pasqaruar rritja e shumës së kredisë prej 2,1 milionë në 2,6 milionë euro, për 500 mijë euro rritje e shumës së kredisë, të cilën ministri i Shëndetësisë nuk ka arritur asnjëherë ta arsyetojë.

Fillimisht ka thënë se këto mjete do të shfrytëzohen për lyrje, instalime dhe montim të aparaturës, pastaj është thënë që janë për trajnim të stafit dhe unë them që këto mjete, të cilat mendohen të shpenzohen ekstra vlerës së projektit, i cili është miratuar dhe është nënshkruar kontrata ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe operatorit apo shitësit, në këtë rast.

Në nenin 19 dhe nenin 20 të kontratës janë të parapara instalimi i aparaturës dhe trajnimi i stafit dyjavor, të cilën Ministria e Shëndetësisë, këtë rast ministri vetë tenton ta arsyetojë si pjesë e marrëveshjes së re për ekstra këtë shumën 500 mijë euro.

Dhe, në debatin të cilin e kemi pasur me ministrin e Shëndetësisë, ai ka deklaruar se kjo shuma prej 500 mijë euro mund të shfrytëzohet, nëse ka bazë ligjore dhe baza ligjore po kërkohet të jepet nëpërmjet votës tonë në Kuvend. Unë edhe atëherë kam thënë dhe tani po e them, le të kthehet kjo marrëveshje në shumën të cilën ka nënshkruar ministria kontratë, për arsye se nuk mund të shpenzojmë 500 mijë euro për këtë kontratë pa pasur një procedurë të mirëfilltë tenderuese ose pa pasur një marrëveshje se si do të shpenzohen këto 500 mijë euro.

Po flasim për një shumë, e cila nuk është pjesë e kontratës, për të cilën bazën ligjore duhet të japë Kuvendi.

Kur jemi te çështja e Kardiologjisë invazive dhe kardiokirurgjisë dua vetëm t'ua tërheq vëmendjen, të nderuar kolegë deputetë juve dhe qytetarëve të Kosovës, e në veçanti ministrit të Shëndetësisë që fillimisht në Kardiologjinë invazive për hapjen dhe fillimin e punës atje janë investuar mbi 1,7 milion euro, pastaj 5,2 milionë euro janë investuar për kardiokirurgjinë, që afërsisht bëjnë deri më tani investime në kardiokirurgji dhe kardiologjinë invazive afro 7 milionë euro.

Përkundër këtyre investimeve, Ministria e Shëndetësisë për çdo vit për pacientët me sëmundje koronore ka shpenzuar edhe nga 5 milionë euro ekstra të tjera për trajtimin e këtyre pacientëve jashtë institucioneve publike, do të thotë që kanë shkuar në institucionet private.

Dhe vazhdojnë ende të investojnë në një sektor ku Ministria për çdo vit shpenzon mjete të buxhetit të Kosovës në kundërshtim me Ligjin e shëndetësisë për trajtimin e këtyre pacientëve jashtë institucioneve publike.

Dhe, kur të kthehemi prapë te marrëveshja, gjithsesi duhet të them se nëse Ministria e Shëndetësisë nuk arrin, në këtë rast vetë ministri, të arsyetojë këtë shumën prej 500 mijë eurove, atëherë cili është arsyeja që ne duhet këtë shumë ta kthejmë.

Ne kemi diskutuar edhe me ministrin në Komisionin Parlamentar dhe kur flasim për modernizimin e Kardiologjisë invazive, ministri ka prezantuar projektin e njëjtë në vitin 2015 në projektbuxhetin e vitit 2015, që në fakt ka qenë salla hibride e planifikuar 2,6 milionë euro për vitin 2015 dhe 2 milionë euro për vitin 2016.

Salla hibride është modernizuar, ndërsa në Komision ministri ka pranuar që po blejnë aparaturë rezervë, aparaturë rezervë për 2,6 milionë euro, e cila ka qenë në kuadër të projektit të sallës, prandaj po shpenzojmë mjete ekstra për diçka që është aparaturë rezervë dhe nuk është modernizim, nuk mund të flasim këtu për modernizim dhe vetë ministri në komision parlamentar bashkë me anëtarët e komisionit kanë pranuar që kjo është aparaturë rezervë dhe aparaturë e tillë ekziston në Qendrën Klinike Universitare dhe tani po blejmë aparaturë rezervë.

Unë dua të shpreh falënderimin tim për Qeverinë e Austrisë dhe bankën austriake, e cila po e ndihmon Kosovën, por hartuesit e këtij projekti që kanë qenë edhe këshilltarët e ministrit, edhe zyrtarë të tjerë të Ministrisë së Shëndetësisë, kanë bërë specifikimin e këtyre pajisjeve në formën që tani mund të abuzohet me votën tonë.

Prandaj, kërkoj nga Ministria e Shëndetësisë, këtë rast vetë ministri, që ta tërheqë këtë marrëveshje, ta bie shumën 2.1 milionë euro sa është marrëveshja dhe pastaj ta votojmë në Kuvend. Me votën tonë po kërkohen të abuzohen 500 mijë euro. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zonja Brovina, urdhëro!

FLORA BROVINA: Komisioni unanimitet ka votuar për dhe unë i lus deputetët që ta përkrahin këtë projekt marrëveshje për kredi shumë të favorshme. Këto diskutime që u thanë, ne e dimë gjendjen në shëndetësi, nuk kemi nevojë tani të sjellim një situatë në të cilën domethënë nuk pranojmë diçka që na ofrohet.

Na ofrohet një mundësi shumë e mirë për trajtimin e pacientëve të shumtë që trajtohen jashtë shtetit për sëmundjet kardiokirurgjike. Unë ju lus që të jemi gjithashtu unanimitet në aprovimin e kësaj kredie që është në të vërtetë kredi miqësore me interesin 0.

KRYETARI: Faleminderit! Përgatitemi për votim, ministri i Financave e ka fjalën, pas fjalimit të ministrit të Financave përgatitemi për votim.

MINISTRI ABDUALLAH HOTI: Unë vetëm të jap një sqarim. Ne sot po votojmë një marrëveshje në shumë totale maksimale prej 2,6 milionë euro.

Është nënshkruar një kontratë me kushte, siç parashihen në marrëveshje, e cila bëhet efektive kur Kuvendi të votojë këtë marrëveshje dhe kjo marrëveshje të hyjë në fuqi sipas ligjeve në Kosovë. Neve nuk na obligon askush të shpenzojmë gjithë shumën prej 2,6 milionë euro, por maksimumi që sot voton Kuvendi është 2,6 milionë euro.

Çdo euro që shpenzohet nëpërmjet kësaj marrëveshjeje bëhet në përputhje me kushtet e marrëveshjes edhe me një procedurë konkurruese. Unë kam pasur takime me Komisionin për Shëndetësi dhe unë i ftoj ata qysh tash le të bëjnë një komision mbikëqyrës për të parë si po implementohet në detaje kjo marrëveshje. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Haxhiu je lajmëruar prapë, lufto edhe pak.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

I nderuar ministër!

Ju dhe ministri i Shëndetësisë vetëm një sqarim duhet të na jepni, për arsye se kontratën e kemi këtu.

Kontrata a është 2.1 milionë a është 2.6 milionë? Vetëm këtë na sqaroni, si është nënshkruar kontrata dhe cili është çmimi i kompanisë fituese.

KRYETARI: E tha ministri, po që edhe njëherë përgatituni për votim. E tha, 2,6 është maksimum.

MINISTRI ABDULLAH HOTI: Më leni të sqaroj çdo marrëveshje e kredisë mund të përfshijë më shumë se një kontratë për implementimin e asaj marrëveshjeje. Kontrata e parë është nënshkruar prej 2 milionë e 110 mijë euro për blerjen e pajisjeve.

Është edhe një pjesë tjetër që parashihet për komplementim të atyre pajisjeve, e cila do të shfrytëzohet sipas kërkesës së Ministrisë së Shëndetësisë dhe shumë mirë tash përmes mbikëqyrjes së Komisionit për Shëndetësi. Edhe unë besoj që nuk ka asnjë dilemë në këtë drejtim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Të nderuar kolegë, për çdo ratifikim duhen 2/3 e votave të pranishëm, në fakt deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Jemi 91 deputetë, do të shkojmë me votimin me dorë prapë, e rëndësishme është kush është kundër, edhe abstenimet, të tjerat merren për.

Kush është kundër? Janë evidentuar. A ka abstenim? Të tjerët merren për. Do të thotë Kuvendi e miratoi Ligjin për ratifikimin e marrëveshjes së kredisë ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe UniCreditBank Austria Ag për financimin e projektit të modernizimit të shërbimet e Kardiologjisë invazive në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës.

6. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes përkitazi me themelimin e Fondit të Ballkanit Perëndimor

Komisioni për Punë të Jashtme ka shqyrtuar Projektligjin për ratifikimin e marrëveshjes. Ftoj ministrin e Punëve të Jashtme, zotin Enver Hoxhaj, që ta paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin.

MINISTRI ENVER HOXHAI: I nderuar, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë të Kabinetit qeveritar,

Shumë të respektuar deputetë të Kuvendit të Kosovës!

Kam nderin që të paraqes para jush për ratifikim Projektligjin për ratifikimin e marrëveshjes për themelimin e Fondit të Ballkanit Perëndimor.

Dua t'ju informoj në pika të shkurta se çka nënkupton ky projektligj dhe kjo marrëveshje. Republika e Kosovës, më datën 13 nëntor të vitit 2015, në Pragë ka nënshkruar marrëveshjen për themelimin e Fondit të Ballkanit Perëndimor. Palët, të cilat e kanë nënshkruar këtë marrëveshje janë: Kosova, Shqipëria, Bosnja, Hercegovina, Mali i Zi, Maqedonia dhe Serbia. Selia e këtij fondi do të jetë e vendosur në Tiranë, që është mirë edhe për Republikën e Shqipërisë, por që padyshim është e mirë edhe për Republikën e Kosovës. Është organizata e parë e cila vendoset me seli në Tiranë në këto 20 vjetët e fundit.

Fondi i Ballkanit Perëndimor ka këto qëllime:

- së pari, të mbështesë bashkëpunimin rajonal në tërësi,
- të mbështesë forcimin e lidhjeve në mes të shteteve të Ballkanit Perëndimor,
- ta mbështesë integrimin evropian të Ballkanit Perëndimor, si dhe projekte konkrete të përbashkëta të këtyre vendeve në raport me Bashkimin Evropian.

Fondi si i tillë synon të promovojë dhe të zhvillojë bashkëpunim kulturor, do të thotë bashkëpunimi kulturor është njëra nga fushat, që të promovojë dhe të mbështesë shkëmbimin akademik, që të mbështesë hulumtime dhe kërkime shkencore në fusha të ndryshme, që të mbështesë dhe të promovojë shkëmbimin mes të rinjve të Ballkanit Perëndimor, si dhe zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik.

Ky projektligj dhe kjo marrëveshje ndërlidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektivat e Qeverisë së Republikës së Kosovës, e cila synon ta mbështesë një politikë aktive rajonale dhe ta mbështesë bashkëpunimin rajonal. Në këtë drejtim unë kërkoj nga ju në mirësi që ta mbështetni ratifikimin e këtij projektligji, i cili Kosovën e bën palë dhe i cili Kosovës ia jep një peshë të veçantë në këtë fond dhe prej së cilës sigurisht që Kosova do të ketë përfitime edhe financiare edhe përfitime në formë të projekteve konkrete. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti ministër! Zonja Teuta Rugova e ka fjalën në emër të Komisionit FunkSIONAL.

TEUTA RUGOVA: Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Komisioni për Punë të Jashtme në mbledhjen e mbajtur më 7 korrik 2016 e ka shqyrtuar Projektligjin për Ratifikimin e Marrëveshjes përkitazi me themelimin e Fondit të Ballkanit Perëndimor.

Gjatë shqyrtimit të projektligjit komisioni ka konstatuar se ky projektligj ka për qëllim ratifikimin e marrëveshjes përkitazi me themelimin e Fondit të Ballkanit Perëndimor, përmes së cilit promovohet zhvillimi i bashkëpunimit më të ngushtë ndërmjet palëve kontraktuese, forcimi i lidhjeve ndërmjet palëve kontraktuese, integrimi i palëve kontraktuese në Bashkimin Evropian dhe prezantimi i përbashkët i palëve kontraktuese me vendet e treta.

Komisioni, duke vlerësuar se me këtë projektligj Republika e Kosovës merr pjesë aktive në promovimin dhe zhvillimin e bashkëpunimit kulturor, shkëmbimeve shkencore, hulumtimeve dhe bashkëpunimeve në fushën e arsimit ndërmjet palëve kontraktuese dhe se avancohet statusin e saj në arenën ndërkombëtare, duke qenë e pranishme në forume ndërkombëtare shumëpalësh ka rekomanduar miratimin e Projektligjit për ratifikimin e marrëveshjes përkitazi me themelimin e Fondit të Ballkanit Perëndimor. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zonja Blerta Deliu-Kodra, në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, kryetar!

Ashtu siç e tha edhe nënkryetarja e komisionit, Komisioni për Politikë të Jashtme më 7 korrik e ka miratuar unanimisht Projektligjin për Ratifikimin e Marrëveshjes përkitazi me themelimin e Fondit të Ballkanit Perëndimor dhe ne si grup parlamentar kërkojmë miratimin e këtij projektligji.

KRYETARI: Nga Lidhja Demokratike të Kosovës po e shoh s'është lajmëruar askush, Teuta e ka përfunduar.

Zonja Puhie Demaku, nga Lëvizja "Vetëvendosje".

PUHIE DEMAKU: Është e qartë që përmes këtij ligji po synohet përafrimi i shteteve të rajonit, pra i palëve kontraktuese, si quhen në ligj. Ky fond në përmbajtje merr formën e një konstalacioni që mund të krahasohet lirisht me një lloj Jugosllavie të re, dhe kjo është shqetësuese, sepse ky Kuvend nuk e ka debatuar kurrë se a është kjo qasja që do të marrë shteti i Kosovës në të ardhmen.

Derisa ky debat të mos ketë ndodhur në këtë Kuvend, atëherë Qeveria e Kosovës nuk ka pasur as dritë të gjelbër të procedojë me një ligj të tillë.

Shqetësimi tjetër është se një nga palët nënshkruese, siç u cek edhe më herët nga vetë ministri, është edhe Serbia, dhe ky Kuvend, ky shtet e di shumë mirë se me çfarë Serbie kemi të bëjmë. Me këtë ligj, nëse votohet nga ky Kuvend, i japim Serbisë edhe një adut shtesë, me të cilin do të na luftojë, pra ne e pajisim atë me një armë ekstra në kuadër të arsenalit që tashmë e ka në dispozicion dhe po e përdor kundër këtij shteti dhe ekzistencës së këtij shteti.

T'ju kujtoj edhe njëherë juve deputetëve të Republikës së Kosovës se Kroacia po e kushtëzon Serbinë shumë më shumë se Republika e Kosovës, e ne kemi shumë më shumë arsye dhe kemi shumë më shumë argumente për ta bërë një gjë të tillë. Për pasojë, lëvizja “Vetëvendosje” nuk e voton këtë ligj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! “6+” zoti Bajrami e keni fjalën.

ĆERIM BAJRAMI: Zahvaljujem, predsedniĉe i Parlamentarna Grupa “6+” preko naŝe uĉeŝće u Komisiju za spoljne poslove je razmatrala ovaj zakon, i mislim da je onu korist Republike Kosove i svakako ĉemo glasiti za njega. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! Nuk ka deputetë, nuk ka përfaqësues të Qeverisë që e kërkon fjalën. Atëherë sqarimi procedural është ai i njëjti, për ratifikimin e marrëveshjes së tillë na duhen 2/3 e votave të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Në sallë janë të pranishëm 73 deputetë, nuk mund ta procedojmë në rrethana të tilla fare. U lutem deputetëve të kthehen. Po shkojmë, po e procedojmë me tjetrin dhe menjëherë i fusim në votim dyja.

7. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e marrëveshjes financiare ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Investime për projektin e rehabilitimit të Linjës Hekurudhore 10

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar Projektligjin për ratifikimin e marrëveshjes dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim. Ftoj ministrin e Financave, zotin Abdullah Hoti, që të paraqesë dhe të arsyetojë projektligjin. Ndërkohë lus regjinë të thërrasë deputetët për votim.

MINISTRI ABDULLAH HOTI: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

Rehabilitimi i linjës 10 të hekurudhës parashihet të kushtojë rreth 195.5 milionë euro, përfshirë këtu edhe TVSH-në.

Me miratimin paraprak të Qeverisë ne kemi zhvilluar negociata me kreditorë dhe donatorë të ndryshëm për gjetjen e fondeve për këtë projekt. Ky projekt do të bëjë rehabilitimin e plotë dhe do të modernizojë linjën hekurudhore që përshkon Kosovën nga kufiri jugor me Maqedoninë, në Hanin e Elezit, deri në kufirin verior me Serbi, në Leshak dhe njëkohësisht paraqet investimin më të madh që është bërë ndonjëherë në hekurudhat e Kosovës.

Kredia që kemi sot përpara me Bankën Evropiane për Investime paraqet një pjesë të financimit të nevojshëm që kap vlerën 42 milionë euro. Kjo kredi do t'i shtohet financimit që tashmë është siguruar në vlerë prej 39,9 milionë euro me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim. Ndërsa, pjesa tjetër pritet të vijë nga fondet e IPA-s të Bashkimit Evropian.

Kushtet e kredisë së negociuar janë mjaft të volitshme dhe karakterizohen me një periudhë kthimit deri në 25 vjet, përfshirë një “greis periudhë” deri në 4 vjet, me normë të interesit 1%

plus euro bori 6-mujor. Kjo kredi do të transferohet tek “Infra Kosi” në formë të transferit të kapitalit dhe do të jetë pjesë e klauzolës së investimeve të miratuara me Ligjin për financat publike. Unë ju ftoj që të apromoni këtë projektligj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti ministër! Zonja Besa Gaxherri, në emër të Komisionit Funksional, e ka fjalën.

BESA GAXHERRI: Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar Projektligjin për ratifikimin e marrëveshjes financiare ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Investime që ka për qëllim financimin e projektit të rehabilitimit të linjës hekurudhore 10.

Në bazë të marrëveshjes Qeveria e Kosovës merr kredi në shumë prej 42 milionë euro nga Banka Evropiane Investive, pjesa e mjeteve të kredisë do të huazohet nga Qeveria te kompania publike “Infra Kos”, si implementuese e projektit.

Realizimi i projektit për rehabilitimin e linjës hekurudhore 10 përfshin një shumë totale prej 195.5 milionë euro, duke përfshirë edhe TVSH-në. Për financimin e projektit, përveç shumës prej 42 milionë euro që aktualisht po diskutojmë, Kuvendi ka ratifikuar marrëveshjen me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për huazimin e kredisë prej 39.9 milionë euro dhe pjesa tjetër e fondeve për realizimin e këtij projekti është duke u negociuar me BE-në në kuadër të IPA-s, pra fondeve të IPA-s.

Një pjesë e financimit do të jetë nga participimi prej buxhetit të Kosovës. Sa i përket kushteve të kredisë, pra periudha, siç e tha edhe ministri, e kthimit është 25 vjet me “greis periudhë” prej 4 vjetëve, ndërkaq norma e interesit është 1%. Ndërkaq, euro bori është 0,86%. Në bazë të vlerësimit të ndikimit buxhetor të bërë nga Ministria e Financave, kostoja për zbatimin e kësaj marrëveshjeje përfshin periudhën 2016-2019 dhe financimi i projektit të rehabilitimit të linjës hekurudhore 10 përmes kredisë është pjesë e projekteve të Qeverisë në kuadër të raportit për planifikim dhe implementimin e klauzolës për investime.

Në pajtim me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë do të jetë pjesë e buxhetit të Kosovës dhe kornizës buxhetore në vazhdim. Komisioni për Buxhet dhe Financa, pasi ka shqyrtuar marrëveshjen, ka vlerësuar rëndësinë e financimit të projektit që do të ndihmojë në përmirësimin dhe rehabilitimin e qarkullimit hekurudhor të personave dhe mallrave dhe meqë kostoja financiare do të jetë pjesë e kornizës buxhetore në vazhdim, duke vlerësuar edhe kushtet e volitshme të kredisë, njëzëri ka marrë vendim dhe i ka rekomanduar Kuvendit që të ratifikojë këtë marrëveshje.

Andaj, unë i ftoj të gjithë deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës që ta votojnë këtë marrëveshje. Faleminderit për vëmendje!

KRYETARI: Faleminderit! Tani radhën e kanë grupet parlamentare. Zonja Labinotë Demi-Murtezi e ka fjalën në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës.

LABINOTË DEMI-MURTEZI: Faleminderit për fjalën, kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës me bashkëpunëtorët e koalicionit ka shqyrtuar Projektligjin nr. 5/L-111 dhe mbështet këtë projektligj, që nënkupton ratifikimin e marrëveshjes financiare ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Investime për projektin e rehabilitimit të linjës hekurudhore 10. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Konjufca në emër të Lëvizjes “Vetëvendosje”.

GLAUK KONJUFCA: Atëherë, Lëvizja “Vetëvendosje” e ka shqyrtuar këtë marrëveshje dhe ne mendojmë që kjo marrëveshje nuk është më e mira për Republikën e Kosovës, këtë duhet ta themi troç.

Pra, ne kemi vërejtjet tona edhe sa i përket përmbajtjes së kësaj marrëveshjeje, por më lejoni të jem shumë i sqartë dhe shumë i drejtpërdrejtë me juve në bisedime dhe me grupet e tjera parlamentare, sidomos këtu e kam fjalën për Lidhjen Demokratike të Kosovës, ne jemi vënë në një pozicion shumë të palakmueshëm që është kushtëzimi i kësaj marrëveshjeje me marrëveshjen paraprake që do të vijë, e kjo është pika e radhës, e cila ka të bëjë me Trafikun urban të Prishtinës.

Edhe pse kjo marrëveshje nuk na pëlqen fare, ne jemi të shtrënguar ta bëjmë këtë radhë një kompromis dhe ta votojmë këtë marrëveshje, jo pse është më e mira për Kosovën, por pse jemi të detyruar ta bëjmë këtë për shkak të marrëveshjes së radhës dhe ky është, pra, njëri prej kompromiseve të rralla që lëvizja “Vetëvendosje” e bën, për arsye se rrezikohet shumë që qytetarët e Prishtinës dhe të Kosovës në përgjithësi për shkak të kësaj marrëveshjeje, nëse ne nuk e votojmë, atëherë do të humbim shumë në marrëveshjen tjetër.

Prandaj, detyrohem ta them të vërtetën hapur, kjo është arsyeja pse do ta votojmë marrëveshjen për hekurudha. Faleminderit!

KRYETARI: Ndërkohë, ka kërkuar fjalën kryetari i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, zoti Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, kryetar!

Sigurisht që unë e përshëndes gatishmërinë e Lëvizjes “Vetëvendosje” të votojë diçka që është në interes të vendit, siç është ky projektligj për të cilin po flasim. Në asnjë rrethanë nuk është punë kushtëzimi, unë publikisht e them, unë kam biseduar me kolegët, me disa prej kolegëve të “Vetëvendosjes” dhe kemi thënë që mirë kishte me qenë të votohet, sepse është në interes të vendit.

Një projekt, i cili e tha ministri pa e zgjatur, 195.5 milionë euro, që është në interes të krejt Kosovës, sikundër që është edhe më vonë marrëveshja tjetër që është në interes të qytetarëve të Prishtinës, absolutisht mua më gëzon fakti dhe do të duhej që kësaj të reflektojmë dhe të votojmë diçka që është në interes të qytetarëve. Po ky interes nuk mund të jetë parcial, për dikë bën, e për dikë s’bën. Prandaj, sigurisht ne do t’i votojmë të gjitha marrëveshjet, sepse është rregull, është kulturë elementare që t’u ndihmojmë qytetarëve tanë përmes kësaj forme. Faleminderit!

KRYETARI: Jo, jo do ta kesh fjalën, po jemi duke u futur tash në një ngërç, për arsye se e kemi edhe këtë ratifikimin e Ballkanit Perëndimor, atëherë veç t'i fusim në paketë të gjitha, se unë s'mund të garantoj në këto marrëveshjet çka po ndodh.

Urdhëro, kryetari i Grupit Parlamentar Lëvizja "Vetëvendosje".

GLAUK KONJUFCA: Unë mendoj që biseda që kemi pasur me zotin Beqiri e ka pasur njëfarë lloj të konotacionit kushtëzues, sepse fjala e tij ka qenë pak a shumë kështu. Ai ka thënë që nëse ju nuk e votoni këtë marrëveshjen e hekurudhave, atëherë rrezikohet që LDK-ja ta votojë marrëveshjen e radhës.

Për arsye që kjo të mos ndodhë, ne votojmë hekurudhat, në mënyrë që LDK-ja ta votojë trafikun urban. Mirëpo, unë nuk e di, ndoshta kjo nuk është kushtëzim i drejtpërdrejtë, mirëpo njëfarë kushtëzimi i tërthortë është. Sikur ky të mos ishte kushtëzim dhe sikur zoti Beqiri ta japë premtimin që këto nuk janë të ndërlihdura, atëherë ne mund ta votojmë këtë për hekurudha kundër, LDK-ja meqenëse po i do caq shumë qytetarët e Prishtinës, le ta votojë atë për. Mirëpo, ne nuk jemi të sigurt që Lidhja Demokratike e Kosovës do ta bëjë këtë gjë, kështu që jemi të shtrënguar ta pranojmë këtë kompromis, me keqardhje.

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Besim Beqaj e ka kërkuar fjalën. Ndërkohë Ali Sadriu, edhe kryetari i Grupit Parlamentar, Ismet Beqiri. Besim!

BESIM BEQAJ: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Dua të them që kemi para vetes një marrëveshje ekstrem të rëndësishme për shtetin. Është një marrëveshje që së paku tre vjet deri më tani është punuar për të ardhur te kjo marrëveshje.

Unë kam qenë ministër i Financave kur kemi filluar negociatat me bankën, është një marrëveshje, e cila nuk shkon vetëm në favor të ekonomisë, por edhe të lëvizjes ndërkombëtare dhe të rëndësisë ndërkombëtare, të cilën Kosova mund ta ketë në rrjetin hekurudhor. Pra, jemi duke folur për një projekt shumë më të rëndësishëm se sa projektet lokale, jemi duke folur për një projekt i cili hap rrugë të Kosovës në zhvillimin ekonomik, por edhe në evidentimin e saj në rrjetet ndërkombëtare të hekurudhave.

Pra, nuk jemi duke folur vetëm për financim, por jemi duke folur për futjen në rrjetën, të cilat janë në nivele të rrjetave ndërkombëtare dhe besoj që duhet të sillemi me përgjegjësi shtetërore, institucionale, kur është fjala për zhvillim ekonomik, kur është fjala për pozicionim të shtetit në nivele të marrëdhënieve ndërkombëtare dhe në nivele të projekteve, të cilat kanë karakter edhe rajonal, por edhe karakter zhvillimor.

Prandaj, unë ju bëj thirrje të gjithë deputetëve, pavarësisht kushtëzimet, të cilat po përmenden. Nëse e krahasojmë cili projekt është më i rëndësishëm prej këtyre të dyja, nuk mund të krahasohen hiq. Jemi duke folur për një projekt të rëndësisë ekstrem të rëndësishme për qytetarët dhe një projekt lokal. Por, nëse është ashtu, shtini në paketë të gjitha dhe flasim pastaj për projekte të tërësishme. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Ali Sadriu, ndërkohë kryetari i Grupit Parlamentar, Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Kryetar, edhe një herë unë i falënderoj të gjithë ata...

KRYETARI: Kryetari i Grupit Parlamentar, unë mendova në fund t'ju lë ju, duke qenë se jeni kryetar i grupit.

ISMET BEQIRI: Besoj se edhe deputeti ka mirëkuptim, normal që mund ta marrë fjalën, por po deshi ai mund edhe pas fjalës sime të mos e marrë hiq, varet prej tij.

Edhe njëherë, zoti kryetar, pa dashur ta zgjas, sepse realisht marrëveshja është jashtëzakonisht e rëndësishme, nuk i bëj komparacion cila ka më shumë e më pak, por është shumë e qartë që interesi i qytetarëve të Kosovës edhe të Prishtinës duhet të ngërthehen, por jo në formë siç u tha më herët nga parafolës. Ne e kemi gatishmërinë dhe si të tillë do të veprojmë në interes të qytetarëve, për projekte të tilla që janë madhore, siç e tha edhe zoti Beqaj, një projekt jashtëzakonisht i rëndësishëm dhe pastaj edhe projekti tjetër për Prishtinën, që është po ashtu i rëndësishëm. Dhe, vota jonë do të jetë pro.

KRYETARI: Deputet, po qe se e do fjalën, unë jam i gatshëm të ta jap. Si të duash. Me korrektësi. Nuk po dua të krijoj situata, por jemi para një situatë, e cila tanimë është publike. Si do të shkojmë në votim, sepse po qe se shkojmë në votim në pako, duhet ta hedhim në votim me 2/3-at. Tash, e keni radhitjen, e kemi:

1. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e marrëveshjes përkitazi me themelimin e Fondit të Ballkanit Perëndimor,

2. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e marrëveshjes financiare ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Investime për projektin e rehabilitimit të linjës hekurudhore 10 dhe

3. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e marrëveshjes së garancisë ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për Projektin e Trafikut Urban.

(Polemikë në sallë)

Kjo varet prej jush, prej meje jo. Shkojmë një nga një. U krye, shkojmë një nga një. Deputeti Ali Sadriu e ka kërkuar fjalën dhe jemi në përfundim të diskutimeve, shkojmë në votim.

ALI SADRIU: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit Qeveritar,

Kolegë deputetë,

U tha shumëçka. Desha vetëm ta vazhdoj aty ku e lanë. Mendoj se pozita e komunikacionit hekurudhor në Kosovë është në gjendjen më të ulët të mundshme. Dhe, nuk mund të mendohet një zhvillim ekonomik pa një transport hekurudhor.

Kjo që i është dhënë, kjo kredi në këtë kuptim në relacionin Hani i Elezit - Leshak është një diçka që na lidhë me faktorin ndërkombëtar dhe na kyçë në rrjedhat ndërkombëtare, nuk diskutohet ajo. Mendoj, se ky projekt është i mangët dhe duhet të bëjmë luftë, që të plotësohet. Ky projekt nuk përfshinë elektrifikimin, që është diçka e kohës dhe ky projekt nuk lëshohet në rrjetin tjetër, do të thotë rrugën për Prizren, për Mitrovicë, e tjera...

Dhe intencat tona, po ne do ta miratojmë me kënaqësi, por duhet të jemi këmbëngulës që pjesa tjetër të vazhdojë, për të pasur një zhvillim të qëndrueshëm. Edhe një herë po theksoj, më kot i kemi ndërtuar autostradat, nëse nuk kemi hekurudha. Atë ua garantoj, brenda pesë vjetësh do të dëmtohen aq rëndë, sa veç meremetimi i tyre do të na kushtojë sa kjo shumë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Shkojmë në votim. Urdhëroni fjalën, Bekim Haxhiu. Mirë është të shkojmë në votim tash.

BEKIM HAXHIU. Faleminderit, i nderuar kryetar!

Vetëm dua të sqaroj një fakt. Ky projekt është me rëndësi jo vetëm për faktin e rehabilitimit të hekurudhave të Kosovës, në pjesët ku tani funksionojnë, por votimi pro kësaj marrëveshjeje e bën që hekurudhat e Kosovës të rehabilitohen edhe në pjesën veriore deri në kufijtë e fundit të Kosovës.

Prandaj, vota kundër kësaj marrëveshjeje është votë kundër shtrirjes së hekurudhave të Kosovës në tërë territorin e vendit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Të nderuar deputetë, sërish është sqarimi procedural. Duhet 2/3-at e votave. Ne do të shkojmë...

Jemi 85 deputetë të pranishëm në sallë. Votimi do të bëhet sërish me dorë. E rëndësishme është, se evidentohet vota kundër dhe abstenim, për arsye se të tjerat merren nga kjo prezencë merren për.

Kush është kundër?

Jemi te shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e marrëveshjes financiare ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Investime për projektin e rehabilitimit të Linjës Hekurudhore 10. Kush është kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.

Kuvendi e miratoi Ligjin për ratifikimin e Marrëveshjes financiare ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Investime për projektin e rehabilitimit të Linjës Hekurudhore 10 me 85 vota për.

Tash na kanë mbetur 6-shi dhe 8-shi:

- Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes së garancisë ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për projektin e Trafikut Urban

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar Projektligjin për ratifikimin e marrëveshjes dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim, bashkë me amendamentet e propozuara.

Siç e pashë, ne jemi marrë vesh, veç proceduralisht, nëse ka nevojë ministri i financave ta bëjë një ekspozë. Ka nevojë apo të shkojmë në votim drejt? Shkojmë në votim? Kryetari i komisionit funksional, nuk ka nevojë. Grupet parlamentare s'kanë nevojë. Deputetët? S'është paraqitur askush. Përfaqësuesi i Qeverisë? "Vetëvendosje" doni para se të votojmë ne për edhe një fjalë? Jo!

Atëherë, thërras deputetët që ta votojmë unanimisht. Me 2/3-at e votave ratifikohet edhe kjo marrëveshje ndërkombëtare.

Edhe një herë, jemi 85 deputetë në sallë. E rëndësishme është vota kundër dhe abstenim nga këto 85, të tjerat merren për, po që se nuk ka reagim. Kush është kundër kësaj marrëveshjeje? A ka abstenim? Më falni, më falni, paska amendamente. Kërkoj falje! Gabim imi, është bërë pa qëllim. Kemi amendamentet.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votimin e pesë amendamenteve. Shkojmë një nga një. Do të shkojmë prapë me votim, çdoherë duhen 80 vota, po me dorë, 85 vetë jemi prezentë në sallë. Në qoftë se ka kundër apo abstenim, të tjerat menjëherë merren aprovim edhe tek amendamentet.

84 deputetë janë në sallë.

Amendamenti 1

A ka kundër? Abstenim? Miratohet.

Amendamenti 2

A ka kundër? Abstenim? Ka 1 abstenim. Miratohet.

Amendamenti 3

A ka kundër? Abstenim? Ka 1 abstenim. Miratohet.

Amendamenti 4

A ka kundër? Abstenim? Një. Miratohet.

Amendamenti 5

A ka kundër? Abstenim? Një. Miratohet.

Atëherë, të nderuar kolegë votojmë tekstin e projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara. Edhe një herë kundër, abstenim, merren parasysh 84 deputetë konsiderohen votim në qoftë se s'ka kundër ose abstenim. A ka kundër? Nuk ka. A ka Abstenim? Një. Kuvendi miratoi Ligjin

për ratifikimin e marrëveshjes së garancisë ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për projektin e trafikut urban Prishtinë.

Dëshironi që edhe një herë ta fus në votim ratifikimin e marrëveshjes mbi themelimin e Fondit të Ballkanit Perëndimor?

Edhe një herë do ta fus projektligjin për ratifikimin e marrëveshjes përkitazi me themelimin e Fondit të Ballkanit Perëndimor. Vlejnë të njëjtat procedura. Duhet 80 deputetë. Kush është kundër dhe abstenim, më falni. Do të merren parasysh në qoftë se s'ka kundër e abstenim, atëherë miratohet me prezencën e tyre.

Edhe një herë po e fus formalisht. 82 deputetë janë në sallë. Ju lutem për koncentrik! Kush është kundër? Kush abstenon? Nuk miratohet.

Shkojmë në pikën tjetër të rendit të ditës, për arsye se nuk e patëm numrin e nevojshëm.

9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për performansën energjetike në ndërtesa

Konstatimet hyrëse.

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit Komisioni FunkSIONAL e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij. Procedimi i mëtejshëm vazhdon si vijon:

E ftoj përfaqësuesin e Qeverisë, zonjën Hykmete Bajrami, që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe arsyetojë projektligjin.

E ftoj zonjën Aida Dërguti, nënkryetare, që të marrë kryesimin. Dëshironi pauzë? Atëherë, sa dëshironi pauzë? Pauzë deri në orën 15:00.

* * *

Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës

Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Fikrim Damka.

9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për performansën energjetike në ndërtesa

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni FunkSIONAL ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij.

Procedimet i vazhdojmë, si vijon: E ftoj përfaqësuesin e Qeverisë, zotin Ferat Shala, që para deputetëve të Kuvendit të paraqesë dhe arsyetojë projektligjin.

FERAT SHALA: I nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar të pranishëm,

Më lejoni që shkurtimisht të paraqes qëllimin dhe rëndësinë e Projektligjit për performansën energjetike në ndërtesa.

Rëndësia e këtij projektligji ka karakter shumëdimensional dhe esencial për zhvillimin e shoqërisë, si në kursimin e energjisë, ashtu edhe në mjedisin dhe shëndetin.

Republika e Kosovës ka nënshkruar tashmë traktatin e komitetit të energjisë dhe ka marrë për obligim miratimin e kornizës ligjore në harmoni të plotë me legjislacionin e Bashkimit Evropian, i cili është parakusht esencial për realizimin e obligimeve që dalin nga traktati i larttheksuar dhe implementimin e planit të veprimit për eficiencën e energjisë 2014/2018. Andaj, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në kuadër të kompetencave të saj për rregullimin e fushës së ndërtimit, duke marrë parasysh obligimin dhe implementimin e direktivës 2010/31 të Bashkimit Evropian dhe Ligjin nr. 04/L-110 për ndërtim, i cili është në fuqi që nga muaji korrik 2012 ka përcaktuar kërkesat për aplikimin e masave të eficiencës së energjisë në objektivat ndërtimore. Meqë, direktiva 2010/31 e Bashkimit Evropian përmban dispozita të cilat nuk plotësohen në bazën ekzistuese legjislative, Ministria e Mjedisit ka identifikuar si nevojë për hartimin e Ligjit për performansën e energjisë në ndërtesa.

Idenë për hartimin e këtij ligji e ka përkrahur edhe Sekretariati i Komitetit të Energjisë duke konsideruar si masë edhe arritjen e civeve si dhe planin e veprimit të eficiencës së energjisë në nivel vendi. Duke qenë të vetëdijshëm për rëndësinë që ka, propozoj që të shqyrtoni, miratoni Projektligjin për performansën e energjisë së ndërtesave. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, i nderuar ministër! Radha është te Komisioni Funkcional.

Në emër të komisionit kush dëshiron ta marrë fjalë, pasi më duket se kryetarja Duda Balje nuk është këtu. Adem Salihu, urdhëroni.

ADEM SALIHU: Përshëndetje, të nderuar kolegë deputetë!

Komisioni për Bujqësi, Pylltari dhe Planifikim Hapësinor e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe e ka proceduar për miratim në parim në Kuvend, në leximin e parë. Ne mendojmë se i plotëson kushtet elementare që të shqyrtohet në parim, pastaj komisioni dhe Kuvendi do ta shqyrtojë për lexim të dytë.

Ne ju thërrasim që të diskutoni dhe ta aprovoni në leximin e parë, kurse pastaj nëse ka vërejtje dhe sugjerime, ne do t'i marrim parasysh gjatë punës së komisionit. Unë do të flas edhe në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së.

Edhe Grupi Parlamentar i LDK-së e përkrah në parim miratimin e këtij projektligji dhe do ta japë kontributin e tij në fazën e mëtutjeshme të amendamentimin eventual të këtij projektligji. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, i nderuar deputet! Shkojmë sipas përfaqësuesve të grupeve parlamentare. Në emër të LDK-së Adem Salihu e ka kryer punën. Grupi Parlamentar PDK, Emilija Rexhepi, urdhëroni.

EMILIJIA REDŽEPI: Hvala predsedavajući!

Poslanici Parlamentarne Grupe PDK su u potpunosti razmotrili ovaj nacrt-zakona i danas će ga u prvom čitanju podržati. Zahvaljujem!

KRYESUESI: Faleminderit, e nderuar deputete! Grupi Parlamentar “Vetëvendosje”, s’ka. Grupi Parlamentar AAK? Lista serbe, edhe “Nisma” s’ka. “6+”-i? Nuk ka. Po, urdhëroni!

Urdhëroni zonja deputete! Fjalën e ka deputetja Mufera Shinik.

MÜFERA ŞINIK: Teşekkür ederim,

Aynı şekilde 6+ Parlamenter Grubu da birinci okunuşunu Yasa Tasarısını kabul etmektedir. İkinci okunuşuna kadar belirli komisyonlarda amandmanları vererek katkısını sunacaktır. Teşekkür ederiz.

KRYESUESI: Faleminderit, e nderuar deputete! Grupet Parlamentare e kanë kryer. Deputeti Sadri Ferati e ka fjalën.

SADRI FERATI: Faleminderit, kryesues!

Përshëndetje!

Zoti ministër,

Ministra,

Të nderuar kolegë,

Unë mendoj se edhe ka qenë momenti i fundit dhe është vërtet për ta përshëndetur këtë iniciativë kudo që ka dalë dhe të gjithë ata që e kanë mbështetur, nga se ka qenë momenti i fundit, që ne të krijojmë hapësira komode për punë dhe për rrjet. Por, nga ana tjetër, duke pasur kujdes në shpenzimet që ne krijojmë, pra të jemi racionalë dhe ajo energji nuk prodhohet nga asgjë, por prodhohet nga diçka e cila pastaj i ka implikimet dhe ndikimet e saj, qoftë në ambient apo në forma të ndryshme.

Ligji është shumë i thjeshtë, shumë i lexueshëm, është shumë i qartë. Kam një çështje, meqë ajo esenca e asaj që ne duam të shohim është e paraparë që të udhëzohet me udhëzim administrativ. Kam një sugjerim për ministrin dhe komisionet që do të jenë të kyçura më tutje, që të jenë më precize dhe sidomos pjesa, ku përveç objekteve të reja dhe objekteve që i nënshtrohen një renovimi më masiv, por ajo të vlejë për secilën ndërtesë, sepse ne kemi efekte pozitive tek ndërtesat e reja dhe tek ndërtesat që i nënshtrohen një renovimi masiv, po themi të një shumice, po pse edhe te çdo institucion. Së paku, të fillojmë nga institucione shtetërore, të cilat duhet të obligohen që t’i kenë të njëjtat, pra t’i ushtrojnë ato të njëjtat përgjegjësi dhe obligime, në mënyrë që të kemi një efikasitet dhe të kemi edhe një performansë pak më të mirë nëpër ndërtesa.

Të jem më konkret. Nëse ne detyrohemi, që me ligj të përdorim masa mjete dhe metoda që të kursejmë energji brendi një objekti, pse objektet e vjetra, sidomos ato me sipërfaqe shumë të

madhe dhe shtetërore, të presin që edhe 15 të rrënohen. Po duhet që ndërmjet dy leximeve të rregullohet, që së paku për një periudhë të caktuar, tri apo pesëvjeçare, të fillojmë me institucione shtetërore, që pastaj qytetari ta kuptojë se sa e rëndësishme qenka kjo. Sepse, nuk bëhet vetëm nga dëshira dhe forma, por ne dëshirojmë efekte pozitive që nga kualiteti i jetës, nga kursimi në energji si dhe ruajtja e burimeve prej nga na vjen ajo energji.

Pra, kam një sugjerim nga të gjithë komplementet dhe përkrahjen time, që të kihet parasysh që ndërmjet dy leximeve të rregullohet, që të gjitha ndërtesat, së paku ato shtetërore, të startojnë brenda tre vjetësh, që pastaj pas tre vjetësh t'ua japim shansin që ndoshta ta bëjmë edhe për çdo ndërtesë.

Përvojat jashtë Kosove, sidomos atje ku këto kanë filluar para 20 a 30 vjetësh, tregojnë një gjë që atje janë rezultate të hatashme. Ne do ta kemi rastin edhe më konkretisht të bisedojmë ndërmjet dy leximeve.

Edhe njëherë, Grupi Parlamentar i LDK-së do ta përkrahë. Vërtet e përshëndes si iniciativë dhe unë mendoj, që ne do t'i kontribuojmë edhe Kosovës dhe ta instalojmë një standard të mirë edhe në të ardhmen, në rast se i detajojmë këto çështje dhe nuk i bëjmë vetëm formale, vetëm të themi se kemi ligj dhe të fillojmë t'i rregullojmë disa fasada me një izolim, ose kulmet, por ajo shkohet detajisht, deri te këmbyesit e energjisë nga të ftohtë në të nxehtë, nga të nxehtë në të ftohtë, e tjera, tjera...

Prandaj, ministër dhe komision, do ta keni përkrahjen tonë edhe në mes dy leximeve, në mënyrë që definitivisht ta aprovojmë një ligj, i cili do të jetë afatgjatë dhe do t'i kontribuojë kësaj fushe në interes të Kosovës dhe qytetarëve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, deputet! I nderuar ministër, e dëshironi fjalën prapë? Faleminderit! Për shkak të mungesës së deputetëve do ta shqyrtojmë pikën e dhjetë, Projektligjin për mbrojtjen e fëmijës, sepse gjithsej i kemi 44 deputetë, derisa të bëhet për votim kuorumi do të vazhdojmë me shqyrtimet.

10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 05/L-105 për mbrojtjen e fëmijës

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit Komisioni Funkcional ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij.

E ftoj përfaqësuesin e Qeverisë, ministrin zotin Abrashi, që para deputetëve ta prezantojë dhe arsyetojë projektligjin.

MINISTRI ARBAN ABRASHI: I nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë,

Ministra,

Zonja dhe zotërinj,

Më lejoni që në këtë sesion plenar të Kuvendit të Republikës së Kosovës të paraqes Projektligjin për mbrojtjen e fëmijës.

Projektligji është miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës me Vendimin Nr. 01/88 të datës 20 maj 2016.

Republika e Kosovës e ka një kornizë të gjerë ligjore, me të cilën rregullohet mbrojtja e fëmijës, mirëpo deri më tani Kosova nuk ka pasur një listë të veçantë sikurse që posedojnë vendet e tjera, i cili rregullon mbrojtjen e fëmijës në të gjitha fushat e jetës.

Në këtë drejtim është e panevojshme të bëhet një ligj i veçantë për mbrojtjen e fëmijës me qëllim të krijimit të një sistemi të mirëfilltë ligjor për mbrojtjen e fëmijës në përputhje me standardet evropiane dhe ndërkombëtare.

Gjithashtu duhet të përmendet se Projektligji për mbrojtjen e fëmijës parashihet edhe në Planin kombëtar për zbatimin e MSA-s, njëherësh del edhe si kërkesë nga Raporti i Progresit për Kosovën.

Projektligji për mbrojtjen e fëmijës është hartuar duke u bazuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, legjislacionin e Bashkimit Evropian, si dhe në Konventën për të Drejtat e Fëmijëve.

Projektligji për mbrojtjen e fëmijës është përgatitur nga Zyra e Kryeministrit.

Gjatë hartimit të Projektligjit është zhvilluar procesi i konsultimeve paraprake dhe publike me të gjitha institucionet e nivelit qendror dhe lokal, të cilat në një mënyrë direkte apo indirekte janë përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijës.

Gjithashtu, Zyra e Kryeministrit ka zhvilluar një sërë debatesh publike me institucionet si dhe me një numër të konsiderueshëm të organizatave të shoqërisë civile, të cilët kanë në fushëveprimin e tyre të punës mbrojtjen e fëmijës.

Projektligji në fjalë ka për qëllim të mbrojë fëmijën nga të gjitha format e dhunës, abuzimit, keqpërdorimit, shfrytëzimit, lënies pas dore apo ndonjë forme tjetër që vë në rrezik jetën, sigurinë, shëndetin, edukimin, arsimimin dhe zhvillimin e fëmijës, sikurse garanton dhe siguron përgjegjësinë e prindërve, familjes, shoqërisë dhe të shtetit në kujdesin, mbrojtjen dhe zhvillimin e fëmijës, duke u bazuar në interesin më të mirë të tij, siguron interesin më të mirë të fëmijës, bashkëpunimin, koordinimin, monitorimin dhe llogaridhënien përmes institucioneve në nivel qendror, deri në nivel lokal, si dhe me organizatat e tjera që punojnë në fushën e mbrojtjes dhe përkujdesjes së fëmijës, integron sistemin e mbrojtjes së fëmijës duke siguruar një kuadër të plotë ligjor e institucional në zbatim të Kushtetutës, instrumenteve ndërkombëtare për të drejtat e fëmijës, ligjit dhe politikave ndërsektoriale, për t'iu përgjigjur kështu të gjitha formave për mbrojtjen e fëmijës.

Projektligji trajton të drejtën për jetë, mbijetesë dhe zhvillim, përgjegjësinë prindërore për mbrojtjen e fëmijës, interesin më të mirë të fëmijës, ndalimin ndaj diskriminimit si dhe shumë aspekteve të tjera, të cilat lidhen kryesisht me mbrojtjen e fëmijëve, të cilët ndodhen brenda territorit të Republikës, me shtetësi kosovare dhe ata që ndodhen jashtë Republikës së Kosovës me shtetësi kosovare, sipas legjislacionit në fuqi, me shtetësi jokosovare, pa shtetësi dhe atyre, të cilët janë të paregjistruar, por që ndodhen në territorin e Republikës së Kosovës.

Dispozitat e këtij projektligji nuk mund të merren si kufizim apo pakësim i të drejtave ekzistuese të fëmijës të përcaktuara në Kushtetutë, Konventën mbi të drejtën e fëmijës ose me marrëveshje të instrumenteve ndërkombëtare, pasi që i njëjti është në harmoni me aktet e lartpërmendura.

Kam nderin që pata rastin të paraqes para jush Projektligjin për mbrojtjen e fëmijës dhe njëkohësisht ju propozoj që ta miratoni, në mënyrë që çështjet të cilat rregullohen me këtë projektligj të vihen në suaza të kornizës ligjore adekuate. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, i nderuar ministër!

Të nderuar deputetë,

Pas prezantimit të Projektligjit, e hap debatin për diskutim në parim.

Ftoj së pari kryetaren e Komisionit FunkSIONAL për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, zonjën Lirije Kajtazi, të marrë fjalën.

LIRIJE KAJTAZI: Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione ka rekomanduar miratimin në parim të Projektligjit për mbrojtjen e fëmijës në mbledhjen e mbajtur më 12 korrik 2016.

Ky projektligj ka për qëllim mbrojtjen e fëmijëve nga të gjitha llojet e dhunës, abuzimit, keqpërdorimit, shfrytëzimit, lënien pas dore apo forma të tjera që vënë në rrezik jetën e tyre, sigurinë, shëndetin, edukimin, arsimimin dhe përgjithësisht zhvillimin e fëmijës.

Po ashtu, ky ligj ka për qëllim të garantojë e të sigurojë përgjegjësinë e prindërve, familjes, shoqërisë e të shtetit për kujdesin, mbrojtjen dhe zhvillimin e fëmijës bazuar në interesin më të mirë të tij.

Gjithashtu Projektligji ka për qëllim të sigurojë në interes të mirë të fëmijës bashkëpunimin, koordinimin, monitorimin dhe llogaridhënien ndërmjet institucioneve në nivel qendror dhe lokal, si dhe organizatat e tjera, të cilat merren me këtë kujdes.

Ky projektligj ka për qëllim të integrojë sistemin e mbrojtjes së fëmijës, duke siguruar një kuadër të plotë ligjor e institucional në zbatim të Kushtetutës, instrumenteve ndërkombëtare për të drejtat e fëmijës, ligjeve dhe politikave ndërsektoriale për t'u përgjigjur të gjitha formave në mbrojtjen e fëmijës.

Ky projektligj është hartuar në bazë të akteve të BE-së, ashtu siç e tha ministri kujdesshëm, në harmoni të plotë me përmbajtjen e këtyre akteve.

Siç e dini, edhe Kushtetuta jonë ka edhe Konventën për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës.

Në vazhdim gjatë punës tonë do të mundohemi të saktësojmë sistemin e referimit, kompetencat e niveleve qendrore e lokale, sidomos te pjesa e bartjes së buxheteve që është shqetësim dhe të cilin Komisioni gjatë punës së vet e ka parë se është një mangësi dhe mungesa buxhetore sigurisht se do të pengojë për t'i dhënë jetë vetë implementimit të ligjit.

Në projektligj shohim se shumë institucione obligohen të nxjerrin aktet nënligjore, të cilat, në mënyrë më specifike do t'i trajtojnë çështjet me të cilat do të bëhet ligji edhe më i zbatueshëm.

Në cilësinë e kryetares së Komisionit, e mbështes miratimin në parim të këtij Projektligji dhe ju ftojme edhe juve ta mbështetni dhe të jepni kontributin tuaj edhe në vazhdim, gjatë punës sonë dhe gjatë dëgjimit dhe çështjeve të tjera që do t'i kemi për bërjen e një ligji sa më të mirë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, e nderuar kryetare!

Radha është te kryetarët ose përfaqësuesit e grupeve parlamentare. Për Grupin Parlamentar të PDK, si duket është paraqitur Xhevahire Izmaqi. Urdhëroni, mund ta merrni fjalën!

Kërkoj falje, fjalën e ka deputetja Mexhide Mjaku-Topalli.

MEXHIDE MJAKU-TOPALLI: Përshëndetje, kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar Projektligjin për mbrojtjen e fëmijëve dhe vendosi që ta përkrahë këtë projektligj në parim.

Përmes këtij projektligji për mbrojtjen e fëmijës synohet të bëhet përmirësimi i gjendjes aktuale sa i përket mbrojtjes së fëmijës si dhe krijimi i një ambienti të sigurt për rritjen dhe zhvillimin e tyre.

Ligji siguron të gjitha masat e nevojshme për garantimin e jetës, mirëritjes dhe zhvillimit të fëmijës nëpërmjet një qasjeje të koordinuar ndërmjet aktorëve të ndryshëm që punojnë në fushën e të drejtave dhe të mbrojtjes së fëmijës.

Vlen të përmendet neni 13, me këtë nen parashihet krijimi i një këshilli ndërministror për mbrojtjen e fëmijëve, i cili këshill udhëhiqet nga kryeministri dhe përfaqësohet nga ministratë në nivel ministrash, gjë që kjo tregon se bashkëpunimi dhe bashkërendimi i punës është detyrim ndërmjet institucioneve përgjegjëse në nivel qendror e në nivel lokal, duke i obliguar të gjitha institucionet që t'i zbatojnë rekomandimet e këshillit ndërministror.

Është e vërtetë ajo që tha paraprakisht ministri se ekziston një kornizë e gjerë ligjore, me të cilën rregullohet mbrojtja e fëmijëve, por deri më tani shteti ynë nuk ka pasur një ligj të veçantë, sikurse e posedojnë vendet e tjera, i cili rregullon mbrojtjen e fëmijës në të gjitha fushat e jetës.

Ky projektligj ka nevojë të rishikohet dhe të specifikojë rolet se cilit departament i bien përgjegjësitë, siç është neni 16 pika 1 dhe 4 e këtij neni. Pastaj neni 21, pika 3, ku thotë se “institucionet sigurojnë kujdes dhe shërbime për fëmijën në nevojë”, por nuk është e precizuar saktësia e institucionit. Pastaj neni 22 - mbrojtja e fëmijës gjatë qëndrimit në strehim familjar, pika 1, nuk është definuar se cila ministri dhe cili departament ka përgjegjësi ndaj mbrojtjes së fëmijëve.

Andaj, projektligji për të siguruar saktësi ligjore, për të saktësuar departamentet përgjegjëse për ekzekutimin e detyrave të sipërpërmendura, e ka një mundësi për t'u ndryshuar gjatë periudhës deri në leximin e dytë, dhe kështu si është i ftoj të gjithë deputetët, si ata të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, po ashtu edhe juve, të nderuar kolegë, të votojmë Projektligjin për mbrojtjen e fëmijëve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, e nderuar deputete! Radha është te Grupi Parlamentar i LDK-së dhe është paraqitur Njomza Emini, apo Lirije Kajtazi. Urdhëroni, deputete, në emër të Grupit, apo?

LIRIJE KAJTAZI: Faleminderit!

Ishte zoti Etem Arifi, që për momentin po mungon, por po e mbuloj unë, meqë jemi në të njëjtin komision dhe kemi qëndrime të njëjta.

Lidhja Demokratike e Kosovës është kujdesur që të dalë një ligj sa më i mirë, për arsye se edhe në proceset, të cilat veç lëvizin gjatë proceseve të integritetit, edhe MSA ka ngritur me kujdes çështjen e përgatitjes së një kuadri më të mirë ligjor, i cili e rregullon këtë çështje dhe ato, të cilat përmenden në Komision, kompetencat e nivelit lokal e qendror, rritjen e vetëdijesimit dhe trajnimet në këtë fushë. Në gjatë monitorimit të njësive të drejtave të njeriut e kemi hasur këtë problem dhe kemi parë se është tepër e nevojshme që të investohet edhe në nivele lokale në këtë drejtim.

Ligji lë mundësinë e hapur që komunat të kërkojnë fonde, por nuk garanton mbështetje institucionale dhe ky është shqetësim për ne, të cilin do të mundohemi që gjatë amendamentimit ta plotësojmë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, e nderuar deputete! Grupi Parlamentar “Vetëvendosje”. Fjalën e ka Mytaher Haskuka.

MYTAHER HASKUKA: Këtu ministri paraqiti arsyetimin lidhur me ligjin, por para nja dy jave ne kemi marrë njëfarë shkrese nga zyrtarja e lartë për të drejtat e fëmijëve nga Zyra e Kryeministrit, e cila thotë se nuk ka pasur konsultime publike paraprake siç parashihet me Rregulloren e punës së Qeverisë, Nr. 09/11.

Këtu tash po vihet pyetje se kush ka të drejtë, do të thotë a është ajo që ministri po e thotë, apo zyrtarja e lartë për të drejtat e fëmijëve, e cila është në Zyrën për Qeverisje të Mirë të kryeministrit.

Ajo po ashtu thekson se edhe ajo vetë, si zyrtare e lartë, nuk ka pasur kohë ose nuk i është dhënë mundësia për ofrim të komenteve dhe kontributeve profesionale të saj lidhur me këtë projektligj dhe thotë se në këtë aspekt projektligji ka shumë mangësi dhe paraqet në 3 apo 4 faqe shumë komente të ndryshme lidhur me Projektligjin se si ai ka probleme të shumta në çështje të ndryshme.

Dhe, po ashtu, edhe unë duke e shikuar ligjin, mund të vërej se ka shumë probleme, sidomos në aspektin e gjuhës, e cila po shihet se është njëfarë përkthimi nga një ligj i huaj dhe në atë aspekt gjuha është deklarative dhe nuk është përcaktuese, nuk është specifike. Shumë dispozita janë të

shumëkuptimta, që do të thotë se nuk ka çështje specifike me të cilat ne mund të kuptojmë mirë ligjin.

Pastaj, në këtë aspekt, po ashtu edhe renditja kronologjike nuk është në rregull.

Ne po themi se ky ligj është për mbrojtjen e fëmijëve nga diskriminimi, por në të njëjtën kohë, ky ligj nuk ofron kurrfarë, për shembull, mbrojtje nga Ligji për ndihmë sociale, i cili, për shembull, parasheh që kur fëmijët të mbërrijnë moshën pesëvjeçare t'u ndalohen ndihmat sociale.

Pra, në këtë aspekt, ky ligj nuk ofron kurrfarë mbrojtje nga ligji tjetër, i cili diskriminon familjet të cilat kanë fëmijë mbi pesëvjeçar.

Pastaj, në shumicën e ligjit shohim se është më shumë ligj reagues, nuk ka dispozita parandaluese dhe ndoshta ne, nëse themi mbrojtjen e fëmijëve, ligji duhet të parashohë shumë aspekte parandaluese. Do të thotë, duhet të jetë për parandalim, për mbrojtje, e jo ligj reagues ndaj shkeljes së të drejtave të fëmijëve.

Po ashtu, ligji, siç thashë, meqë është si një përkthim, po shihet se është përkthues, nuk është obligues. Ka shumë fjali dëshirore. Domethënë, ligji dëshiron të mbrojë të drejtat e njeriut, por nuk i obligon institucionet ta bëjnë një gjë të tillë, prandaj mbetet shumë abstrakt dhe nuk është konkret dhe gjithmonë kur ligjet janë abstrakte, nuk kanë zbatim. Pra, problemi kryesor i Kosovës është se ne kemi plot ligje, të cilat nuk zbatohen. Do të thotë, rrinë nëpër sirtarë, nuk ka buxhet. Dhe ky ligj, faktikisht, është një ndër ato ligje, i cili do t'u bashkëngjitet këtyre ligjeve abstrakte, e të cilët nuk kanë buxhet, nuk kanë kurrfarë implementimi real dhe nuk do ta ndryshojnë jetën e njerëzve në Kosovë, e në këtë aspekt, as nuk do të ndikojë në përmirësimin e jetës së fëmijëve në Kosovë.

Pra, në këtë aspekt, nëse i marrim parasysh komentet edhe të zyrtares për të drejtat e fëmijëve nga Zyra për Qeverisje të Mirë në Zyrën e Kryeministrit, ne nuk do t'i bashkëngjitemi dhe nuk do ta aprovojmë këtë ligj ashtu si është. Prandaj duhet të ketë konsultime, duhet dhënë mundësia Zyrës për Qeverisje të Mirë t'i japë komentet e saj dhe të rregullojë këtë ligj, e pastaj të na vijë këtu e ta votojmë prapë, po dua të them, se ne do të abstenojmë nga votimi i këtij ligji.

KRYESUESI: Faleminderit, i nderuar deputetë! Fjalën e ka Grupi Parlamentar Sërpska lista, Slavko Simiq.

SLAVKO SIMIĆ: Zahvaljujem se predsedavajući!

Parlamentarna grupa Srpske liste razmatrala je Nacrt zakona o zaštiti deteta i s obzirom da ovaj zakon ima za cilj zaštitu deteta od svakog oblika nasilja, zlostavljanja, zloupotrebe, iskorišćavanja, zapostavljanja ili drugog oblika koji ugrožavaju život, sigurnost, zdravlje, vaspitanje, obrazovanje i razvoj deteta a takođe i obezbeđuje i garantuje roditeljsku, porodičnu, društvenu i državnu odgovornost za staranje, zaštitu i razvoj deteta u najboljem njegovom interesu, Parlamentarna grupa Srpske liste u načelu podržava Nacrt zakona o zaštiti deteta i mi ćemo danas dati podršku ovom zakonu a ujedno ćemo i dati doprinos kroz funkcionalne, odnosno kroz stalne komisije za polnu ravnopravnost, nestala lica i peticije da se ovaj zakon

dizajnira najoptimalnije kako bi prilikom drugog čitanja on bio podržan od svih poslanika. Zahvaljujem!

KRYESUESI: Faleminderit, i nderuar deputet! Radha është te Grupi Parlamentar 6+. Fjalën e ka deputeti Kujtim Paçaku.

KUJTIM PAÇAKU: Faleminderit, kryesues!

I nderuar kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Edhe ne si pjesë e Grupit Parlamentar për të Drejtat e Njeriut kemi shqyrtuar dhe debatuar goxha për këtë ligj. Në Komision unë kam abstenuar me qëllim, sepse nuk e kam parë ligjin të kompletuar, një ligj siç u dëgjua edhe më herët, që duhet të jetë ligj me karakter parandalues, e jo me karakter dëshirues.

Kur është fjala te ligji për mbrojtjen e fëmijëve, atëherë nëpërmjet akteve nënligjore, gjegjësisht nëpërmjet amendamenteve në leximin e dytë do të kërkojmë që ky ligj të jetë i fokusuar më tepër edhe te fëmijët e komunitetit rom, nga se nuk ka fokusim aspak. Ne jemi dëshmitarë që secili prej nesh, edhe në Prizren, edhe në Gjakovë, edhe në Gjilan, edhe në Mitrovicë, edhe në Pejë hasim fëmijë lypsarë. Askush nëpërmjet ligjit, që 17 vjet nuk e ka luftuar këtë dukuri negative, e cila shfaqet në Kosovë.

Dëshiroj që në leximin e dytë, gjegjësisht gjatë leximit të dytë me amendamente dhe akte nënligjore të jetë i dedikuar, gjegjësisht të jetë i sforcuar te pjesëtarët e komunitetit rom, posaçërisht te fëmijët.

Është relevante të bisedohet edhe për një ligj tjetër, përkatësisht për një kategori tjetër jo të fëmijëve, por të foshnjave të komunitetit rom, për çka kemi informata se vdekshmëria e foshnjave të komunitetit rom është 3 herë më e madhe se sa e komuniteteve të tjera.

Vdekshmëria e foshnjave të komunitetit rom në Kosovë është shumë më e lartë se sa te komunitetet e tjera. Dallim shumë i madh është edhe te treguesit e tjerë, se vdekshmëria neonatale apo postnatale, apo vdekshmëria e fëmijëve që prej lindjes deri në datëlindjen e pestë. Një studim nga UNICEF thotë se – tregimet e anketave të grupeve treguese të shumëfishta tregojnë se që në vitin e kaluar janë nxjerrë këto të dhëna të mirëfillta me metodologji shkencore rreth kësaj çështjeje.

Po flasim edhe për një kategori shumë të ndjeshme, tanimë jo të fëmijëve, por të foshnjave. Derisa vdekshmëria e foshnjave në Kosovë është 12 në 1 000, foshnjat e lindura gjallë te komuniteti rom është 41 në 1 000, apo gati trefish më e lartë.

Ky dallim është po kaq drastik edhe te treguesit e tjerë se vdekshmëria neonatale 29 kundrejt 9 në 1 000. Vdekshmëritë postnatale dhe neonatale 12 kundrejt 3 në 1000 apo vdekshmëria e fëmijëve prej lindjes deri te datëlindja e pestë, 49 kundrejt 5 në 1 000 lindje të gjalla.

Këto të gjitha forma negative po shfaqen tek te dy kategoritë tani, edhe te fëmijët, edhe te foshnjat.

Nuk është vetëm te komuniteti rom, e kjo ndodh edhe te pjesëtarët e komuniteteve të shtresës së varfër.

Unë plotësisht e përkrah zotin Haskuka, kur thotë se në këtë ligj aspak nuk bisedohet edhe për atë se fëmijët e tërë Kosovës humbin të drejtën për ndihmë sociale, përkatësisht për përfitimin e ndihmës sociale, që një ditë pas pesë vjetësh e humb të drejtën e ndihmave sociale. Ky ligj edhe dëmton rëndë pjesëtarët e komunitetit rom, andaj gjatë leximit të dytë, me amendamente do të kërkojmë që ky ligj të votohet pas leximit të dytë, por tani pasi që është lexim i parë, unë do ta votoj, në të dytin nuk do ta votoj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, i nderuar deputet Paçaku! Vazhdojmë me diskutimet sipas radhës së paraqitjes së deputetëve. Fjalën e ka deputetja Xhevahire Izma.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Sidoqoftë, unë si deputete e përshëndes sponsorimin nga ana e Qeverisë së këtij ligji, i cili edhe pse kemi vërejtje, ka mundësi të plotësohet gjatë leximit të dytë, por megjithatë unë mendoj se do ta plotësojë rregullativën ligjore, e cila i ka munguar Kosovës dhe në këtë drejtim kam shpresa se ministri i Punës, por edhe ministri i Arsimit e kanë një punë apo obligim shumë të madh gjatë implementimit, për arsye se shumë amendamente varen prej institucioneve, të cilat drejtpërdrejt menaxhohen nga këto dy ministri.

Unë do të ndalem vetëm në tri nene. Pra, është çështja te neni 24, pra ndalimi i ndëshkimit trupor. E thanë edhe kolegët e mi pak më herët, sepse teksti dhe përkufizimi mendoj se duhet të jetë shumë më i sforcuar.

Nëse ne e lëmë të tillë, siç është personeli arsimor dhe personeli i lidhur me shkollën nuk duhet të përdorin ndëshkimin trupor, mendoj se është një masë shumë e lehtë, e cila do të përkthehet në atë mënyrë që ata nuk do të obligohen të kenë parasysh një ndëshkim trupor. Është edhe qëndrimi në një këmbë që e përdorin shumë edukatorët tanë nëpër shkolla, ku ne fatkeqësisht kemi parë viteve të fundit edhe skena të këqija, të cilat asnjëherë nuk e di si kanë përfunduar, do të thotë, nëse është dënuar një profesor, por qoftë edhe nxënës kur e ka kthye atë dhunë të përdorur nga ana e mësimit.

Pastaj, tek neni 25, ku kemi mbrojtjen e së drejtës për privatësi, që është një fushë e gjerë, e cila përfshin edhe ligje të tjera. Pra, nuk është decidivisht e përcaktuar te çështja e privatësisë, ku përfshihet edhe komunikimi.

Duke ditur se sot ne jetojmë në një botë të re të komunikimit, kemi mundësinë që fëmijët t'i shohim se kanë qasje shumë të mundshme në portale dhe ueb-faqe, të cilat nuk u takojnë moshës së tyre, ne kemi nevojë që edhe në ligj të përkufizojmë moshën. Pra, ndryshe është kur ne mund të kontrollojmë një privatësi, e cila i takon një fëmije 4 vjeç, 6 vjeç ose 9 vjeç dhe ndryshe do të flasim për një fëmijë, i cili është në moshën 17-vjeçare dhe një prind mund t'ia kontrollojë Facebookun, të themi kushtimisht.

Pra, pasi Kosova ende nuk e ka një ligj të përdorimit të internetit, ne sigurisht se duhet të kemi parasysh që gjatë amendamentimit të kemi kujdes në këtë çështje, sepse janë dy gjëra, pra privatësia, por është edhe mbrojtja e fëmijës nga vizita e faqeve të ndryshme, të cilat e dëmtojnë dinjitetin dhe rritjen e fëmijës.

Mendoj që te neni 42, ku i kemi epërsitë e ligjit, ne shohim se tendencë dhe ambicie që ky ligj të jetë me përparësi të dispozitat që dalin nga ligjet e tjera dhe për këtë arsye, besoj se ne do të kemi punë shumë në amendamentimin gjatë leximit të dytë.

Pra, nëse ky ligj ka përparësi, atëherë dispozitat e tij duhet të jenë shumë të qarta, që i përmendën edhe kolegët e mi më herët, kanë kryesisht punë qendrat sociale, të cilat shpeshherë janë ankuar se kanë mungesë legjislacioni dhe nuk dinë si të sillen në raste të ndryshme të kujdestarisë së fëmijëve.

Pra, unë do të votoj për dhe besoj se do të jap kontributin gjatë amendamentin në leximin e dytë. Faleminderit!

KRYESUESI: Zonja Emini e ka fjalën.

NJOMZA EMINI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë!

Me që jemi në shqyrtimin e parë të Projektligjit për mbrojtjen e fëmijëve, konsideroj që është një moment i veçantë për neve që në mënyrë të përbashkët të kemi mundësi që t'i ndajmë edhe rekomandimet apo edhe sugjerimet për Komisionin për të Drejtat e Njeriut dhe shumë mirë e tha edhe kolegja ime, njëherësh edhe kryetarja Lirije Kajtazi, për rëndësinë e këtij projektligji.

Unë do të ndalem te disa sugjerime apo edhe rekomandime që konsideroj se janë të nevojshme në këtë fazë.

Në radhë të parë, edukimit në familje, në çerdhe dhe në shkollë duhet t'i kushtohet kujdes i veçantë nëpër të gjitha fazat e edukimit të tyre. Pastaj edhe reduktimi medial: ne jemi dëshmitarë që në mediat tona emisionet nuk përkufizohet, apo ndonjë film, që të përcaktohet edhe mosha, sepse fëmijët nuk e dinë, pra të përcaktohet se çfarë të mos shohin fëmijët.

Po ashtu edhe te edukimi kulturor, duhet të njihen fëmijët me kulturën e tyre kombëtare, pastaj edhe me kulturën universale. Kjo duhet të bëhet me një kujdes të përhershëm dhe sistematik.

Po ashtu edhe risocializimi i atyre fëmijëve që nuk u përshtaten rrethanave të shoqërisë sidomos në ambientet urbane. Duhet të krijojmë mundësi për trajtimin e tyre aty ku ka nevojë.

Largimi nga dukuritë e këqija, nga rruga e keqe, siç janë lypësit, e të tjerë.

Kosova duhet të krijojë programe të caktuara, edukim për një shtresë fëmijësh edhe jashtë orarit të mësimi, domethënë këtu kam një apel te Ministria e Arsimit që të mendojë të hartojë edhe

programe jo vetëm gjatë shkollës, por edhe mbas shkollës, në mënyrë që fëmijët të jenë të zënë dhe të mos u krijohen hapësira për dukuri të këqija.

Gjithashtu që të mos bien në grackën e keqpërdorimeve të ndryshme në Kosovë duhet të rritet dhe të edukohet fëmija i shëndoshtë dhe i pasuruar me dituri për çdo ditë.

E ardhmja e fëmijëve tanë është e ardhmja demokratike e Kosovës dhe e zhvillimit të shtetit tonë, këtë ne çdo herë e themi, por kjo duhet të jetë në mënyrë praktike, jo vetëm deklarative.

Prandaj, ligji duhet të jetë i qartë dhe funksional për mbrojtjen e të drejtave të tyre, sfidat po ashtu, siç e dini, të njëvjeçarit janë të pakontestueshme për fëmijët, sidomos duhet të punojmë fuqishëm.

Kultura shëndetësore e fëmijëve është tejet e rëndësishme, me mijëra fëmijë vdesin për neglizhencë. Ne jemi të vetëdijshëm edhe kemi parë që sa fëmijë vdesin për një pakujdesi apo për një neglizhencë nga institucionet përkatëse apo edhe për një mungesë trajtimi ndaj tyre.

Edhe procesi i integritetit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, siç e tha edhe kolegia ime, zonja Lirije, kërkon kuadër ligjor më të avancuar për të rregulluar mbrojtjen e fëmijës në mënyrë më të mirë, domethënë edhe ky ligj, por edhe ligjet e tjera për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve si dhe institucioni i Avokatit të Popullit me të madhe ndikojnë në kualitetin dhe mbrojtjen e fëmijëve.

Po ashtu edhe përdorimi i narkotikëve, domethënë sipas hulumtimeve të fundit me atë sa kam lexuar dhe kam vërejtur, është një numër i konsiderueshëm i fëmijëve që përdorin substancat narkotike. Kjo është shqetësuese, mendoj dhe duhet të reagojmë në mënyrë që të mos kemi aq shumë fëmijë përdorues të narkotikëve.

Po ashtu, kjo është një çështje komplekse, sepse jo vetëm një institucion, por edhe ministritë, si për shembull, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe e Sportit të mendojnë që të hartojnë edhe programe, por edhe aktivitete kulturore që të jenë krenarë edhe ata me kulturën e tyre kombëtare.

Nuk e qartëson po ashtu mirë edhe ky projektligj përgjegjësinë e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Zyrës për Qeverisje të Mirë në Kryeministri, domethënë këtu duhet të kemi më shumë qartësim.

Unë konsideroj që Komisioni për të Drejtat e Njeriut, në bashkëpunim me Komisionin për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, kur vjen puna të amendamentimi që të takohen së bashku, por edhe me Komisionin për Integritet Evropian që të shohin mundësitë, meqë jemi në shqyrtim të parë, t'i japim rekomandimet tona që të jetë ky ligj sa më i mirë dhe në shërbim të fëmijëve dhe në mbrojtjen të tyre. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radhën e ka zonja Haxhiu.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Ndonëse qëndrimet e Grupit Parlamentar për këtë projektligj i paraqiti deputeti Haskuka. Unë do të mundohem vetëm disa nga çështjet t'i përmend gjatë kësaj kohe që kam në dispozicion.

Ky Kuvend disa herë ka diskutuar për gjendjen e fëmijëve në vend dhe gjithë jemi dëshmitarë se gjendja e tyre është jashtëzakonisht e rëndë dhe pajtohem me deputetin që përmendi komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, gjendja e të cilëve është edhe më e rëndë.

Pra, ka kohë që ky Kuvend edhe ka nxjerrë rekomandime për proceduar Qeveria Projektligjin për mbrojtjen e fëmijëve.

Dhe, natyrisht që ky projektligj lë shumë për të dëshiruar, për shkak se ka shumë paqartësi, ka shumë kundërthënie ndërmjet neneve, lë hapësira interpretimi që besoj që do të jetë goxha vështirë për t'i zbatuar.

Neve si subjekt politik na kanë ardhur shumë vërejtje nga organizatat e shoqërisë civile që merren me të drejtat e fëmijëve, e po ashtu edhe nga grupet e tjera të interesit.

Këtu po thuhet që ka pasur një konsultim me këto grupe të interesit, unë në fakt nuk e di se me cilat grupe të interesit ose me cilat organizata të shoqërisë civile është konsultuar Qeveria.

Do të doja të parashtroja një pyetje sa i përket buxhetit për këtë projektligj. Me që është ministri i Financave këtu, Abdullah Hoti.

Në rekomandimin e Ministrisë së Financave thuhet që ky projektligj nuk ka implikime buxhetore, në ndërkohë në qoftë se e shohim këtë projektligj, e kuptojmë që ka shumë implikime buxhetore dhe hyrja në fuqi e këtij projektligji parashihet të jetë një vit pas publikimit në Gazetën Zyrtare. Unë besoj që kjo është gabim jashtëzakonisht i madh, për shkak se ky ligj do të duhej të hynte në fuqi menjëherë pas publikimit në Gazetën Zyrtare.

Mirëpo pyetja që doja t'ia bëja zotit Hoti është: si ka mundësi që ky ligj të mos ketë implikime buxhetore? Në qoftë se i shohim nenet e këtij projektligji natyrisht që ka shumë implikime buxhetore. Ky Kuvend voton ligje për t'i zbatuar institucionet konkrete dhe jo për të mbetur në sirtarët e institucioneve që e kanë obligim për t'i zbatuar këto projektligje.

Unë i bëj thirrje Komisionit Funkcional që ta ndryshojë nenin 48 që ka të bëjë me hyrjen në fuqi dhe të bëjë presion te Qeveria që të ndajë buxhet për këtë projektligj.

Natyrisht që ne amendamentet tona do t'i procedojmë përmes deputetit Haskuka. Zonja Izmaku e përmendi edhe ndëshkimin e fëmijëve nëpër kopshtet publike apo private. Unë do të doja që të gjitha komunat ta marrin shembullin e Komunës së Prishtinës, ku shumë shpejt do të vendosen kamerat në secilën institucion parashkollor.

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Fikrim Damka.)

KRYESUESI: Faleminderit, zonja Haxhiu! Fjalën e ka deputetja Salihe Mustafa.

SALIHE MUSTAFA: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë!

Pa dyshim që është shumë me rëndësi që sot e kemi para vetes një projektligj për herë të parë, Projektligjin për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

Unë si anëtare e komisionit kam disa vërejtje sepse është normale që ligjet e hartuara nga Qeveria kanë vërejtje, për atë jemi ne si deputetë dhe si komisione për t'i përmirësuar dhe amendamentuar ato.

Kam vërejtje të përkufizimet, prandaj të neni 22, 28 dhe të disa nene të tjera.

Por ajo që është me rëndësi unë dua ta falënderoj ministrin Abrashi për prezantimin e këtij projektligji para nesh, por ajo që konsideroj unë që është problem, është sepse ky projektligj nuk ka adresë kush do ta implementojë.

Ky projektligj është sjellë nga zyra e kryeministrit, Zyra për Qeverisje të Mirë dhe ne si deputetë kemi përvoja jo të mira në implementim të këtyre ligjeve, sidomos Ligji për persona të verbër.

Gjatë monitorimit kemi hasur në probleme në zbatim, sepse nuk ka adresë të saktë kush është implementues i këtij ligji.

Kisha kërkuar nëse ka mundësi që Ministria e Punës dhe Mirëqenies të jetë implementuese, bartëse e këtij ligji, nëse ka mundësi. Përndryshe me këtë ligj rregullohen të drejtat e fëmijëve me shumë ligje të tjera dhe tani është problem harmonizimi me ligje të tjera, ka shumë punë. Nëse nuk harmonizohet ky projektligj me ligjet që janë në fuqi, atëherë vetëm do të sjellë probleme në implementim.

Unë i kisha ftuar edhe kolegët deputetë të gjithë, e sidomos ata që sot ishin aktiv në diskutime, konkretisht të na ndihmojnë në komision, të jenë prezentë sidomos Komisioni për Shëndetësi, por edhe ata që diskutuan sot me propozime konkrete të na ndihmojnë në komision, kështu që bashkërisht do ta bëjmë një projektligj të zbatueshëm. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, deputete! Fjalën e ka Gëzim Kelmendi.

GËZIM KELMENDI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar ministra,

Deputetë të nderuar!

Duke pasur parasysh vërejtjet e shumta që u dhanë për këtë projektligj nga kolegët deputetë, atëherë është e udhës që ministria, si sponzorizues i këtij projektligji, ta tërheqë mbrapa këtë projektligj, ju i dini edhe rregullat: kur një projektligj ka vërejtje të mëdha përmbajtjesore, duhet të kthehet prapa në Qeveri, të korrigjohet dhe pastaj përsëri të sillet në Kuvend, në mënyrë që të mos i humbë vlera dhe pesha e këtij projektligji, pra të mos jetë vetëm në korrigjim dhe përpunim në anën e Komisionit Parlamentar.

Duke pasur parasysh vërejtjet e mëdha që u bënë sot nga shumica e kolegëve deputetë, është e udhës që ministria përkatëse ta tërheqë prapa këtë projektligj dhe të na sjellë një projektligj më produktiv për mbrojtjen dhe sigurinë e fëmijëve në Kosovë.

Nuk do koment që vite me radhë siguria e fëmijëve të Kosovës nuk është në nivelin e duhur. Kur flasim për sigurinë dhe mungesën e kujdesit ndaj tyre, fjala kryesore bie te fëmijët e komuniteteve në Kosovë, veçanërisht të komuniteteve egjiptian, ashkali dhe rom, të cilët fatkeqësisht nuk kanë trajtim shtetëror dhe institucional sa duhet, nuk kanë kujdes sa duhet. Kemi parë vite me radhë kur edhe fëmijët nga mungesa e përkujdesjes adekuatë institucionale kanë qenë viktimë edhe e qenve endacakë në rrugët e Kosovës. Prandaj, ne si shtet duhet të merremi më shumë me kujdesin ndaj tyre.

Në anën tjetër, edhe unë nuk pajtohem fare me Projektligjin për mbrojtjen nga skemat sociale, ku një fëmijë nëse ka kaluar moshën pesëvjeçare privohet familja e tij nga skema sociale.

Kjo politikë zhvillimore e zvogëlon apo, më mirë të thuhet, e rëndon edhe më shumë situatën në Kosovë që e kemi, duke u ballafaquar këto vite pas luftës me rënie të natalitetit. Në vend që Qeveria dhe shteti ynë të merret me politika zhvillimore të ruajë dhe të rritë natalitetin, ne jemi duke bërë politika që të ulim natalitetin, nga se çdo familje që e ka një fëmijë mbi moshën 5-vjeçare privohen nga skema sociale.

Prandaj, pa dashur të zgjas më shumë, ne gjithë jemi dëshmitarë se si po privohen edhe familjet nga skema sociale, si shëndeti dhe siguria e fëmijëve kosovarë nuk është në nivelin e duhur.

Kërkoj nga ministria si sponzorizuese e projektligjit ta tërheqë prapa këtë projektligj dhe të hapë rrugën për një projektligj të ri, më produktiv dhe më të mirë të jetë në Kuvendin e Kosovës.

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Pajaziti e ka fjalën.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë!

Jam në vijën e mbështetjes së këtij projektligji, është mirë që e kemi më në fund këtë projektligj.

Ndoshta është koha kur në mënyrë përmbajtjesore kjo shoqëri dhe institucionet e këtij vendi t'i trajtojnë të drejtat e fëmijëve dhe të kujdesen për ta. Pasi duhet trajtuar më seriozisht, nuk e pata ndërmend ta marr fjalën, por u theksua disa herë diçka që e kemi vërejtur, puna e adresimit të përgjegjësive.

Nëse disa herë radhazi ndër lëshimet ose mangësitë e institucioneve të vendit është adresuar moskoordinimi i institucioneve, atëherë nëse në ligj nuk precizohen këto përgjegjësi, atëherë do të jetë vështirë të implementohet ose ta kryejë misionin e vet ky ligj.

Besoj që me këto dokumente rrjedhëse të ligjit këto do të plotësohen.

Po ajo që dëshiroj të them, ministër, është që pavarësisht ligjit, mendoj që ti si ministër edhe mund t'i koordinosh në një mënyrë disa aktivitete për të bërë diçka në kuadër të kompetencave të tashme legislative dhe kushtetuese për sa i përket mbrojtjes së drejtës së fëmijëve.

Është e patolerueshme që në çdo ditë që ecim nëpër kryeqytet ose në qytete të tjera ndalemi në semafor dhe kemi fëmijë aty që abuzohet me ta në mënyrë të paligjshme, shkojmë për kafe diku dhe shërbejnë fëmijët, aty ose ka lypsar, ose shesin.

Mendoj që me një koordinim të aktiviteteve tuaja me institucionet e tjera me këtë bazë ligjore do të mund të bëhej diçka. Mendoj që është si për qytetarët, për fëmijët, të atyre që vijnë këtu, të miqve tanë, po edhe e shoqërisë tanë, është një dobësi shumë e madhe që po na përcjell me vite dhe mendoj që nuk ka qenë krejt puna te ligj.

Është mirë që e kemi tash këtë ligj, edhe unë uroj që ky të bëhet dhe të jetësohet sa më shpejt. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Brovina e ka fjalën.

FLORA BROVINA: Faleminderit, kryesues!

Më vjen mirë që Ligjit për të drejtat e fëmijëve ndodhet në Kuvendin e Kosovës.

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale nuk e ka shqyrtuar si komision këtë çështje. Por unë do të flas në pika të shkurta për këtë ligj.

Ligji vërtet nuk ka një adresë ekzekutive ose të detyrueshme, por ai edhe tani ka shumë adresa.

Në asnjë ligj që kemi aprovuar në Kuvendin e Kosovës nuk kemi shkelur ose jemi munduar të mos i shkelim të drejtat e fëmijëve dhe gjithnjë është vepruar në të mirën e tyre.

Prandaj, ky ligj ka adresë të gjitha ministritë që merren me çështjen e fëmijëve dhe kujtoj që në bashkëpunim të ngushtë, tani më të shpallur në mes të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, ku janë edhe të drejtat e fëmijëve edhe Komisioni për Shëndetësi Punë dhe Mirëqenie Sociale, jemi marrë vesh që të punojmë më tutje bashkë dhe të koordinohemi qoftë edhe në debatet dhe tryezat që do të organizohen dhe të këmbejmë edhe përvojat e të tjerëve që t'ia adresojmë përgjegjësitë reale secilit që i takon. Ta zëmë, nëse është mbrojtja e të drejtave në shëndetësi, në arsim ose në mirëqenien sociale.

Prandaj, puna që e pret Komisionin për të Drejtat e Njeriut, së bashku me Komisionin për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale do të jetë e përbashkët në amendamentimin e tij dhe besoj që do të kem adresa secili obligim që rrjedh nga ky ligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka tjerë të paraqitur. Nuk ka as kuorum për të votuar.

Ministër, e do fjalën? Jo!

Atëherë po vazhdojmë me pikën e dhjetë të rendit të ditës:

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për kamatëvonesat në transaksionet tregtare

Shqyrtimi i këtij projektligji do të bëhet në pajtim me vendimin e sotëm të seancës plenare.

Komisioni Funkcional, në mbështetje të nenit 58 të Rregullores së Kuvendit e ka shqyrtuar projektligjit dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim në parim.

Ftoj ministrin e Tregtisë dhe Industrisë, zonjën Hykmete Bajrami, që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin.

MINISTRIJA HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës!

Ministria e Tregtisë dhe e Industrisë në vazhden e aktiviteteve të veta për të përmirësuar ambientin e biznesit ka hartuar Ligjin për kamatëvonesat në transaksionet tregtare.

Objektiv i këtij projektligji është krijimi i bazës ligjore të mirëfilltë, përcaktimi i rregullave, pra afatet dhe mënyrën e llogaritjes së kamatëvonesave në rastet e furnizimit me mallra dhe shërbime nga ana e shoqërive tregtare kundrejt shoqërive të tjera tregtare dhe autoriteteve publike, në mënyrë që të sigurohet funksionimi i duhur i tregut, duke nxitur aftësim konkurruesit e shoqërive tregtare, e në veçanti të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

Ligji synon zvogëlimin e rasteve të pagesave të vonuara, në mënyrë që të kontribuoj në funksionimin e duhur të tregut dhe në nxitjen e konkurrencës të shoqërive tregtare.

Pra, zbatohet për të gjitha llojet e pagesave dhe detyrimeve, të cilat janë bërë si shpërblim për transaksionet tregtare.

Në përgjithësi, Ligji për kamatëvonesat dhe transaksionet tregtare ka rëndësi të veçantë në procesin e mbledhjes së kredive, pasi që rregullon pagesat e vonuara të kredive.

Ligji synon procesin e vendosjes të kamatëvonesave dhe përcakton metodën e vendosjes së tyre dhe metodën e llogaritjes dhe vlerësimit të kamatëvonesave.

Gjithashtu obligon institucionet financiare që të informojnë hollësisht debitorin për pasojat dhe kushtet e vonesave në kthim të kredisë.

Ligji synon të arrijë një ndryshim thelbësor për një kulturë të pagesës në kohë të shpejtë dhe kërkon debitorëve të paguajnë kamatëvonesat dhe shpenzimet e arsyeshme dhe dëmshpërblimi të kreditorit, në qoftë se ata nuk paguajnë për mallrat ose shërbimet me kohë.

Duhet t'ju themi që ligji pjesërisht bënë transfuzimin e direktivës evropiane 2011 duke iu përshtatur, për shkak se kemi pasur vështirësitë tek transpozimi për publikimin e normave të interesit, e cila është vendosur gjatë konsultimit publik që të jepet një afat 5-vjeçar për transfuzimin e plotë të kësaj direktive me draftligjin me këtë version të tanishëm.

Përcaktimi i normave të interesit bëhet sipas akteve nënligjore, të cilat do të shtjellohen dhe praktikave të Bankës Qendrore të Kosovës.

Edhe një sqarim, Ligji për kamatëvonesat është ligj special, i cili trajton kamatëvonesat, e të cilat nuk janë të trajtuara mjaftueshëm dhe rregulluar në Ligjin për marrëdhëniet detyrimore.

Prapë me draftligjin që kemi sjellë këtu te ju palët mund të kontraktojnë dhe mund të përcaktojnë kamatëvonesat, mund të përcaktojnë interesat për kamatëvonesa në bazë të parimeve të tregut të lirë dhe në bazë të kontratave të tyre, mirëpo, në rast se këto nuk përcaktohen me kontratë, atëherë aplikohen dispozitat e këtij ligji.

Ligji ka kaluar të gjitha procedurat. Andaj, unë ju falënderoj që për shkak të rëndësisë që ka, ju sot edhe e futët në rend të ditës, gjithashtu pres që ligji të përmirësohet me amendamentet e deputetëve gjatë dy leximeve dhe ju ftoj që ta votoni sot. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja ministre! Tani po vazhdojmë me diskutimin në parim të projektligjit.

Radha është e kryetarit të Komisionit Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, zotit Mustafa.

MUHAMET MUSTAFA: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë!

Siç e theksoi edhe ministrja, ne kemi një procedurë të rregullt, ne kemi trajtuar këtë diskutim dhe për rëndësinë e tij unë fola edhe kur ju luta që ta fusim në rend të ditës, meqenëse jemi para pushimeve dhe vonesa në trajtimin e tij nuk do të ishte ndoshta aq e dobishme.

Komisioni gjatë trajtimit ka vlerësuar se ka projektligj ka një rëndësi të madhe për përmirësimin e mjedisit biznesor siç tha ministrja, sepse i kontribuon përmirësimit të rrjedhave financiare, lehtësimit të transaksioneve biznesore dhe rritjes së likuiditetit të bizneseve dhe aktorëve të tjerë në marrëdhëniet kontraktuale.

Ai e ngre kulturën e pagesës me përgjegjësi, ndikon në zvogëlimin të borxheve, të cilat tani më u paraqesin problem edhe në funksionimin e bizneseve private, por edhe ndërmarrjeve publike dhe në përgjithësi aktorëve të tjerë në aktivitetet biznesore.

Gjatë diskutimit anëtarët e komisionit ngritën disa çështje posaçërisht lidhur me përputhjen me direktivat evropiane që do t'i trajtojmë me kujdes gjatë leximit të dytë.

Pastaj, në aspektin e kontraktimit të marrëdhënieve mes bizneseve, periudhën e caktimit të kamatës referente nga Banka Qendrore e Kosovës si dhe qartësimin të formulimeve në disa paragrafëve të këtij projektligji.

Pas këtij diskutimi komisioni e ka aprovuar njëzëri dhe i ka rekomanduar Kuvendit që ta aprovojë në parim ligjin dhe gjatë procedurës së leximit të dytë çështjet e ngrita që unë i sqarove

dhe që ministria po ashtu i vuri në rend të ditës, ne do t'i përmirësojmë në bashkëpunim me aktorët e interesuar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e grupeve parlamentare. Grupi Parlamentar i PDK-së, fjala për Sala Berisha Shalën.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, nënkryetar!

Përsëritje kolegjë deputetë,

Ministra,

Ju të pranishëm!

Edhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka analizuar Projektligjin për kamatëvonesat me transaksione tregtare dhe e kemi mbështetur në parim. Edhe përfaqësuesit tanë në Komisionin Parlamentar i kanë pasur disa vërejtje që shpresojmë se gjatë fazës mes dy leximeve do të bëhen përmirësime të duhura dhe shpresojmë që do të vijë në nivelin e duhur.

Vlerësojmë se është i nevojshëm, i kontribuon frymës së lehtësimit të bizneseve dhe të tjerave. Ju ftoj që ta përkrahni, kolegjë deputetë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i LDK-së, nuk është paraqitur askush. Zoti Fatmir Rexhepi.

FATMIR REXHEPI: Faleminderit!

Përsëritje kryesues,

Kolegjë deputetë!

Edhe Grupi Parlamentar i LDK-së e vlerëson në parim dobishmërinë e këtij projektligji dhe nevojën që e ka për të rregulluar këtë fushë dhe për të ndihmuar bizneset në relacionet e tyre afariste.

Prandaj edhe leximin që e kemi bërë në komision, por edhe si grup parlamentar mendojmë në procedurën e mëtutjeshme ne do t'i përmirësojmë edhe ato pjesë të cilat u thanë nga kryetari i komisionit dhe projektligji do të jetë në funksion të biznesit dhe asaj që është në të mirën e tyre. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar “Vetëvendosje”, e do fjalën dikush? Jo!

Srpska lista? Niko, u redu je sve.

Ministre, e do fjalën si përfundim? Jo!.

Nuk ka prapë kuorum. Po më duket ka humbur edhe interesimi. A doni ta lëmë për nesër ta vazhdojmë, nuk ka kuorum.

Leximet e dyta nuk ka votim, Ligjin për kundërvajtje jam t'ia kthejmë Qeverisë në lexim të tretë. 263 amendamente, unë nuk e di, kush s'e dinë çka u bë në të. 263 amendamente, nuk ka ligj që mbetet ligj me të gjitha këto amendamente që s'di askush çka po votojmë. 263. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për kundërvajtje, 263 amendamente, po t'i i ke punuar, por unë i kam 263.

Jo, më falni, pra, qenka ligji tjetër: Rregullat e komunikacionit rrugor, po unë e kam lexuar gabimisht. Se ky paska ashtu si tha. Unë po besoj që mund të vazhdojmë ose nuk mund të vazhdojmë. 49 deputetë janë në sallë. Nesër në orën 12:00, po në orën 11:00 Kryesia ka mbledhjen ose e lëmë pasdite ose e vazhdojmë sonte, por mua po më duket që s'ka as interesim të dëgjojnë. Atëherë nesër në orën 12:00 e vazhdojmë seancën.

* * *

*Vazhdimi i mbledhjes plenare, e filluar më 4 gusht
Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.*

KRYETARI: Të nderuar kolegë deputetë,
I nderuar Kabinet qeveritar!

Në sallë janë të pranishëm 64 deputetë, që do të thotë se janë plotësuar kushtet për punë. Para se t'i vazhdojmë punimet e seancës plenare, më lejoni të theksoj se mbrëmë ka ndodhur një rast i rëndë, është sulmuar Kuvendi i Republikës së Kosovës. Dëshirojmë të përçojmë si kuvendarë mesazhe te qytetarët e Republikës së Kosovës për maturi dhe siguri, pikërisht për këtë arsye të gjitha forcat politike të përfaqësuara në Kuvendin e Republikës së Kosovës do të bëjnë një deklaratë të përbashkët në Kuvendin e Republikës së Kosovës, e cila pastaj edhe do të miratohet nga kuvendarët për dënimin e këtij akti kriminal.

Shefat e grupeve parlamentare janë bashkë me një deklaratë, të cilën do ta lexojë deputetja Blerta Deliu-Kodra. Pastaj do ta vejme edhe në miratim.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit!

I nderuar kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës, zoti Kadri Veseli,
Të nderuar deputete dhe deputetë të Kosovës,
Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës!

"Ne, përfaqësuesit e zgjedhur të popullit, dënojmë fuqishëm sulmin kriminal të kryer mbrëmë mbi Kuvendin e Republikës së Kosovës. Ky është një sulm kundër shtetit të Kosovës, kundër interesave të qytetarëve tanë dhe kundër qëllimeve e vlerave politike që afirmojnë subjektet tona partiake.

Ne afirmojmë së bashku se mosmarrëveshjet tona politike duhet dhe do t'i zgjidhim vetëm përmes dialogut politik, përmes rrugëve demokratike dhe se asnjë kauzë apo asnjë qëllim politik nuk mund të arrihet asnjëherë përmes dhunës.

Po ashtu ftojmë institucionet e sigurisë që të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për zbardhjen e këtij sulmi dhe dhënien e kriminelëve para drejtësisë.

KRYETARI: Faleminderit, e nderuar deputete! Është deklaratë e Kuvendit, do të kemi vetëm një deklaram formal me ngritje dore për aprovimin e kësaj deklarate të Kuvendit të përbashkët.

Zonja Albulena Haxhiu e ka fjalën, pastaj zoti Albin Kurti.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Në fillim të kësaj seance u tha që kjo deklaratë është përgatitur bashkë me të gjithë shefat e subjekteve politike parlamentare dhe unë mund të theksoj faktin që kjo nuk është e vërtetë. Nuk e di kush ka shpifur për këtë, por neve të paktën nuk na ka ftuar askush që të marrim pjesë në draftimin e kësaj deklarate.

E udhës është që të gjithë shefat e grupeve parlamentare të mblidhen bashkë dhe ta bëjnë bashkë një draft, për shkak se ne nuk jemi dakord me pikën 3 të kësaj deklarate, e cila aludon,

domethënë, një qëllim të caktuar, sepse thotë: “Ne afirmojmë së bashku se mosmarrëveshjet tona politike duhet dhe do t’i zgjidhim vetëm përmes dialogut politik, rrugëve demokratike dhe se asnjë kauze apo qëllim politik nuk mund të arrihet përmes dhunës”.

Ju e dini shumë mirë që Lëvizja “Vetëvendosje” e ka dënuar fuqishëm këtë sulm kriminal. Mirëpo, ne kërkojmë që të marrim pjesë në draftimin e kësaj deklarate. Nuk është korrekte që subjekti më i madh opozitar të mos marrë pjesë në këtë deklaratë dhe natyrisht që ne kërkojmë që derisa të bëhen bashkë shefat e grupeve parlamentare të mos vendoset kjo deklaratë në votim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Kurti, edhe zonja Tërmkolli e ka kërkuar, po ashtu, fjalën.

ALBIN KURTI: Pra, së pari kryetari i Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosjes”, Glauk Konjufca, nuk ka marrë pjesë në draftimin e këtij teksti.

Ne si Lëvizje “Vetëvendosje” tashmë i kemi dënuar sulmin dhe nuk jemi dakord me paragrafin e tretë, e cila bën njëfarë lloj aludimi te veprimet aktive të opozitës gjatë këtij, le të themi, gati një viti të fundit dhe nëse hiqet paragrafi 3 dhe nëse në vend të fjalës “ne përfaqësuesit e zgjedhur të popullit” thuhet “ne deputetët e Kuvendit”, sepse këtu nuk jemi të gjithë përfaqësues të popullit, këtu ka përfaqësues të qytetarëve të popullit, por ka edhe përfaqësues të korrupsionit. Pra, nëse e bëni përfaqësues të zgjedhur të popullit, duhet ta bëni edhe përfaqësues të korrupsionit.

Pra, ne propozojmë që në vend të fjalës “ne përfaqësuesit e zgjedhur të popullit”, të jetë “ne deputetët e Kuvendit”, se deputetë të Kuvendit me të vërtetë jeni, por për deputetë të zgjedhur të popullit, për përfaqësues të zgjedhur të popullit, nuk do të thosha.

KRYETARI: Zonja Tërmkolli e ka fjalën, edhe zoti Zemaj e ka kërkuar fjalën.

MELIHATE TËRMKOLLI: Faleminderit!

Përsëritje të gjithëve!

Sinqerisht nuk po di qysh ta quaj këtë deklaratë, përveç një deklarate, më falni në shprehje, e coftë.

Nuk keni pasur nevojë absolutisht të takoheni ju udhëheqësit e politikës për të na e lëshuar një kesi deklarate që, madje, edhe për fëmijët do të ishte paksa qesharake.

Unë sot kam pritur këtu që të jetë ministri i Punëve të Brendshme, të jetë kryeministri, që të paraqiten para Kuvendit të Kosovës e të japin informacione çfarë ka ndodhur, jo për ta ekzagjeruar çështjen, por përkundrazi, për të siguruar qytetarët e Kosovës se shteti i Kosovës është duke funksionuar dhe shteti i Kosovës do t’i gjejë dhe do ta zbardhë rastin. Kaq. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Zemaj e ka fjalën, ndërkohë janë lajmëruar Rexhep Selimi dhe Muhamet Mustafa.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryetar!

Unë besoj që deklaratat e tilla të Kuvendit të Kosovës të spektrit politik kanë munguar jorallëherë gjatë rrugëtimit tonë, sidomos pas pavarësisë, apo edhe pas përfundimit të luftës.

Akte të tilla qyqare ndaj institucioneve, qoftë gjyqësore, qoftë policore, qoftë ndaj individëve, ka pasur edhe në të kaluarën dhe fatkeqësisht kanë munguar deklaratat e tilla nga spektri politik në vend.

Jo shumë gjatë në kohë, jo më larg se sa objekti i Kuvendit këtu është gjuajtur edhe Gjykata e Qarkut me një mjet granatahedhës, njëjtë sikurse që ka ndodhur në Kuvendin e Kosovës.

Është gjuajtur edhe Dhoma e Dëshmive në Pejë e krimeve të rënda dhe këtë e dini të gjithë botërisht, mbi të gjitha është tentuar edhe të vriten individë, njerëz, politikë me të njëjtën formë siç ka ndodhur në Kuvendin e Kosovës.

Andaj, unë po besoj, e mira në këtë keqe të madhe është që keni arritur ta nxirrni një deklaratë të tillë edhe ta vini para gjithë spektrit politik në vend, ta ngrisni një vetëdije se sulmet e tilla makabre, qyqare, nuk i shërbejnë politikës. Atë e kanë bërë armiq të Kosovës, e kanë bërë ata që më së paku mund ta quajnë veten shqiptarë për çfarëdo motivi që ta kenë pasur apo çfarëdo motivi që fshihet.

Mbi të gjitha, unë pajtohem shumë me koleget time, kjo është përgjegjësi institucionale, u takon organeve të rendit, u takon njerëzve që kanë kompetencë jo të fshihen si struci mbas akteve të tilla dhe nesër dalin me deklarata pompoze dhe t'i lejojnë politikës që t'u shërbejë për interesa personale, por mbi të gjitha të marrin vendime konkrete, shumë serioze në zgjedhjen e këtyre çështjeve.

Mbi të gjitha, deklaratat politike duhet të jenë të unifikuara në këtë drejtim, sepse pasojat janë më të mëdha se sa minimizimi i një çështjeje të caktuar apo politizimi i çështjes së caktuar.

Kjo duhet të tregojë vetëdijen tonë për të mos u përsëritur ato që kanë ndodhur, sepse në Kosovë kanë ndodhur dhe nuk janë dënuar nga shumë njerëz. Bile-bile, janë përkrahur edhe nga njerëz institucionalë dhe nga njerëzit politikë, qoftë sulme, qoftë vrasje politike, qoftë edhe gjëra të tjera negative që kanë dhënë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti Zemaj! Zoti Selimi e ka fjalën, le të përgatitet zoti Mustafa.

REXHEP SELIMI: Normalisht unë nuk po e kuptoj çka keni dashur të thoni me pikën tre, sqaroni mirë çka keni dashur të thoni me këtë pikë.

KRYETARI: Ju kisha lutur, të mos ketë ndërhyrje, deputeti e përfundon, pastaj secili që do flet për vete.

REXHEP SELIMI: Nuk dëgjova që ka ndërhyrje, m'u duk diçka tjetër, po sidoqoftë, çka keni dashur të thoni me këtë punë.

Edhe ana tjetër, pikërisht tash neve po na bëni të dyshojmë se diçka prapa saj qëndron. Pikërisht politizimi kaq i shpejtë, kaq i ngutshëm i kësaj çështjeje neve prej këtij momentit po na lë të mendojmë vërtet për diçka shumë konspirative, edhe diçka të përgatitur për këtë punë.

Në radhë të parë politizimi i kësaj çështjeje para se ta kemi ne as ekspertizën e vetme të policisë, të organeve të drejtësisë dhe të ndjekjes, neve tash po na bëjnë edhe një herë para një pozite që të paragjykohet politikisht kjo punë.

Unë dua të them edhe një herë që, për fat të keq, ky nuk është rasti i vetëm i sulmeve ndaj institucione të Kosovës, as forma, formë jo e njohur. U përmend edhe më herët ka pasur forma të tilla, pastaj jo shumë para pak ditësh kemi pasur edhe krijimin e një paniku me kohën e birrë-festës, edhe atje ka pasur armë zjarri.

Ndërlidhshmëria e këtyre nuk është e pamundshme, krijimi i një situatë të tillë nuk është e pamundshme. Prandaj, edhe një herë po e them, mos u ngutni me këso cilësimesh, sepse nuk na del mirë askujt. Dua të them edhe një herë, Lëvizja “Vetëvendosje” e ka dënuar këtë akt, do të vazhdojë ta dënojë këtë akt dhe, në anën tjetër, ky nuk është sulm thjesht i parcializuar, ky është sulm edhe ndaj nesh. Por dua t’ju them, edhe një herë të tërheq vërejtjen, mos u ngutni ta politizoni një gjë të tillë, sepse nuk na del mirë askujt. Politizimi i kësaj çështjeje na bëjnë të dyshojmë edhe të analizojmë përtej kësaj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Mustafa, e ka fjalën. Ndërkohë janë lajmëruar për diskutim zonja Kada-Bujupi dhe zoti Ibishi.

MUHAMET MUSTAFA: I nderuar kryetar i Kuvendit,
Të nderuar kolegë!

Unë e përshëndes deklaratën që u lexua këtu, mendoj që nuk është e ngutshme, por është përgjegjësi e Kuvendit që sot të reagojë për këtë edhe të aprovojë një tekst të tillë çfarë e dëgjuam, megjithëse s’e kemi me shkrim, ndoshta ekziston mundësia të bëhet një formulim më i mirë, por unë nuk po e shoh shumë problem me formulimet që janë aty. E para.

E dyta, këtu nuk u sqarua mospjesëmarrja dhe kërkoj të sqarohet, mospjesëmarrja e kryetarit të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”. Nëse nuk është ftuar është dashur të ftohet, nëse është ftuar e s’ka marrë pjesë edhe ajo duhet të sqarohet unë mendoj që duhet të ketë qenë i ftuar.

Çështja tjetër që u përmend këtu aluzioni në paragrafin 3, sa e dëgjova unë ai paragraf nuk bën aluzion ndaj asnjë force politike. Prandaj, le të lexojmë me kujdes edhe unë i ftoj kolegët deputetë që ta lexojnë me kujdes, a unë sa dëgjova në qoftë se duhet le të shumëzohet, le të na vjen teksti këtu ai bën aluzion se qëllimet politike, zhvillimet politike në Kosovë duhet të arrihen në mënyrë demokratike dhe nëpërmes dialogut, jo nëpërmjet dhunës. Ju lutem, ky Kuvend nuk mund ta pranojë dhunën.

Këtë duhet ta ketë të qartë secili dhe të mos e merr askush se ky është aluzion ndaj dikujt, përveç në qoftë se donë dikush të marrë aluzionin me zor. S’ka nevojë të marrë aluzione, teksti është i qartë, ne nuk e pranojmë dhunën në këtë Kuvend si mënyrë të arritjes së qëllimeve politike dhe si

kulturë dhe si praktikë. E kemi dënuar edhe gazin, edhe molotovin dhe do ta dënojmë dhe nuk e pranojmë. Ta kemi të qartë këtë!

Ju lutem, mos ndërhyj, unë nuk ndërhyra, mos ndërhyj! Rri në vend tënd atje, je mësuar ti si në pazar të flasësh. Këtu është Kuvendi i Kosovës. Rri në vend tënd!

Katër, Qeveria e Kosovës....

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Regjia, mos ia ndal fjalën!

MUHAMET MUSTAFA: ...ne duhet ta ftojme Qeverinë e Kosovës që të raportohet për këtë dokument, por sot mund ta aprovojmë këtë deklaratë edhe pa prezencën e Qeverisë. E kemi ministrin Hoti këtu, tash e vërejta, por mund ta aprovojmë edhe pa praninë e Qeverisë së Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Kisha kërkuar vetëm të shkojmë me radhë dhe pa emocione në fund, ose në qoftë se doni janë nëntë diskutues që janë lajmëruar për diskutim, ose mundeni të shkoni të takoheni shefat e grupeve parlamentare, në mënyrë që të mos e çojmë diskutimin më tej.

Mua kur më erdhi deklarata, më erdhi se ishte e koordinuar me të gjitha grupet parlamentare. A dëshironi të uleni bashkërisht apo të vazhdojmë diskutimet ende? Atëherë pra vazhdojmë, kërkoj falje në radhitje, zonja Kadaç-Bujupi ishte e para, tash doli pothuajse e fundit te teknika. Atëherë, zonja Kadaç-Bujupi e ka fjalën, tash ka dal e para zonja Osmani dhe nëntë tjerë.

DONIKA KADAÇ-BUJUPI: Jo, shumë thjesht, hiqeni pikën tre, ulemi e dakordojmë tekstin edhe e bëjmë bashkë, sepse nuk kemi qenë pjesë e këtij teksti u tha edhe nga kolegët. U konfirmua edhe nga të tjerët që ka përpjekje, të cilat nuk qëndrojnë. Prandaj, hiqeni treshin ulemi edhe dakordohemi edhe e nxjerrim një deklaratë për një akt kriminal. Kaq! Kjo s'ka të bëjë asgjë me mosmarrëveshjet tona politike, absolut s'ka të bëjë me mosmarrëveshjet politike veprimi.

KRYETARI: Faleminderit! Urdhëro zoti Grabovci, edhe pastaj deputetët që janë lajmëruar kisha pasur dëshirë a e duan fjalën apo le të shkojmë të harmonizohet dokumenti. Ok! Fjalën të gjithë do ua jap. Vetëm kartelat jeni duke i lëviz, mbani kush e ka kërkuar fjalën mbajeni kartelën për kërkim fjale.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, zoti kryetar!

Unë vetëm për hir të sqarimit edhe të korrektësisë, është e vërtetë se ua kam ofruar tekstin të gjitha grupeve parlamentare, në mungesë të shefit të Grupit Parlamentar të VV-së unë u konsultova me zotin Kurteshi, thashë “këtë tekst mund ta harmonizojmë bashkërisht, nëse keni vërejtje edhe pas leximit mund të harmonizohet ky”.

Kështu që unë mendoj që ne mund të tërhiqemi shefat e grupeve parlamentare dhe ta harmonizojmë tekstin nëse kanë vërejtje VV-ja, ndonjë edhe e hedhim në votim. Faleminderit!

KRYETARI: Atëherë, zoti Ibishi kërkoj falje, por me teknikë ose kam unë problem, ose ky kompjuteri s'po bën.

NUREDIN IBISHI: Edhe unë desha vetëm të them ato që tha zoti Grabovci që duhet të jenë një harmonizim i të gjitha grupeve parlamentare me dal me një deklaratë të përbashkët. Por, sido që të jetë mendoj që në fillim duhet të përshkruhet rasti çfarë ka ndodh. Kjo është ndoshta prej një deklarate qoftë të policisë që edhe atë me lidh edhe mendoj që përfundimisht duhet të angazhohen komisionet funksionale që mbikëqyrin sektorin e sigurisë në këtë rast edhe të hetuesisë, që në vazhdimësi ta përcjellin situatën rreth procedurës së zbatimit tonë të hetimeve për gjetjen e kryerësit.

Tash s'mund të predikoj nëse është rast kriminal, apo ndonjë veprim politik.

KRYETARI: Faleminderit! Zonja Osmani, fjala për ju.

VJOSA OSMANI: Faleminderit!

Unë shumë shkurt desha të them që është pikërisht gjuha e urrejtjes, mllëfit edhe polarizimet ekstreme që lënë hapësirë që sulmet e tilla të rënda ndaj institucioneve të vendit, ndaj sigurisë së vendit, por edhe ndaj qytetarëve të bëhen madje edhe nga siç u tha më herët nga kolegët edhe nga armiqtë e Kosovës, nga shërbime të tyre, sepse e dinë që shumë lehtë do t'i ikin përgjegjësisë sepse ne prapë qysh po dëshmohet këtu do të merremi me njëri-tjetrin.

Mos të harrojmë, të nderuar deputetë që dje në këtë ndërtesë ka pas policë të Kosovës, shqiptarë, por edhe të komuniteteve tjera të cilët kujdesen për sigurinë e këtij institucioni e që secilit prej nesh dhe punojnë për mbrojtjen e tyre, të cilët kanë qenë edhe te hyrja këtu, por edhe në katet më lart dhe vetëm rastësisht nuk janë lënduar apo nuk e kanë humb jetën, sepse po i dëgjoj njerëzit duke thënë sulmi është bërë për deputetët që s'kanë qenë aty.

Në këtë ndërtesë nuk punojnë vetëm deputetët, punojnë edhe me qindra shërbyes të tjerë të këtij vendi që e bën këtë sulm edhe shumë më serioz. Unë po pajtohem që te paragrafi tre ka një aludim që ai sulm është bërë për qëllime politike. Ne këtë nuk e dimë, këtë duhet ta thotë vetëm Policia e Kosovës dhe vetëm atëherë ky Kuvend mund ta konfirmojë një gjë të tillë.

Prandaj, nuk i kushton askujt asgjë që pesë minuta pas dy vitesh polarizim ekstrem që ka ndikuar edhe në polarizim të shoqërisë ne të ulemi bashkë dhe ta dëshmojmë që mund të nxjerrim një deklaratë të përbashkët. Në qoftë se as sulmet me predha antitanke nuk na bëjnë bashkë, atëherë ne nuk e meritojmë me qenë në këtë institucion.

KRYETARI: Zoti Beqaj fjala për ju, përgatitet zonja Gaxherri.

BESIM BEQAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

Dua të them që si deputetë duke shprehë indinjatën time për atë çka ka ndodh jam tepër i zhgënjyer sot këtu në fillim të seancës dhe arsyet që janë 14 orë që ka ndodh akti dhe ne është dashur që të kemi së paku ministrin e Brendshëm këtu me një deklaratë çfarëdo qoftë që do ta kishte bërë ai në bazë të elementeve, të cilat i kanë pas deri më tani, së paku deputetët e Kuvendit

kanë merituar që ministri i Brendshëm dhe Qeveria të vjen dhe t'i informojë zyrtarisht mbi atë dhe jo mbi bazën çka kemi lexuar dhe kjo është tepër shqetësuese.

Ky Kuvend brenda dhe jashtë ka shumë pajisje, të cilat mund ta evidentonin një rast të tillë, ka shumë njerëz të sigurisë, të cilët janë përgjegjës për këtë dhe dikush duhet të jep përgjegjësi. Pa hyrë në elementet e deklaratës së përbashkët. Deklarata e përbashkët është element politik, të cilin ne jemi duke tentuar t'ia japim një dimension politik një momenti të caktuar, por se para se gjithash duhet të kemi informatë zyrtare nga institucionet e sigurisë.

Unë nuk po e kuptoj me çfarë përgjegjësie sillen institucionet e sigurisë së vendit tonë, kemi të bëjmë me sigurinë edhe të institucioneve, por kemi të bëjmë edhe me sigurinë e shtetit dhe të qytetarëve. Nuk është kjo çështje krejt kaq e thjeshtë sa që asnjë nga Kabineti qeveritar me përjashtim të ministrit të Financave nuk paraqitet sot këtu dhe të na jep së paku një informatë. Nëse jo Qeveria, është dashur dikush prej përfaqësuesve të sigurisë së Kuvendit të na japin një informatë neve si deputetë.

Dhe, normalisht nuk është mirë që deklaratat të jenë të pa harmonizuara paraprakisht, as aludime politike, as kurrfarë. Të jenë deklarata të cilat e adresojnë gjendjen, por mbi bazën e informacionit të cilin duhet nxjerr në mënyrë profesionale nga ajo çka ka ndodhur.

Unë besoj që nuk është formë më e mirë e trajtimit të një problemi ekstrem serioz, sepse kjo reflektohet edhe tek qytetarët. Nëse ne sot këtu deputetët të zgjedhurit e popullit nuk e dimë saktësisht asnjë element zyrtarë, asnjë informatë zyrtare nuk e kemi është e papranueshme për mua si deputetë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zonja Gaxherri, fjala për ju. Zoti Kurti edhe një herë, a?

BESA GAXHERRI: Faleminderit!

Kolegë deputetë,

Akti i mbrëmshëm vërtetë ka qenë shumë i rëndë edhe i shëmtuar, për këtë gjë natyrisht që pajtohem të gjithë, por unë konsideroj se ne duhet njëherë e përgjithmonë të marrim përgjegjësitë dhe obligimet tona dhe të jemi shumë serioz në përgjegjësitë dhe në kryerjen e obligimeve tona.

Thanë shumë kolegë para meje dhe unë po e ritheksoj sot këtë ditë duhet të jetë shembull për ne që vërtet secili person që ka marrë përgjegjësinë duhet ta kryejë detyrën e vet. Po natyrisht është dashur me qenë Kabinet qeveritar sot këtu, dhe po natyrisht ne duhet të diskutojmë për këtë çështje, dhe po natyrisht ne duhet të kemi kujdes për fjalën e thënë dhe për veprimet tona çdo ditë, kudo në çdo institucion qoftë edhe brenda mureve të shtëpisë tonë, sepse në atë moment kur ne marrim votën përgjegjësinë e qytetarëve ne më nuk kemi emra të përveçëm, ne jemi institucioni.

Akti i mbrëmshëm ka qenë atak ndaj pavarësisë së vendit, atak ndaj demokracisë, ndaj fjalës së lirë, ndaj gjithçkaje, por ne nuk guxojmë të paragjykojmë askënd, sepse ne jemi shtet demokratik, i cili kemi institucionet kompetente për çdo veprim të çdokujt. Andaj, nuk guxojmë të paragjykojmë askënd dhe nuk duhet ta paragjykojmë askënd.

Por, ne jemi partitë politike këtu të gjitha sot të cilat duhet ta marrin përgjegjësinë dhe duhet të tregojmë se sikur çdo shtet demokratik ka përplasje e debate, por ne jemi një për mbrojtjen e vendit tonë dhe mos të lejojmë që të na ndërhyjë asnjë agjenturë dhe të shfrytëzojë përplasjet tona politike. Dhe sot duhet ta hartojmë deklaratën të gjithë të pajtimit, dhe jo deklaratë të tillë çfarë ishte sot e improvizuar, por deklaratë më korrekte dhe deklaratë edhe më të ashpër dhe deklaratë e cila ne të gjitha pozitivisht dhe opozitivisht do të marrim përgjegjësi për mbrojtjen e vendit tonë, për mbrojtjen e institucioneve tona dhe jo vetëm të gjuajnë, por të kemi kujdes edhe me atë se çka flasim.

Sepse, unë jam e sigurt që të gjithë e duam vendin njësoj, por ne duhet të jemi të kujdesshëm sepse Kosova ka shumë armiq, ata të cilët nuk e duan e shfrytëzojnë rastin kur të duan.

Andaj, unë e konsideroj se kjo deklaratë natyrisht edhe duhet të mësohemi njëherë e përgjithmonë, edhe njëherë po e përsëris secili ta merr përgjegjësinë e vetë, nuk mundemi t'i improvizojmë gjërat dikujt iu ka tek me bë një deklaratë e del këtu e lexon i pëlqej e s'i pëlqej ky nen e ai nen. Ne duhet të ulemi secili këtu kemi përgjegjësi, secili kemi përgjegjësi duhet secili ta japim mendimin tonë dhe secili punën tonë çdo ditë e sidomos këto ditë kur janë kaq të ashpra dhe të vështira. Faleminderit për vëmendje!

KRYETARI: Zoti Kurteshi, fjala për ju, përgatitet zoti Gashi.

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit! Unë vetëm desha të shpjegoj situatën në lidhje me komunikimin me zotin Grabovcin nja pesë minuta para se të fillojë seanca, zoti Grabovci është afruar këtu te unë dhe më ka njoftuar për idenë në fillim se ka pas as tekstin, më vonë e ka sjell tekstin, at tekst e kemi lexuar ne 2-3 deputetë kemi arrit ta lexojmë para se të fillojë seanca dhe mandej të lexohet edhe deklarata në emër të grupeve parlamentare, po e vërteta është që Grupi Parlamentar i lëvizjes “Vetëvendosje” jo që s’ka marrë pjesë në draftim, por ka qenë i njoftuar tepër vonë dhe do të thotë është krejt jo korrekte që diçka të lexohet edhe në emër të grupit tonë e ne të njoftohemi në minutën e fundit me tekstin pa pasur mundësi që ta japim mendimin tonë.

Prandaj, propozoj që për të dal me një deklaratë të përbashkët duhet të takohen shefat e grupeve parlamentare, ta hartojnë ata bashkë nëse i harmonizojnë qëndrimet dilet me një deklaratë të përbashkët. Përndryshe, dalja kështu në emër të grupeve pa u thirr grupet nuk është korrekte. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ne do ta përfundojmë deputetët, por kjo është problemi më i vogël për arsye se ende nuk është miratuar si deklaratë, do të miratohet nga ju.

Mirë është ndërkohë derisa i kryejnë grupet shefat e grupeve parlamentare të harmonizojnë tekstin, të shkojnë. Ne do të vazhdojmë që të përfundohen këta deputetë diskutimet e tyre.

Zoti Gashi e ka fjalën, bëhet gati zoti Salihaj.

ARBEN GASHI: Faleminderit, i nderuar kryetar!
Të nderuar kolegë deputetë,

Unë ndaj shqetësimin me të gjithë ju për ngjarjen e mbrëmshme, megjithatë tash kemi para vetes një tekst për të cilin duhet të diskutojmë.

Mendoj se pika 3 e tekstit lë të nënkuptojë edhe është po ashtu edhe implicite, por edhe eksplicite në përmbajtjen e vetë duke aluduar grupet politike apo partitë politike që kanë marrë pjesë në atë që ka ndodh ose si të ketë ardhur, ndodh ngjarja e mbrëmshme është rezultat i mosmarrëveshjeve politike. Prandaj, një tekst i tillë nuk guxon të jetë dhe ne ta votojmë këtu. Pika tre duhet të hiqet dhe pasi që të hiqet pika tre ne mund të harmonizohemi dhe të dalim me një tekst, ... mund të jetë akoma më e ashpër, por nuk guxon në asnjë formë përderisa nuk ka një raport zyrtar të institucioneve shtetërore Kuvendi nuk guxon në asnjë formë të aprovojë një tekst, i cili nënkupton se ngjarja e mbrëmshme ka ndodh si rezultat i mosmarrëveshjeve politike.

Ngjarja e mbrëmshme deri tash konsiderohet nga institucionet shtetërore si akt kriminal dhe ndoshta edhe në ditët e ardhshme mundet të shndërrohet në një akt terrorist apo diçka tjetër, por në një akt politik, të paktën nuk duhet të ketë, nuk ka indice që është një akt politik. Prandaj, si i tillë nëse mbetet me pikën 3 unë deklaroj votën time kundër. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Salihaj e ka fjalën, bëhet gati zoti Konjufca.

ADEM SALIHAI: Faleminderit!

Të nderuar kolegë,

Edhe unë e shpreh habinë time që Ministria e Punëve të Brendshme dhe Qeveria ende s'ka asnjë deklaram rreth kësaj çështje e cila vërtetë na ka shqetësuar të gjithëve shumë, sepse sulmi i mbrëmshëm është një sulm kriminal, por që ka prapavijë të thellë politike dhe qëllimi i tij është sulm ndaj institucioneve të Kosovës dhe një përpjekje për ta destabilizuar Kosovën si shtet dhe ne si institucione politike.

Vërtetë, deklarata nuk është e formuluar mirë, sepse te pika 3 ka aluzion qartë se këtë mund ta ketë bërë pozita për shkak të një kauze dhe mosmarrëveshjeve politike. Nuk do të thotë domosdo që është kjo, madje mund të mos jetë fare, mos të ketë lidhje me këtë sepse situata të caktuara i shfrytëzojnë lloj-lloj agjenturash për të krijuar kështu një aluzion siç është formuluar aty.

Pra, nuk duhet të ngutemi me këtë, duhet të jetë një deklaratë e balancuar që e dënon si krim dhe ta deklarojë prapavijën politike të këtij akti kriminal. Unë mendoj se vërtetë se Ministria e Punëve të Brendshme është nën çdo nivel këtë rast, dhe ne jemi shumë të hutuar se s'kemi asnjë informatë zyrtare se çfarë ka ndodhur aty. Unë e di që në Kuvend janë të instaluar lloj-lloj kamerash edhe në parking edhe në oborr, dhe duhet ta themi qartë se përgjegjësinë për sigurinë në Ndërtesën e Kuvendit e kemi edhe ne edhe para gjithash kryetari i Kuvendit dhe mua më habit fakti që ka pasur lloj-lloj të themi diversionesh këtu në Kuvend dhe ne përsëri jemi në një gjendje të një pasigurie të plotë këtu.

Është fat që ajo ka ndodh në orët e vona, sepse nuk pati viktimë në njerëz. Por, ne s'duhet ta përjashtojmë asnjë mundësi tjetër dhe unë kërkoj që Ndërtesa e Kuvendit të mbrohet më mirë edhe me pajisje edhe me sigurim se sa deri më tash që ka qenë.

Nuk është shqetësimi për jetët tona, është shqetësimi për institucionet që ne përfaqësojmë, sepse ata që bëjnë veprime të tilla kriminale mund të mos e kursejnë edhe jetën e askujt. Jeta e secilit prej nesh është e barabartë me jetën e një pastruesi ose punëtori të sigurimit dhe ne duhet të jemi të shqetësuar për të gjithë ata.

Pra, nuk duhet të ngutemi të jetë një deklaratë e balancuar dhe të bëjë përpjekje ta shpjegojë edhe prapavijën edhe qëllimet politike, për të cilat ka ndodhur kjo. Faleminderit!

KRYETARI: Zoti Konjufca e ke fjalën, zoti Meta bëhet gati edhe zoti Buja është, zoti Kurti a e do edhe njëherë fjalën në fund a ka mbet prej më herët, edhe njëherë a? Atëherë, bëhet gati pas Glaukut menjëherë.

GLAUK KONJUFCA: Nëse lexohet ky tekst me vëmendje është shumë e qartë që më shumë këtu ka aluzion ndaj opozitës edhe kundërshtarëve politik, se sa që është qëllimi me e dënuar sulmin që ka ndodh mbrëmë.

Paragrafi 3, qartësisht thotë që sulmi mbrëmë paska ndodh për shkak të mosmarrëveshjeve politike. Kjo ia mvesh opozitës aktin e mbrëmshëm. Prandaj, unë mendoj që jo vetëm ky paragraf që duhet të hiqet, por do të kishte qenë mirë edhe të na tregoni kush e ka shkruar këtë paragraf, është shumë me rëndësi. Paragrafi 3 nuk është i paqëllimshëm dhe nuk është shkarje, shkarje tekstit, shkarje e gjuhës, është gjuhë e konstruktuar me qëllim prej dikujt është mirë të na tregojnë a e ka shkruar Adem Grabovci a Ismet Beqiri në mënyrë që ta marrim vesh pse është konstruktuar bash kështu.

Që ne kemi mosmarrëveshje kemi bërë debate kohëve të fundit për demarkacionin dhe për “Zajednicën”, nuk jemi pajtuar, por nuk është mirë me gju bomba edhe eksplozive sikur që ishte mbrëmë. Pra, në mënyrë të qartë nëpërmjet kësaj gjuhe po i mvishet një akt i tillë të gjithë atyre që nuk pajtohen me Qeverinë, kjo është skandaloze. Kjo nuk duhet asnjë mënyrë të pranohet, por edhe duhet të jepet përgjegjësi për një formulim të tillë.

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Kurti, zoti Meta bëhesh gati menjëherë.

ALBIN KURTI: Brenga jonë për aluzionin se opozita do të mund të qëndronte prapa kësaj u tregua legjitime pikërisht nga fjala e deputetit Muhamet Mustafa, i cili gazin lotsjellës, koktejin e molotovit dhe sulmin e mbrëmshëm i vuri në një fjali.

Pra, kjo po tregon qartë edhe nga vetë deputeti i LDK-së se në fakt ka një prapavijë paragrafi i tij, andaj ne po kërkojmë që paragrafi i tretë le të hiqet tërësisht dhe në vend të asaj “ne përfaqësuesit e zgjedhur të popullit” të të jetë “ne deputetët e Kuvendit të Kosovës”.

KRYETARI: Vetëm pak, në fund do të ndalen në qoftë se pajtohen kryetarët e grupeve parlamentare ta përfundojmë një herë debatin, pasi ka ende të lajmëruar pastaj nuk ka mundësi të kalojë asnjë tekst, po profesor do ta kesh të drejtën për replikë, pa e pas miratimin e juaj. Kjo është ajo.

Zoti Mustafa fjala për ju, replikë!

MUHAMET MUSTAFA: Para replikës unë rezervohem që kur ta shoh tekstin e shkruar të them, unë u përqendrova në dhunën si mjet për arritjen e qëllimeve politike dhe po e përsëris.

Kjo që thashë për molotovin, kjo që thashë për gazin lotsjellës fola për sjelljet në Kuvend në këtë sallë. Nuk ka lidhje, mos m'i vë fjalët që s'i kam thënë. S'ka lidhje, nuk kam bërë asnjë aluzion, mos më fol! Asnjë lidhje, as s'e kam lidh me atë çka ka ndodhur mbrëmë, të jemi të qartë.

Por, unë e dëshiroj që ne këtu të gjithë të kuptojmë shqip që nuk mund të tolerohet dhuna në këtë sallë për arritjen e qëllimeve politike.

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Meta e ke fjalën.

BARDHYL METAJ: Faleminderit, kryetar!

Më tepër e mora fjalën për shkak se në disa raste prej kolegëve u tha këtu se nuk kemi të bëjmë kur është fjala për sulmin e mbrëmshëm, nuk kemi të bëjmë me një akt politik.

Po shkoj krejt në mënyrë të thjeshtë dhe pa pikë emocionimi po them meqenëse jam në Komisionin për Buxhet dhe Financa unë e di që ky Kuvend borxhe nuk ka dhe nuk ka ardhur ndonjë borxhli me e gjuajt me zollë këtu për t'i marrë paratë. Domethënë nuk kemi të bëjmë këtu me një akt privat, as me një akt të izoluar, as me asnjë njeri që i ka pirë dy birra apo s'i ka pirë dhe e ka marrë një zollë dhe e ka gjuajtur këtë Kuvend.

Jo, jo po kjo si individ të me merret zolla edhe të gjuhet Kuvendi nuk është puna që e ka marrë dikush për arsye se ky Kuvend ia ka ndonjë faturë të papaguar. Akti i sulmit të mbrëmshëm është politik, kjo tash kjo s'ka të bëjë me atë a e ka bërë Rusia, a e ka bërë Bullgaria, a është rast paralajmërim rasti me Kumanovë a me çka. Po akti është politik, është terrorist, është kriminal. Sa i përket koordinimit të tekstit mua po më vjen keq së pari që u pru një tekst që nuk kish gjë të koordinuar u tha që jemi marrë vesh a teksti nuk kish qenë i marrë vesh derisa një grup politik tha ne nuk kemi marrë pjesë në hartimin e tekstit.

Tash, kjo është vetë në vete dhe është një gabim jashtëzakonisht i madh. Po të ishim ulur bashkë nuk do të kishte ngjarë kjo pika 3, apo do të kishte ngjarë e formuluar ndryshe. Kaq!

KRYETARI: Faleminderit! Unë po e shoh zonja Tërmkolli, edhe zoti Kurti prapë janë lajmëruar. Ok! Zonja Tërmkolli e ka fjalën, pastaj zoti Kurti se po i shoh si kundër replika si t'i quaj tashmë.

MELIHATE TËRMKOLLI: Po, gjysmë minute krejt ndoshta. Nuk kisha dashur replikë, veç për hir të korrektësisë po dua të them deputetit Albin Kurti që të mos kapen shumë për kashla dhe për do fije të vogla. Janë më shumë se pesë deputetë të LDK-së që kërkuar heqjen e pikës 3.

Ju lutem, bëhuni pak korrektë! Bëhuni një grimë korrektë, dhe nuk kemi këtu politizim të kësaj çështje e aq më pak partizim të saj. Ju lutem, të jemi në nivel të përgjegjësisë së deputetit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Kurti edhe një herë pra shkurt dhe pastaj janë edhe dy diskutues.

ALBIN KURTI: Po, është e vërtetë që kishte disa deputetë të LDK-së të cilët po ashtu deklaruan që duhet të hiqet paragrafi 3, mirëpo ne e dimë që këta janë më parë deputetë të shtypur brenda LDK-së se sa deputetë të LDK-së.

Pra, nuk është qëndrimi i LDK-së dhe nuk është qëndrimi i kryetarit të Grupit Parlamentar të LDK-së. Ky është problemi, e para. E dyta, është që në Kosovë ka pasur shumë dhunë. Është e vërtetë që në Kosovë ka pasur shumë dhunë, mirëpo deputeti Mustafa e bëri përzgjedhjen e disa akteve, të cilat i lidhi në fjalinë e tij.

“Gazin lotsjellës” tha, “koktej të molotovit edhe sulmi i mbrëmshëm”. Gazi lotsjellës nuk është dhunë, dhunë janë “Zajednica” dhe demarkacioni. Gazi lotsjellës është padëgjueshmëri parlamentare, përveç asaj qytetare. Pra, gazi lotsjellës nuk është dhunë, kokteji i molotovit, sulmi i mbrëmshëm pse i vendosni edhe i përzgjidhni bashkë në një grup, kjo është kritika ime, por në të njëjtën kohë është edhe falënderimi im sepse ju treguat që paragrafi 3 praktikisht e ka këtë prapavijë politike.

Edhe një herë, jemi dakord që të votohet ky tekst por me kusht që të hiqet lidhja e sulmit të mbrëmshëm me mosmarrëveshjet tona politike.

KRYETARI: Faleminderit! Ka pasur kundër reaksion, por pas kësaj do ta mbyllim këta janë më për hir të publikut. Nuk do t’ia jap askujt fjalën. Këta që janë aktualisht, publikisht do t’u them, më s’do t’ua jap askujt fjalën: Zoti Mustafa, zoti Salihaj, zonja Osmani e ka kërkuar fjalën si reaksion dhe zoti Beqiri si kryetar i Grupit Parlamentar e merr në fund të këtyre tre deputetëve. Pastaj, zoti Buja, zonja Halimi e ka fjalën për herë të parë dhe e përfundojmë, ta keni parasysht më nuk do t’jua jap fjalën.

Ok, se po shndërrohet shpesh për arsye se kemi një pajtueshmëri të gjithëve për deklaratë, për atë veç sa zgjatemi më shumë.

Atëherë, shkojmë kështu zonja Osmani, fjala për ju, përgatitet zoti Salihu menjëherë, pastaj edhe zoti Mustafa nga një minutë, këta që i përmenda.

VJOSA OSMANI: Shumë shkurt, patjetër më duhet të përgjigjem në kualifikimin e ne 4-5 deputetëve që nuk e pranuan paragrafin 3 si të tillë, pra nga LDK-ja si deputetë të shtypur.

Zoti Kurti, ne nuk jemi deputetë të shtypur, ne jemi përfaqësues të lirë të qytetarëve të Kosovës dhe në qoftë se askush në këtë Kuvend deri sot nuk e ka dëshmuar këtë, këtë liri të përfaqësimit të qytetarëve besoj mund ta gjesh pikërisht te këta pesë deputetë, e para.

E dyta, shtypjen, jo vetëm nga përfaqësuesit tjerë politikë të partisë sime, por nga askush në jetë deri sot nuk e kam pranuar, edhe pse praktika të tilla mund të jenë të njohura për ju, prandaj ju lus në vend që të thirrni për bashkëpunim në këto momente kaq të rënda për këtë institucion, por edhe për qytetarët që presin nga ne ta shohin një shembull të mirë, do të ishte mirë të mirëprisnit fjalë të tilla nga deputetët e LDK-së. Nuk jemi deputetë të shtypur, e para. E dyta, jemi të gjithë përfaqësues të zgjedhur pavarësisht sa i pëlqejmë njëri-tjetrit, sepse është term kushtetues.

Pra, te paragrafi i tretë pajtohem që mund të ndryshohet apo të hiqet, por jo edhe te termi “përfaqësues i zgjedhur”, sepse jemi institucioni i vetëm në nivel qendror që zgjidhemi drejtpërdrejt prej qytetarëve, për dallim prej shumë prej të tjerëve që janë ulur në Qeveri. Të gjithë i kanë zgjedhur qytetarët e Kosovës, të cilët edhe unë edhe ti i përfaqësojmë.

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Salihaj mundësisht shkurt dhe zoti Mustafa.

ADEM SALIHAI: Unë vërtet u habita nga deklarata e zotit Kurti, më duket cinike dhe pa nivel për këtë debat që e kemi këtu dhe t’i them që nuk jemi aspak të shtypur, ne po i mbrojmë disa parime, të cilat mendojmë që janë të drejta dhe përkundër faktit që kemi qenë të sulmuar brutalisht ne si deputetë nga ju, me ujë fytyrës, me gaz, me të gjitha ato. Megjithatë, po e shohim të arsyeshme që t’i mbrojmë disa parime, pra të ju mbrojmë edhe ju nga një akuzë e padëshmuar.

Pra, është një akuzë e padëshmuar dhe këtë parimisht po kërkojmë ta heqim, pra jemi shumë mbi at nivel që po pretendon zoti Kurti që ta përfaqësojë këtu. Faleminderit!

KRYETARI: Zoti Mustafa fjala për ju. Kryetari i Grupit Parlamentar pastaj e ka fjalën, zoti Beqiri.

MUHAMET MUSTAFA: I nderuar kryetar i Kuvendit,
Më lejoni në fillim të theksoj se përderisa jemi të gjithë deputetë të zgjedhur të popullit, askush nuk ka drejtë ta konsiderojë veten përfaqësues më i mirë se tjetri i popullit dhe me dhënë cilësime nuk është kolegiale... *(nuk dëgjohet për transkriptim)*

E dyta, dëshiroj të theksoj se nuk kam thënë se sulmi i mbrëmshëm është i lidhur me dhunën... *(nuk dëgjohet për transkriptim)*... kjo është amputim edhe po e përsëris, nuk kam menduar dhe nuk kam thënë.

E treta, sa i përket paragrafit 3 po them që kur te marrim tekstin mund ta shohim edhe unë mendoj që në qoftë se ka elemente që këtu u theksuan mund të riformulohen, por unë e cilësoj me mbetë deklaratë që ky Kuvend kërkon të gjitha forcat, jo vetë 2-3 forca por edhe “Vetëvendosja”, edhe PDK-ja, edhe LDK-ja edhe të gjithë kërkojmë që dhuna të evitohet si instrument për arritjen e qëllimeve politike. Ky është kuptimi i fjalimit tim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Beqiri, kryetari i Grupit Parlamentar të LDK-së, e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Faleminderit!

Vërejtjet që kolegët, shumica po veçmas të LDK-së që diskutuan absolutisht edhe unë i bashkëngjitem, kur flasim për paragrafin 3.

Ajo që është e dhimbshme është që edhe në këto momente cilido qoftë të tentojë, të moralizojë, të përfitojë politikisht është e dhimbshme edhe tregon nivelin e deputetit apo të përfaqësuesit të popullit. Unë po ju tregoj nuk kam marrë pjesë unë as Glaukut, asnjërit s’i frikësohem në përpilim të tekstit këtu kam qëndruar e di zoti Kurteshi kemi ndejt, nuk po hy në këtë historik se me e pas shkruar tekstin po tregoj Glauk unë them po unë e kam shkruar, por nuk është esenca

aty. Esenca është ta dënojmë këtë akt dhune, kriminal kjo është kryesorja. Riformulimi asnjë problem nuk ka, të gjithë e thanë e bëjmë.

Unë po habitem pse po stërzgjetet kjo edhe secili pastaj këtu kanë njëfarë nasihati që thotë populli me na shit mend edhe filozofi patriotike s'ka asnjë nevojë. Po e shti edhe veten që s'kisha fol mos me u pas thirr. Sa i përket aktit të mbrëmshëm është shumë e qartë çfarë akti kriminal është. E para, është e drejtë e imja si deputet me e thënë që për mua nuk është rezistencë paqësore gazi lotsjellës është dhunë, sikur që është edhe koktej molotovi dhunë. Ajo është e drejtë e imja me e thënë nuk dua që t'i lidh me rastin e mbrëmshëm dhe secili ka të drejtë që ta mbajë qëndrimin a është gazi lotsjellës mjet demokratik me ia fut në gojë kolegut gazin lotsjellës apo jo, kjo është çështje tjetër.

Dhe nuk po dua ta bëjë temë tash, por nuk është temë edhe s'është punë e sodit se ky gaz e këto çka po ndodhin po ndodhin që një kohë të gjatë. Nuk po dua as dëshirojmë as si grup parlamentar, as si deputet, me i lidh rastin e mbrëmshëm me asnjë subjekt politik dhe çka është e rëndësishme ne jemi të gatshëm është shumë normale me e riformuluar tekstin, me e pa dhe me qenë i pranueshëm për të gjithë.

Edhe njëherë po ju lus, është shumë e ulët prej cilitdo prej nesh që sot të mundohemi në këtë situatë kur mbrëmë kam mundur siç e tha kolegja Vjosa edhe të tjerët besoj janë të vetëdijshëm ka mundur të ketë viktima. Prandaj, ta lëmë për një minutë bile këtë moralizim të njëri-tjetrit ulemi e bëjmë tekstin asnjë problem nuk ka, por çështja e prononcimeve politike unë i kam lexuar të gjitha partive politike sigurisht edhe ju deklaratat dhe në të gjitha këto dënohet dhuna. Bile-bile përmendet si kauzë nuk e pranojmë asnjëri dhunën.

Kështu thuhet, të mos jetë ky tekst cilitdo tekst që është i pranueshëm për të gjithë ne e pranojmë, është me rëndësi si akt edhe vepër kriminale duhet ta dënojmë edhe të mos i lidhim po pajtohemi në kontekst tjetër e bëjmë, por se jemi përfaqësues të popullit jemi, ai që se ndjen veten që s'është përfaqësues i popullit le t'ia lë emrin si të donë, këtë e sqaroi edhe kolegja edhe çka shkruan në Kushtetutë.

Prandaj, ne në emër të grupit po them kryetar jemi të gatshëm nëse ju na ftoni ulemi e bëjmë riformulimin veçmas është çështja e paragrafit tre, e riformulojmë ose e heqim krejt ajo është problemi më i vogël. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Buja fjala për ju, edhe jemi në përfundim, ju kisha lutur.

SHUKRI BUJA: I nderuar kryetar!

Të nderuar deputetë,

Fillimisht nuk e kuptova pse duhet të dalim me një deklaratë, por nga diskutimet e deputetëve të nderuar që diskutuan deri tani e kuptova se e adhurojnë, kanë dëshirë që ta polarizojnë edhe më tutje skenën politike dhe qytetarët e Kosovës.

Nuk po e kuptoj pse duhet ta aprovojmë një deklaratë kur kemi dal me deklarata që nga fillimi i punës së këtij Kuvendi, me deklarata nga subjektet politike, nga deputetët, nga njerëz përgjegjës, të cilët kanë qenë të papërgjegjshëm dhe e kanë polarizuar skenën politike në Kosovë.

Deklarata më e mirë do të ishte që organet e sigurisë, t'i arrestojnë këta njerëz, t'i zbulojnë, organet e ndjekjes t'i paraqesin para organeve tjera, të cilat do t'i dënojnë si akt kriminal, do t'i dënojnë këta individë. Kjo do të ishte deklarata më e mirë se sa të nxjerrim ndonjë deklaratë që unë as nuk e posedoj. Deklarata të tilla nxirren kur nuk ke mekanizma shtetëror, të cilat e luftojnë krimin dhe del me një deklaratë, e dënon me një deklaratë dhe e kryen këtë punë. Faleminderit!

KRYETARI: Jemi në përfundim zonja Halimi edhe e përfundojmë.

SELVIJE HALIMI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Akti i mbrëmshëm ishte akt mbi të gjithë qytetarët e Kosovës, pa dallim të partive politike, pa dallim nacionaliteteve.

Ishte akt mbi të gjitha institucionet e Kosovës duke filluar nga institucioni më i lartë i vendit, nga Kuvendi. A thua pse ndodhin këto akte? Kush i bën këto akte dhe çfarë motive fshihen pas këtyre akteve?

Ne nuk mund të deklarojemi sot, as të japim cilësime, sepse nuk jemi organ kompetent për të cilësuar dhe për të gjetur përgjegjësit. Kemi ligje, të gjitha i dimë dhe i lexojmë shpesh. I kemi të përcaktuara qartë kompetencat tona dhe secili duhet të jetë i përgjegjshëm dhe të ndihet përgjegjës për fjalën e thënë publike, për veprimin e bërë publik, qoftë në dëm të tij personal, por edhe në dëm të interesave të qytetarëve të Kosovës.

Në qoftë se sot para se organet e ndjekjes të dalin me raporte zyrtare ne duhet të dalim me deklaratë dhe unë mendoj se duhet të dalim. Të gjitha subjektet politike, madje edhe ato që sot nuk janë në Kuvend duhet të ftohen dhe së bashku do të dalim me një deklaratë unike ku të gjitha subjektet politike, të gjithë deputetët e Kuvendit të Kosovës pa dallim edhe nacionaliteti, zotohen se do të jenë unik në të gjitha momentet kur cenohen institucionet e shtetit të Kosovës, kur cenohen interesat dhe të drejtat e qytetarëve të Kosovës.

Debati që u zhvillua sot të jep të kuptosh se Kuvendit të Kosovës i mungojnë debatet për shumë çështje e në veçanti për çështjen e sigurisë. Andaj, të marrim mësim nga kjo e keqe që ndodhi mbrëmë, të organizojmë debate, të kërkojmë raporte nga institucionet përgjegjëse, të debatojmë mbi bazën e atyre raporteve dhe të tregohemi më të përgjegjshëm 120 sa jemi këtu. Të tregohemi më efikas në kryerjen e detyrave tona dhe përgjegjësi që i kemi marrë. Askush nuk na i ka dhënë me zor, kemi kërkuar përgjegjësi. Duhet të jemi unik ndaj akteve të tilla, por jo vetëm ndaj këtij të mbrëmshmit. Ndaj të gjitha akteve që kanë ndodhur, dhe akteve të cilat ne po ua hapim rrugët që të ndodhin në të ardhmen. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Veç në qoftë se nuk e përmend askënd Albin, në qoftë s'e përmend askënd. Për hir të korrektségisë politike, në qoftë s'e nuk e përmend askënd.

Vazhdo po mos përmend as emra, as subjekte.

ALBIN KURTI: Së pari, unë besoj që nuk është turp të jesh i shtypur por është turp të shtypësh. Unë vetë ndihem deputet i shtypur nga ky regjim këtu dhe një pjesë të madhe të jetës kam qenë i shtypur dhe dashamirësia ime, e solidariteti im shkon pikërisht me njerëzit e shtypur.

Prandaj, kjo është botëkuptimi im vleror sa i përket shtypjes. Dhe në anën tjetër më vjen shumë mirë, se gjithnjë e më shumë po thuhet se nuk ka lidhje gazi lotsjellës me sulmin e mbrëmshëm. Mirëpo, prandaj po them që gazi lotsjellës nuk është dashur të përmendet fare sot dhe krejt në fund unë e kuptoj formulimin juridik kushtetues, përfaqësues të zgjedhur të popullit. Mirëpo, konteksti aktual politik sot nuk është ai i kushtetutshmërisë, po është ai i bombave të përditshme të aferës “Pronto 2” dhe ata kanë interes që të shkruajnë fjali në afirmojmë së bashku, në përfaqësuesit e zgjedhur të popullit, e kështu me radhë.

Pra, ka një tendencë përbashkimi në një kontekst politik të polarizuar ku u konvenon pikërisht shtypësve që në të shfaqemi bashkë. Prandaj, unë thashë që e vërteta politike sot është më e rëndësishme se saktësia juridike e vitit 2008 kur është shkruar Kushtetuta. Faleminderit!

KRYETARI: Zonja Tërmkolli për hir të respektit si deputete e vjetër, më e vjetra.

MELIHATE TËRMKOLLI: Salih, veç një grimë qetësi se ngadalë po e kryejmë. Unë më duhet ta them një fjalë që s’i pëlqen Albinit po është shumë punë e madhe. Unë kam pas shpirt të lirë edhe kur Kosova ka qenë e okupuar dhe vazhdoj ta kem shpirtin e lirë.

KRYETARI: Faleminderit! Kisha kërkuar nga kryetarët e grupeve parlamentare tërhiqen ta bëjnë munifikimin e deklaratës dhe t’i shpërndahet teksti të gjithë deputetëve para miratimit vazhdojmë me seancën.

Vetëm le të shkojnë kryetarët e grupeve parlamentare ju kisha lutur. Mesazhi me aq çfarë po dërgojmë tek qytetarët tanë me sjellje të tilla është se ne me asgjë s’mund të merremi vesh vetëm sa e komplikojmë më tepër se sa qartësojmë diçka në këto rrethana. Ne duhet të tregojmë siguri dhe gatishmëri me marrë përgjegjësitë tona politike, aspektet institucionale të cilat lidhen me krimin le t’i marrin organet ndjekëse.

Kryetarët e grupeve parlamentare, urdhëro zoti Beqiri.

ISMET BEQIRI: Kryetar, unë po propozoj që zoti Zemaj të shkon me e bë tekstin, kam besim të plotë në emër të LDK-së do të shkojë zoti Zemaj nuk ka kurrfarë problemi, secila parti e dërgon kënd t’ia marrë mendja, ajo është çështje e tyre.

Nuk është kjo veç e shefave, unë nuk e kam asnjë problem, por zoti Zemaj le të shkojë në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së e bën tekstin dhe pastaj e harmonizojmë.

KRYETARI: Faleminderit! Do ta vazhdojmë seancën se kemi kuorum të mjaftueshëm. Partia Demokratike e Kosovës?

ADEM GRABOVCI: Në emër të Partisë Demokratike shkon Selvije Halimi.

KRYETARI: Lëvizja “Vetëvendosje”!

GLAUK KONJUFCA: Prej nesh shkon Albulena Haxhiu.

KRYETARI: Faleminderit! Lista serbe?

SLAVKO SIMIČ: U ima Srpske liste predlažemo Srdjana Popović.

KRYETARI: Faleminderit! Nga “6+”?

MÜFERA ŞINIK: Prej Grupit “6+” Kujtim Paçaku.

Faleminderit! Kërkoj nga të apostrofuarit që të tërhiqen dhe të na sjellin tekstin e harmonizuar.

Vazhdojmë me votimin e *Projektligjit për performansën energjetike në ndërtesa*.

Duke pasur parasysh se jemi në vazhdimin e punimeve të seancës plenare të filluar dje, më 04 gusht 2016, me pikat e papërfunduara. Atëherë, të nderuar deputetë, mbani vendet.

- Votimi i Projektligjit për performansën energjetike në ndërtesa

Të nderuar deputetë, ju njoftoj se diskutimet për këtë pikë kanë përfunduar në seancën e djeshme por në mungesë të kuorumi votimi është shtyrë për sot.

Në vazhdim kërkohet deklarimi me votim për miratimin në parim të Projektligjit. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Kemi kuorum të mjaftueshëm mos të humbim kohë.

- Votimi i Projektligjit nr. 05/L-101 për performansën energjetike në ndërtesa

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim në mënyrë elektronike. Votojmë tash!

63 deputetë kanë votuar, 55 për, 8 kanë abstenuar.

Kuvendi e miratoi në parim *Projektligjin për performansën energjetike në ndërtesa*.

Ngarkohen komisioni funksional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

- Votimi i Projektligjit për mbrojtjen e fëmijës

Të nderuar deputetë, ju njoftoj se diskutimet për këtë pikë kanë përfunduar në seancën e djeshme, por në mungesë kuorumi votimi është shtyrë për sot. Në vazhdim kërkohet deklarimi për votim, për miratimin në parim të projektligjit.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tash. Atëherë, shkojmë edhe njëherë votojmë pra me dorë pasi po kërkohet nga deputetët, veç te konfirmoj pjesëmarrjen e deputetëve. 71 deputetë janë në sallë. Do të shkojmë votimin me dorë, po shoh se disa kolegë deputetë kanë probleme në votim elektronik.

Kush është kundër Projektligjit për mbrojtjen e fëmijës? A ka abstenim? A mund të konsideroj të gjithë deputetët e tjerë prezentë janë për? Atëherë, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për mbrojtjen e fëmijës me 61 për, 10 abstenime.

Ngarkohen komisioni funksional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

- Votimi i Projektligjit për kamatë vonesat në transaksionet tregtare

Të nderuar deputetë, ju njoftoj se diskutimet për këtë pikë kanë përfunduar në seancën e djeshme, por në mungesë kuorumi votimi është shtyrë për sot. Në vazhdim kërkohet deklarimi me votim për miratimin në parim të projektligjit.

Votojmë me dorë: kush është kundër? A ka abstenim? A mund të konstatojmë nga 69 deputetë të cilët janë aktualisht në sallë 69 kanë votuar për? Po!

Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për kamatë vonesat në transaksionet tregtare.

Ngarkohen Komisioni Funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 05/L-087 për kundërvajtje

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për kundërvajtje dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Ftoj raportuesin e Komisionit Funksional për Legjislacion, zotin Armend Zemaj, që para deputetëve të paraqesë dhe arsyetojë raportin me rekomandime. Shkon në komision.

A dëshiron dikush t'i paraqesë këto? S'ka nevojë. Atëherë, i kemi gjithsej 32 amendamente nga Komisioni Funksional. Unë, në qoftë se e kemi pajtimin e seancës, në qoftë se ka dikush kundër le të lajmërohet, do të shkojmë me 32 amendamentet që t'i votojmë përnjëherë, me votime me dorë.

Jemi 71 deputetë në sallë. A jemi për që të shkojmë me 32 amendamente përnjëherë. Do të shkojmë me pyetjen, kush është kundër për të 32 amendamentet? A ka abstenim? Nuk ka.

Mund të konstatojmë se 32 amendamentet u miratuan.

Shkojmë në votimin e tekstit të projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara. Përgatitemi për votim. Kush është kundër? 71 deputetë jemi. A ka abstenim? Atëherë, pjesa tjetër me aprovimin e seancës është për, 71 deputetë. Kuvendi miratoi Ligjin për kundërvajtje.

13. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Kryetarja e Komisionit FunkSIONAL, ka nevojë apo është në rregull? OK. Në këtë projektligj janë propozuar gjithsej pesë amendamente nga Komisioni FunkSIONAL. Nëse kemi aprovimin e 70 deputetëve që aktualisht janë në sallë, shkojmë me pesë amendamente nga Komisioni FunkSIONAL që t'i votojmë njëherësh. Jemi për po.

Atëherë, votojmë të pesë amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL. Kush është kundër? A ka abstenim? Votohen të gjitha amendamentet. Jemi tek votimi i projektligjit në tërësinë e vet. Jemi 70 deputetë në sallë. Kush është kundër? 71 në fakt, se u fut edhe një deputet. Nuk ka kundër. Abstenim a ka: Nuk ka.

Atëherë, konstatojmë se Kuvendi miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara me 70 vota për.

- Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për rregullat e komunikacionit rrugor

Shqyrtimi i këtij projektligji do të bëhet në pajtim me vendimin e seancës së sotme plenare. Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar projektligjin për rregullat e komunikacionit rrugor dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara, me përjashtim të Komisionit për Legjislacion, i cili nuk e ka shqyrtuar raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL brenda afatit të paraparë me Rregulloren e Kuvendit, nenit 57.8.

Kryetari i Komisionit FunkSIONAL, a ka nevojë ta marrë fjalën? Janë 263 amendamente, 3 amendamente. Urdhëro, kryetar i Komisionit FunkSIONAL, zoti Mustafa.

MUHAMET MUSTAFA: Po, në këtë ligj është punuar shumë. Ka qenë një punë interdisiplinare, të them ashtu, prej shumë komisioneve. Ka shumë amendamenteve, por shumica e tyre janë rregullim gjuhësor i përmbajtjes, nuk janë përmbajtjesore. Janë aprovuar njëzëri prej të gjithëve që janë konsultuar, por në këtë punë ka punuar kolegu Raif Qela, e ka udhëhequr grupin dhe unë kërkoj që ai të bëjë arsyetimin.

KRYETARI: Zoti Qela, urdhëroni, fjala është për ju.

RAIF QELA: Të nderuar deputetë,

Meqenëse, është pak e panatyrshme që kaq shumë amendamente të vijnë për një projektligj, do të përpiqem shkurtimisht që ta arsyetoj këtë.

Ky projektligj, si dhe plotë projektligje të tjera që na vijnë prej Qeverisë, janë me probleme të mëdha teknike, drejtshkimore, të sintaksës dhe logjike. Përkundër faktit se nga ana

përmbajtjesore nga ana profesionale ky projektligj në përgjithësi është në rregull, megjithëse edhe komisioni e ka plotësuar atë, problemet e tilla na kanë detyruar që t'i shkojmë nen për nen dhe t'i korrigjojmë të gjitha ato gabime.

Gabime teknike, drejtshkimore, të sintaksës dhe logjike ka me qindra, mbase edhe më shumë se njëmijë. Çdo nen, çdo paragraf është me gabime të tilla, madje edhe gabime të tilla logjike, si kjo në vijim: “Dispozitat e parkimit të këtij ligji”, nuk e di qysh parkohet ligji!

Duke pasur parasysh se formulime të tilla e çorientojnë cilindo dhe cilindo gjyqtar, e kemi parë të arsyeshme që projektligjin në njëfarë mënyre, me shumë kujdes, ta korrigjojmë nen për nen. Në komision, përveç Komisionit për Zhvillim Ekonomik, në grupin punues kanë marrë pjesë edhe përfaqësues të Komisionit për Legjislacion dhe përfaqësues të Komisionit për Siguri. Që të dy kanë dhënë kontribut të konsiderueshëm në këtë.

Gjatë tërë punës së grupit punues tërë kohën kanë qëndruar përfaqësuesit e ministrisë, përfaqësuesi i ministrisë dhe përfaqësuesi i Policisë. Të gjitha ndryshimet i kemi bërë në unanimitet të plotë. Nëse jeni të interesuar që ndryshimet përmbajtjesore t'i lexoj kalimthi, jam i gatshëm, përndryshe, nëse jo, zgjat pak më shumë. Prandaj, nëse keni nevojë për sqarim për çdo nen, për çdo amendament mund të sqarohemi.

Unë e shfrytëzoj rastin që t'i drejtohem Qeverisë me një kërkesë shumë të thjeshtë, të mos i sjellë ligje të tilla më, të paredaktuara, të palekturuara këtu, sepse po i nxjerr tepër telashe Kuvendit, për një punë e cila nuk është e Kuvendit. Po merremi me punë të tjera, në vend se të merremi vetëm me çështje të përmbajtjes së tyre. Ka mundësi, që kjo para se të vijë këtu të redaktohet teksti, që vazhdimisht krahas një lektori e një redaktori të jetë edhe një përfaqësues i Zyrës Ligjore, që tu tregojë se si bëhen ligjet, në mënyrë që të mos dalë kaq shumë problem këtu në Kuvend.

Jam i vetëdijshëm se ka shumë amendamente, por jam shumë i sigurt se ky projektligj tani është shumë më i mirë, se sa që ka qenë në fillim dhe është në përputhje e në harmoni me atë se çfarë ka dashur edhe grupi punues i Qeverisë ta punojë edhe qysh na e ka sjellë si projektligj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Na ke impresionuar, zoti Qela. Besoj se Qeveria ta ka borxh një honorar, po herëve tjera është mirë t'ua kthejmë krejt, se këtë punë e kanë...

Atëherë, në këtë projektligj janë propozuar gjithsej 263 amendamente, çfarë na e qartësoi kolegu deputet, nga ana e Komisionit Funkcional. Unë, në qoftë se kemi pajtimin e juaj, formalisht do të shkoja 263 amendamentet përnjëherë t'i votojmë. A ka dikush kundër? Urdhëroni zoti Ibishi, se e ka kërkuar fjalën.

NUREDIN IBISHI: Unë po dua, pa ju marrë nga koha, vetëm të ritheksoj edhe një herë kontributin e jashtëzakonshëm të kryesuesit të grupit të punës për amendamentimin e ligjit në procedurën parlamentare dhe realisht kisha thirrur që edhe të tjerët të jemi shembull i tij.

Sinqerisht, kemi punuar një grup i punës shumë i përkushtuar dhe na kanë ardhur gjithë këto amendamente, edhe me ato që e tha, edhe gjuhësor edhe përmbajtjesor, që të kemi kujdes kur të na vijjnë këto ligje, me qëllim që të mos na e marrin kohën. Edhe unë dua të cekim edhe diçka që e kemi tejkaluar, përveç direktivave evropiane që i kemi harmonizuar, është edhe çështja tjetër rreth raportit evropian të aksidenteve, që po na shkakton shumë tollovi për aksidente shumë minore dhe ndalen midis rrugëve dy vetura. Derisa të merren vesh, bëhet tollovia e pakufi. Kjo është tejkaluar me ligjin e ri. Po, ne veç duam që kjo të zbatohet nga institucionet përkatëse të zbatimit të ligjit.

Çështja tjetër, që edhe kam mbajtur një fjalë jashtë rendit të ditës, lidhet me trendet në rritje të aksidenteve të trafikut dhe mendoj që me zbatimin e këtij ligji e sidomos me vënien në funksion të masave ndëshkuese, po edhe të gjobave, që nuk janë zbatuar deri tash, domethënë këtyre tiketave të famshme që shkojnë deri në 80 apo 90%, se edhe Policisë i merr shumë kohë edhe normalisht, se edhe buxhetin e dëmtojnë diku, me një vlerësim, diku 4-5 milionë brenda vitit. Mendoj dhe i thërras institucionet që këtë ligj ta zbatojnë me qëllim të arritjes së efektit, së pari të mbrohen jetët e njerëzve, që thash se janë në trend të rritjes, dëmet e mëdha materiale, lëndimet me invaliditet, por edhe aspekti material, sepse dëmtohet edhe buxheti i Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Beqaj, në ndërkohë e ka kërkuar fjalën.

BESIM BEQAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

Nuk e di, ndoshta kryetarit të komisionit i ka ikur informata rreth kërkesës që ne e kemi bërë si komision për Kryesinë e Kuvendit, është që lekturimi i ligjeve të mos bëhet në kuadër të zyrave për lekturë, ku nuk dihet se kush është lektori, mirëpo të bëhet edhe në ligj, në secilin ligj të shkruhet se kush është lektori dhe ta mbajë përgjegjësinë e lekturës.

Ajo me çfarë po ballafaqohemi në mënyrë të rregullt, kemi ligje të cilat, jo vetëm që nuk kuptohen për materien të cilën ato pretendojnë ta rregullojnë, por nuk kuptohen as gjuhësisht fjalitë të cilat duhet të thuhet nëpër ato ligje. Prandaj, për ta parandaluar një gjë të tillë, unë propozoj që Kryesia t'ia dërgojë një shkresë Qeverisë, që paraprakisht secili ligj që na vjen në Kuvendin e Republikës së Kosovës të jetë i lekturuar nga lektori me emër dhe mbiemër, i cili duhet të bartë përgjegjësinë për këtë lekturë. Faleminderit!

KRYETARI: Zoti Mustafa e ka fjalën dhe zoti Konjufca e paska kërkuar në ndërkohë.

MUHAMET MUSTAFA: Unë e falënderoj kolegun Beqaj që perkujtoi me të vërtetën, s'e thash unë, sepse mendova që e thotë Raifi, edhe ne kemi marrë qëndrim që një shkresë të ngjashme me këtë që e tha kolegu Beqaj, me shkrim t'i drejtohet Kryesisë, në mënyrë që lektura të ndryshojë një procedurë e përgatitjes së ligjeve, në mënyrë që teksti të na vijë i lekturuar dhe redaktuar dhe le të dihet se kush e mbanë përgjegjësinë. Domethënë, ky ka qenë qëndrim i komisionit.

KRYETARI: Ju lutem, deputetëve u kërkoj që të qëndrojnë, se e kemi menjëherë edhe votimin, për dy minuta. Zoti Konjufca dhe menjëherë futemi në votim.

GLAUK KONJUFCA: Është me të vërtetë skandaloze ajo që tregoi zoti Qela, në një ligj me 900 rreshta të jenë 1 000 gabime. Po unë e hulumtova pak këtë problem dhe e di ku është arsyeja dhe dëshiroj ta ndaj me ju. Po më duket se lektorin e ka punësuar Adem Grabovci.

KRYETARI: Edhe legjendë keni për ta bërë bacën Adem. Urdhëroni, zoti Gashi.

ARBEN GASHI: Faleminderit, kryetar!

Vetëm për procedurën, se u hodhën shumë ide këtu për çështjen e lekturës.

Në momentin kur ligji dërgohet prej Qeverisë në Kuvend, nuk guxon kurrkush ta prekë as të ndërhyjë, as ta lekturojë, përveçse në procedurë të rregullt kuvendare. Kështu që, ligji në formën qysh vjen prej Qeverisë dërgohet drejt në Kuvend dhe në trupat e veta, në komisione dhe seancë. Nuk mund të ndërhyjë kurrkush, asnjë lektor, as kurrkush.

Prandaj, kërkesa mund t'i drejtohet Qeverisë për t'i rritur kapacitetet, por jo në Kuvend, në procedurë kuvendare jo të rregullt të ndërhyhet në ligj, sepse do të krijohet një precedent shumë i rrezikshëm dhe mund të keqpërdoret. Faleminderit!

KRYETARI: Urdhëro, zoti Beqaj!

BESIM BEQAJ: Zoti kryetar,

Si duket, ose nuk kam qenë i qartë unë, ose ndoshta ka qenë keqkuptim.

Kërkesa jonë është që Qeveria t'i lekturojë para se t'i sjellë në Kuvend. Pra, kur të vijë ligji në Kuvend, të jetë i lekturuar e pa gabime, sepse na çmendën me gjithë këto farë shkresash dhe inovacionesh në drejtshkrim, të cilat nuk mund t'i kuptojë askush. Faleminderit!

KRYETARI: Zoti Selimi e ka fjalën dhe shkojmë në votim.

REXHEP SELIMI: Gati desha të tërhiqem prej asaj çfarë u fol këtu, por ta kemi parasysh një. Me gjithë respektin e punës që ka bërë grupi punues për këtë punë, po në Kuvend për amandamentim sillen çështjet përmbajtjesore dhe ndryshimet logjike, por jo edhe gabimet e lekturës, për shkak se ekziston kjo në Kuvend dhe tash s'po dua ta përsëris atë që e tha zoti Beqaj, por mendoj që edhe gabimet drejtshkimore nuk do të duhej të vinin si amendamente, se ekziston lektori në Kuvend. Për ata që s'e dinë gjuhën shqipe po flas, për ata që e dinë s'ka nevojë.

KRYETARI: Atëherë, të shkojmë drejt votimit. Sa për informim, në draft-Rregulloren e re është paraparë që të jetë edhe kush e lekturon, ta kemi parasysh.

Shkojmë në votimin e 263 amendamenteve, e patëm aprovimin e seancës. Aktualisht janë 67 deputetë në sallë. Votojmë për 263 amendamente në mënyrë të përbashkët. Kush është kundër? A ka abstenim? Aprovohen të gjitha 263 amendamente.

Votojmë tekstin e projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara. Kemi ardhjen edhe të tre deputetëve, në sallë jemi 70 vetë. Përgatitemi për votim. Kush është kundër? Bëhemi 72 deputetë në sallë. A është dikush kundër? A ka abstenim?

Atëherë, Kuvendi e miratoi Ligjin për rregullat e trafikut rrugor me 72 vota për.

14. Shqyrtimi i raportit vjetor të Qeverisë së Republikës së Kosovës për funksionimin e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm të Financave Publike në Sektorin Publik të Kosovës për vitin 2015

Komisioni Funksional për Mbikëqytjen e Financave Publike e ka shqyrtuar raportin vjetor të Qeverisë së Republikës së Kosovës për funksionimin e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm të Financave Publike në Sektorin Publik të Kosovës për vitin 2015 dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij bashkë me rekomandimet e propozuara. Ftoj ministrin e Financave, zotin Abdullah Hoti, që ta marrë fjalën si propozues.

MINISTRI ABDULLAH HOTI: I nderuar kryetar i Kuvendit,
Të nderuar deputetë,

Ministria e Financave në pajtim me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe Ligjin për auditim të brendshëm, ka përgatitur raportin vjetor për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të financave publike për vitin 2015.

Raporti paraqet të arriturat, gjetjet dhe masat që duhet të ndërmerren për përmirësimin e sistemit të kontrollit të financave publike.

Të dhënat kryesore për përgatitjen e këtij raporti janë siguruar nga pyetësorët vetëvlerësues të pranuar nga organizata buxhetore, nga raporte vjetore nga njësitë e auditimit të brendshëm, nga plane strategjike dhe vjetore të auditimit të brendshëm, nga monitorimi i njërive të auditimit të brendshëm, nga raportet e auditorit të përgjithshëm, nga raporti i progresit, raporti i SIGMA-s, të OSID-s, intervista dhe informata të tjera, të mbledhura nga trajnimet dhe seminarët e ndryshme.

Më lejoni në vijim të përmend disa nga aktivitetet e ndërmarra në fushën e menaxhimit financiar, kontrollit dhe auditimit të brendshëm gjatë vitit 2015. Është përgatitur dhe aprovuar në Qeveri fillimisht, strategjia për kontrollin e brendshëm të financave publike për periudhën 2015/2020, është përgatitur koncept dokumenti për Ligjin e kontrollit të brendshëm të financave publike, i cili është aprovuar në Qeveri, janë përgatitur modulet për trajnimin e auditorëve të brendshëm për programin për certifikim vendor, janë rishikuar dhe janë avancuar pyetësorë vetëvlerësues për organizatat buxhetore.

Disa nga të arriturat në fushën e menaxhimit financiar të kontrollit janë si në vijim: nga 108 organizata buxhetore, të cilave u janë shpërndarë pyetësorë vetëvlerësues 95 prej tyre kanë plotësuar këta pyetësorë, që përbën një rritje prej 6,7% krahasuar me vitin paraprak; është shënuar përmirësim në cilësinë e informatave të raportuara përmes pyetësorëve vetëvlerësues të përgatitur nga zyrtarët kryesorë administrativë dhe zyrtarët financiar. Kjo është rritur falë trajnimeve të shumta, që janë organizuar nga njësia qendrore harmonizuese e Ministrisë së Financave.

Në përgjithësi, vlerësoj se vërehet një vetëdije më e lartë në nivelin menaxherial të organizatave buxhetore për menaxhimin financiar dhe për kontrolle.

Së i përket auditimit të brendshëm Ligji nr. 03/L-128 për auditim të brendshëm dhe Udhëzimi Administrativ 23/2009 për themelimin dhe funksionimin e njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik i përcaktojnë kërkesat, që çdo organizatë buxhetore duhet të zbatojë, sa i përket funksionimit të auditimit të brendshëm.

Gjatë vitit 2015 funksioni i auditimit të brendshëm kryesisht është zbatuar nga njësitë e pavarura të auditimit të brendshëm të themeluara brenda organizatave buxhetore. Në disa raste shërbimi i auditimit të brendshëm është kryer nga Departamenti i auditimit të brendshëm në Ministrinë e Financave me kërkesë të organizatave buxhetore përkatëse.

Funksionin e auditimit të brendshëm gjatë vitit 2015 e kanë ushtruar 71 njësi të auditimit të brendshëm në nivel qendror dhe në nivel lokal, prej të cilave 5 njësi të auditimit të brendshëm funksionojnë në kuadër të nënsubjekteve të organizatave buxhetore. Shtatë organizata buxhetore funksionin e auditimit të brendshëm e kanë kryer përmes Departamentit të auditimit të brendshëm nga Ministria e Financave, si Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave, Instituti Gjyqësor i Kosovës, Autoriteti Kosovar i Konkurrencës, Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik, Ministria e Diasporës, Këshilli Kosovar për Trashëgimi Kulturore dhe Agjencia Kosovare Kundër Korrupsionit.

Funksionin e auditimit të brendshëm gjatë vitit 2015 nuk e kanë kryer zbatuar këto organizata buxhetore: Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale, Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Zyra Rregullative e Ujit dhe Mbeturinave, Autoriteti i Aviacionit Civil, Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës, Autoriteti Rregullativ i Komunikimit Elektronik dhe Postar, Zyra Rregullatore e Energjisë, Komisioni për Ndihmë Juridike, Agjencioni Shtetëror për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Komuna e Mamushës, e Zubin Potokut, e Zveçanit, e Hanit të Elezit, e Kllokotit dhe e Parteshit.

96% e njësive të auditimit të brendshëm kanë raportuar për aktivitetet e tyre të zhvilluara në organizatat përkatëse në nivel qendror dhe në nivel lokal, që është një rritje prej 1,5% krahasuar me vitin paraprak. Njësitë e auditimit të brendshëm për vitin 2015 kanë kryer 489 auditime të brendshme, që është një realizim i planit prej 2% më shumë se sa që është planifikuar fillimisht. Por, kjo nuk do të thotë që të gjitha njësitë i kanë realizuar plotësisht planet e tyre. Janë kryer auditime edhe me kërkesë të zyrtarëve kryesorë administrativë të organizatave buxhetore.

Në përgjithësi vlerësojmë, se janë ngritur kapacitete të auditimit të brendshëm përmes trajnimit në fushat për vlerësimin e cilësisë, planifikimit strategjik dhe vjetor, shkëmbimin e përvojave në mes auditorëve të brendshëm dhe organizatave të tyre buxhetore.

Lidhur me komitetet e auditimit gjatë vitit 2015, 53 komitete të auditimit e kanë ushtruar funksionin e tyre në nivel qendror dhe në nivel lokal. Me komitete të auditimit janë mbuluar 58 subjekte të sektorit publikë, ose 81,69% të organizatave buxhetore. Kjo reflekton faktin që komitetet e auditimit kanë mbuluar disa institucione, që janë të ndërlidhura dhe vartëse të subjektit të sektorit publik. Për shembull, Ministria e Financave ka themeluar një komitet të auditimit, që mbulon Ministrinë, ATK-në, Doganën, Thesarin; Ministria e Punëve të Brendshme

ka themeluar një komitet auditimi për Ministrinë, për Inspektoratin Policor të Kosovës, Akademinë e Kosovës për Siguri Publike.

Mirëpo, ende ka edhe disa komuna dhe agjenci të pavarura, edhe pse kanë krijuar njësi të brendshme të auditimit, nuk kanë themeluar komitetin e auditimit, siç është: Komuna e Malishevës, e Gjakovës, e Klinës, e Shtërpçës, Ranillugut, Obiliqit, Institucioni i Avokatit të Popullit, Agjencia Kosovare e Privatizimit, Agjencia Kosovare e Pronës.

Sipas informatave tona, anëtarët e komiteve të auditimit kanë kualifikime të larta shkollore, të cilat janë kualifikuar në fushën e ekonomisë kryesisht, pastaj të auditimit, shkencave juridike, administratë publike dhe fusha tjera përkatëse, që i bën ata kompetentë për kryerjen e detyrave të tyre ligjore, në kuadër të komitetit të auditimit.

Megjithatë, ne jemi përballë me disa sfida gjatë vitit 2015, sa i përket menaxhimit të kontrollit dhe auditimit të brendshëm, si në vijim: edhe pse tani menaxhmenti e kupton mirë rolin e menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe vetë përgjegjësinë menaxheriale, ende nevojitet angazhim për përmirësimin e planifikimit dhe ekzekutimit të buxhetit, për zbatimin e Ligjit të prokurimit, për zbatimin e Ligjit sa i përket rekrutimit të stafit, për menaxhimin e pasurisë, për raportimin dhe arkëtimin e të hyrave, për menaxhimin e obligimeve financiare, e tjera.

2. Ekziston një numër i madh i agjencive të pavarura, që janë të vogla nga aspekti i personelit, buxhetit dhe pasurive, në një kohë që këto shërbime mund të kryhen si shërbime të përbashkëta, duke fuqizuar strukturat e këtyre shërbimeve dhe duke i zvogëluar fondet publike që përdoren për këto qëllime.

Mendoj që hapi i parë është ndërmarrë në këtë drejtim përmes kryerjes së prokurimeve nga ana e organizatës buxhetore mbikëqyrëse, ose nëpërmjet Agjencisë Qendrore të Prokurimit për ato organizata që kanë nën 50 punëtorë.

Procesi i menaxhimit të rrezikut dhe vendosjes së kontrolleve në disa organizata buxhetore për fushat me rrezik të lartë, ende vazhdon të mbetet sfida për menaxhmentin. Disa organizata buxhetore ende nuk kanë identifikuar, ose nuk kanë analizuar dhe vlerësuar regjistrin e rrezikut të tyre.

Përdorimi i aplikacioneve të ndryshme softuerike ka ndikuar që të mos kemi informata të plota për pasurinë publike, por që është duke u kompletuar edhe kjo fushë. Unë ju falënderoj për vëmendje. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Faleminderit! Kryetari i Komisionit Funkcional, respektivisht zoti Topalli, por zoti Topalli s'është këtu. Zoti Damka, atëherë e ka fjalën, ose kush? Besa Baftiu. Në emër të komisionit, zoti Damka e ka fjalën, në emër të grupit Besa. Faleminderit, që s'e keqpërdorët.

FIKRIM DAMKA: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike në bazë të nenit 69, paragrafi 5 i shtojcës nr. 2, pika 13 e Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 22 qershor 2016 shqyrtoi raportin vjetor të Qeverisë së Republikës së Kosovës për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të financave publike në sektorin publik të Kosovës për vitin 2015 dhe vendosi që Kuvendit t'i paraqesë këtë:

Rekomandim

Njësia qendrore harmonizuese e auditimit të brendshëm në afatin kohor sa më të shkurtër, të hartojë planin e veprimit dhe adresimin e dobësive të vlerësuar në raportin e vjetër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të financave publike në sektorin publik, në veçanti për këto rekomandime:

1. Me qëllim të auditimit të brendshëm nëpër organizata buxhetore të jetë më efektiv njësia qendrore e harmonizuese e auditimit të brendshëm, duhet të bëjë monitorimin e aktiviteteve të auditimit të brendshëm dhe të kërkojë, që njësitë e auditimit të brendshëm nëpër organizata buxhetore të bëjnë një planifikim të arsyeshëm të aktiviteteve vjetore, ku përfshihet numër i madh i auditimeve.
2. Me qëllim të ngritjes së bashkëpunimit në mes auditimit të brendshëm dhe menaxhmentin të njësisë qendrore harmonizuese të auditimit të brendshëm të planifikojë tryezë diskutimi, nëse është nevoja edhe trajnime për menaxhmentin, në mënyrë që të kuptohet drejt funksioni dhe roli i auditimit të brendshëm.
3. Me qëllim të ngritjes së vazhdueshme profesionale për stafin e auditimit të brendshëm Komisioni i Financave Publike rekomandon njësisë qendrore hulumtuese të vazhdojë trajnimin dhe licencimin e auditorëve të brendshëm në sektorin publik.

Nën 2. Qeveria e Republikës së Kosovës në afatin sa më të shkurtër kohor të hartojë planin e veprimit për adresimin e dobësive të vlerësuar në raportin vjetor të Qeverisë së Republikës së Kosovës për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të financave publike në sektorin publik, në veçanti. Të themelojë njësi auditimi të brendshëm aty ku ka mundësi ligjore dhe buxhetore, ndërsa aty ku njëra nga këto mundësi mungon, atëherë këto shërbime t'i marrë nga organizata tjera buxhetore, siç kanë bërë edhe gjatë vitit 2015 disa organizata buxhetore.

Me qëllim të ngritjes së pavarësisë së auditimit të brendshëm nëpër organizata buxhetore të formohen komitete auditimi, ose këto funksione të merren si shërbim nga ndonjë organizatë buxhetore tjetër.

Qeveria duhet të obligojë çdo organizatë buxhetore, që të plotësojë formularin e vetëvlerësimit në mënyrë profesionale dhe objektive, në mënyrë që të pasqyrohet një gjendje e vërtetë e sistemit të kontrollit të brendshëm në organizatën buxhetore dhe njëkohësisht kjo të vërtetohet nga njësia e auditimit të brendshëm gjatë vitit.

Qeveria duhet të obligojë të gjitha organizatat buxhetore, që të implementojnë të gjitha rekomandimet e auditimit të brendshëm.

Unë thërras deputetët që të votojnë këto rekomandime. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, zoti Fetahu e ka fjalën.

NAIM FETAHU: I nderuar kryesues i Kuvendit,

I nderuar ministër,

Të nderuar deputetë,

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike në bazë të nenit 69, paragrafi 5 dhe shtojcës numër 2, pika 13 e Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 22 qershor 2016 e shqyrtoi raportin vjetor të Qeverisë së Republikës së Kosovës për funksionimin e sistemit të kontrollit publik.

Raporti përmbledh vetëvlerësimin e bërë nga zyrtarët kryesorë financiarë të organizatave buxhetore dhe të auditorëve të brendshëm, lidhur me funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, e kombinuar me gjetjet e njësisë qendrore harmonizuese. Nga 108 organizata buxhetore, të cilat kanë pranuar formularë të vetëvlerësimit, 95 prej tyre i kanë plotësuar apo 87,9%.

Sfidat kryesore gjatë vitit 2015, sa i përket kontrollit të brendshëm financiar janë: dobësitë janë pothuajse me ato të vitit paraprak 2014 e këto janë në planifikimin dhe ekzekutimin e buxhetit, mangësitë në zbatimin e Ligjit të prokurimit publik, mangësi në Ligjin e pagave dhe Ligjin e shërbimit civil, e në veçanti në rekrutimin e stafit, menaxhimin e pasurisë, raportimin e të hyrave, krijimin e obligimeve financiare.

Njësitë e auditimit të brendshëm, funksionin e Auditorit të Brendshëm gjatë vitit 2015 e kanë ushtruar 71 njësi të auditimit të brendshëm. Shtatë organizata buxhetore funksionimin e auditimit të brendshëm e kanë kryer përmes Departamentit të brendshëm në Ministrinë e Financave, ndërsa më shqetësuese është se funksionimi i auditimit të brendshëm gjatë vitit 2015 nuk e kanë kryer 17 organizata buxhetore.

Nëse e krahasojmë me vitin e kaluar, kemi një rritje të numrit të auditimit nga 49 në 53, ose me 8,6% më shumë. Mirëpo, kemi ende organizata buxhetore, të cilat nuk e kanë krijuar komitetin e auditimit.

Çështja më shqetësuese është adresimi i rekomandimeve të organizatave buxhetore, pra nga 2499 rekomandime të dhëna në 2015 deri më tani janë adresuar vetëm 54% të këtyre rekomandimeve, 26% janë proces dhe 24% nuk janë adresuar fare.

Bazuar në këtë Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike ka përgatitur edhe rekomandimet, të cilat ju ftoj që t'i përkrahim së bashku. Rekomandimet i lexoi nënkryetari i komisionit dhe në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, kërkoj që t'i mbështesim njëzëri.

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të LDK-së nuk është paraqitur askush. Ali Sadriu e ka fjalën.

ALI SADRIU: Faleminderit, zoti kryesues!

Edhe Grupi Parlamentar i LDK-së e ka shqyrtuar këtë raport me vëmendje të veçantë dhe një analizë konkrete.

Në të gjitha fushëveprimet e punës së saj vërehet në raport edhe nga të dhënat konkrete, se krahasuar me vitet e kaluara kemi një progres të theksuar në adresimin e çështjeve dhe në iniciativat për tejkalimin e problemeve, që na kanë përcjellë vite me radhë.

Vlen të përhëndetet se për herë të parë ka filluar trajnimi prej ekspertëve kosovarë të numrit të ardhshëm të auditorëve, gjë që nuk e kemi pasur, por kjo çështje është kryer prej trajnerëve ndërkombëtarë. Kjo është diçka që na premtonte, se në të ardhmen shpejt do të kemi fushë të mbuluar me auditorë, prej nga edhe rrjedhin këto çështje. Ne e përkrahim atë dhe i japim fuqimisht përkrahje gjithë këtij procesi.

Në adresimet dhe rekomandimet që i ka dhënë komisioni, mendoj se Qeveria, besojmë se do të reflektojë në to dhe raportin e vitit të ardhshëm do ta kemi edhe më të avancuar. Prandaj, ne i rekomandojmë seancës, që këtë raport me këto rekomandime ta miratojë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Baftija e ka fjalën.

BESA BAFTIJA: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Më 31 mars të këtij viti ministri i Financave, Abdullah Hoti i ka dorëzuar Qeverisë dhe Kuvendit raportin e njësisë qendrore për sistemin e kontrollit të brendshëm të financave publike. Fjala është për një vetëvlerësim të performancës së organizatave buxhetore, duke filluar nga institucionet e pavarura, komunat e deri tek ministritë.

Edhe pse, ka kohë që ky raport ka kaluar në Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike në Kuvend, po sillet me shumë vonesë. Besoj që secili që ka lexuar këtë raport, nuk mund të mos e ndjejë veten të shqetësuar për këtë situatë. Kjo vonesë mbase ka të bëjë me një përpjekje të Qeverisë për të diskutuar raportin në kohë pushimesh, në mënyrë që sa më pak qytetarë të njoftohen për kaosin që mbretëron nëpër institucionet tona.

Thelbi i raportit thotë se gjendja është alarmante. Në institucionet tona nuk ka kontroll të brendshëm mbi financat publike. Kjo është skandaloze. 12% e institucioneve të Kosovës nuk i raportojnë fare ministrit Hoti për mënyrën, se si i menaxhojnë financat publike. Të gjitha organizatat buxhetore thonë se ka nevojë për ndryshime. varësisht nga fusha, kërkesat për ndryshime shkojnë nga 34 deri në 77%. Në të gjitha fushat, për të cilat është bërë vlerësimi del se ka probleme të mëdha. Pra, nuk ka procedura të brendshme të punës, nuk ka përkrahje të detyrave të punës, nuk ka planifikim, nuk ka ndarje të përgjegjësisë, nuk ka trajtim të konfliktit të interesit, nuk ka procedura për raportimin e shkeljeve.

Kur nuk ndahet përgjegjësia, kur nuk ka kontroll, ka vetëm kaos, keqmenaxhim dhe pse jo edhe keqpërdorim të parasë publike. Karshi disa institucioneve të tjera i kemi edhe pesë komuna me shumicë të popullsisë serbe, si Leposaviqin, Zubin-Potokun, Zveçanin, Klllokotin, Mitrovicën e Veriut, të cilat marrin para nga Buxheti i Kosovës, por nuk i përgjigjen, as ministrit Hoti, as Qeverisë e as Auditorit të përgjithshëm. Në këto komuna, pra nuk shtrihet sovraniteti i Republikës së Kosovës. Kjo gjendje nuk është e re, ka qenë kështu edhe në vitin 2014, por prej ardhjes së koalicionit të madh PDK-LDK në pushtet, gjendja është për 8% më e keqe. Pra, nuk kemi përmirësim, por kemi përkeqësim.

Zoti Hoti është përgjegjës kryesor për mbledhjen, planifikimin, shpërndarjen së financave publike, për kontrollimin e shpenzimeve. Zyrtarët që kanë bërë vetëvlerësimin në organizata të ndryshme buxhetore, thonë se mbretëron një kaos në organizim dhe planifikim. Edhe pse gjendja është kaotike, edhe pse raporti nuk është i jashtëm por i brendshëm, pra nuk mund të thuhet se është tendencioz, Qeveria e Republikës së Kosovës deri më sot nuk ka treguar se ka marrë ndonjë hap konkret për të ndryshuar këtë situatë.

Raportet e auditimit që janë publikuar më vonë, tregojnë se sa e rëndë është situata në organizatat e ndryshme buxhetore, duke filluar prej mungesës së kontrollit të brendshëm, tejkalimit të përgjegjësisë të zyrtarëve, keqpërdorimit të mjeteve financiare, problemeve të mëdha në tenderim e deri te keqpërdorimi i shpenzimit të buxhetit.

Përkundër faktit që ky raport sjell shumë të dhëna për mungesën e kontrollit tek financat publike, ai është i mangët në dhënien e informacioneve, më konkretisht, sa i përket organizatave buxhetore që kanë bërë shkelje. Ai është i përgjithësuar dhe nuk lë mundësinë për të krijuar një botëkuptim më të qartë se cilat organizata buxhetore kanë bërë shkelje, cilët janë përgjegjësit kryesorë, cilat janë masat që kanë ndërmarrë organizatat buxhetore ndaj shkelësve të ligjit dhe keqpërdoruesve të detyrave zyrtare.

Për këtë arsye, ne ju ftojmë që raporti të mos miratohet, por të jepet një afat prej 30 ditësh, që të plotësohet me informacione të nevojshme, që të japin të dhëna më konkrete, se si është gjendja në secilën organizatë buxhetore, cilët janë përgjegjësit për situatën, cilat janë masat që janë ndërmarrë ndaj atyre që nuk i kanë kryer detyrat, respektivisht që kanë rënë ndesh me ligjin.

Nga Qeveria kërkojmë që brenda një afati prej 30 ditësh të sjell një raport për masat që ka ndërmarrë ndaj keqpërdoruesve të detyrave dhe masave konkrete për përmirësimin e kontrollit të brendshëm. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Shukri Buja.

SHUKRI BUJA: Të nderuar deputetë,

I nderuar kryesues,

Në këtë raport, sidomos në rekomandimet që i jep Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike është dhënë një informatë, kur flitet për komitetet e auditimit dhe njësisë nëpër institucionet publike, është dhënë edhe për pushtetin lokal, e në veçanti, që është shumë shqetësuese, edhe për komunën e Lipjanit apo në veçanti potencohet komuna e Lipjanit.

Të nderuar deputetë,

Në Lipjan ka pasur njësi të auditimit të brendshëm me tre auditorë të licencuar, të rekrutuar në bazë të Ligjit për rekrutimin e stafit civil dhe në bazë të Udhëzimit Administrativ 23/2009 lëshuar nga Ministria e Financave, ku thuhet në nenin 3, pika 2.3, subjekti i sektorit publik me buxhet mbi 5 milionë euro duhet të ketë të paktën 3 auditorë të brendshëm.

Tani, në Lipjan në kundërshtim me këtë Udhëzim Administrativ, në kundërshtim me statutin komunal, në kundërshtim me Ligjin e shërbyesve civilë, janë larguar dy auditorë të brendshëm, duke e lënë komunën me vetëm një auditor. Dy auditorëve të brendshëm u është ulur koeficienti i pagës nga 15 në 7 dhe janë sistemuar në kundërshtim me ligjin.

Po ashtu, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës si organ i këtij vendi ka marrë vendim që këta auditorë t'i rikthejë në pozitat e tyre. Ky vendim nuk është respektuar nga kreu i ekzekutivit, që potencohet edhe në raportin e këtij organi të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës i raportuar në qershor të vitit të kaluar nga Kuvendi, ku është edhe aprovuar.

Po ashtu, auditori i jashtëm për dy vjet rresht thekson, po citoj: “Kjo lëvizje e stafit të auditimit në pozita tjera ndikon në mosbesimin e kredibilitetit të kontrollit të brendshëm dhe mosrealizimin e planit vjetor. Për moszbatim të vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbyesve Civilë, e që në Lipjan janë shtatë, që janë të pazbatueshme apo nuk janë zbatuar, ka procedura ligjore të cilat i rregullon Ligji për vetëqeverisjen lokale, dhe ligjet tjera të cilat duhet t'i zbatojë Ministria e Pushtetit Lokal e që nuk i ka zbatuar.

Po ashtu, ka procedura ligjore të cilat duhet t'i zbatojë kryeministri i Kosovës i cili është i njoftuar nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës, por nuk i ka zbatuar dhe nuk di deri kur ne do të vazhdojmë me moszbatim të ligjit edhe kur është fjala për bashkëpartiakët. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Sadriu e keni kërkuar sërish fjalën. Zoti Sadriu e ka fjalën.

ALI SADRIU: Faleminderit, zoti kryesues!

Ndër të tjera, pati një vërejtje se raporti po vjen i vonuar dhe raportet po vijnë të vonuara.

Është shumë e vërtetë, që Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike në veçanti në këtë legjislacion po ka ngecje në punën e vet. Më vjen mirë, që zotërinjtë e “Vetëvendosjes” në mënyrë të spikatur orvaten që t'i prezantojnë gjërat, por më vjen keq që pa fakte.

Do të kishte qenë më mirë, sikur shoqja Besa t'i drejtohej kryetarit të komisionit, i cili vjen nga radhët e “Vetëvendosjes” dhe jo rastësisht ky komision i takon opozitës, që në mënyrë permanente dhe profesionale ta korrektojë Qeverinë në gabimet e veta. Unë po deklaroj këtu dhe para seancës në biseduam edhe me kryetarin e Kuvendit dhe sekretarin, se ky komision do të duhej trajtuar ndryshe.

Që nga themelimi, që nga funksionimi i kësaj legjislature, në këtë komision kemi pasur ngecje. Kanë pasur njëherë një kryetar tjetër, i cili ka shkuar në Amerikë ku ka ndenjur një dy-tre muaj, pastaj nuk kanë qenë prezentë në Kuvend, e kanë bojkotuar Kuvendin dhe normalisht që s'ka pasur edhe kuorum. Dhe, tani po u them se kryetari i ri që e kanë deleguar, komisionin e ka çuar

në pushim, kundër rregullores, sepse komisioni apo deputetët shkojnë në pushim vetëm me urdhrin dhe vendimin e Kuvendit e jo të kryetarit të komisionit. Por, megjithatë, komisioni është orvatur në kuadër të kapaciteteve që ka pasur, në mënyrë të spikatur ta analizojë tërë materien dhe shumëçka që u tha nga disa diskutues qëndrojnë aty dhe rekomandimet janë dhënë pikërisht për korrektimin e tyre, që nuk mund të mohohet se ka progres dhe indikacionet që të shkojë drejt progresit janë po aty. Prandaj, rekomandimi i komisionit është që të miratohet me këto rekomandime, ky raport. Faleminderit!

KRYEUSEI: Faleminderit! Zoti Abdyl Ymeri e ka fjalën.

ABDYL YMERI: Faleminderit, nënkryetar!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Raporti është në pajtim me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe Ligjit për auditimin e brendshëm. Në tërësi paraqet të arritura të buxhetit dhe masat që duhet të ndërmerren për përmirësimin e sistemit të financave publike. Njësia qendrore e harmonizimit ka shpërndarë pyetësorët vetëvlerësues 108 organizatave buxhetore, 95 prej tyre i kanë plotësuar dhe krahasuar. Në vitin 2014 kemi një rritje prej 6,74%.

Nëse shikojmë grafikun në faqen 9, që tregon nivelin e mjedisit të kontrollit, që është bazuar nga përgjigjet e marra nga organizatat buxhetore dhe nëse e krahasojmë me vitin 2014, shohim se kemi një vlerësim më të ulët për 6,62%.

Për të përmirësuar mjedisin e kontrollit duhet të përqendrohemi në procedura të brendshme, harmonizimin e planeve, në kornizën afatmesme të shpenzimeve dhe buxhetit, hartimin dhe monitorimin e planeve konkrete. Edhe sa i përket menaxhimit të rrezikut, kemi një vlerësim më të ulët për 6,70% krahasuar me vitin paraprak.

Në raport shihet, se disa organizata buxhetore ende nuk kanë identifikuar, analizuar, vlerësuar dhe përgatitur regjistrin e rrezikut. Organizatat buxhetore aktivitetin e kontrollit e kanë vlerësuar me 2,55 pikë nga maksimumi prej 3 pikësh dhe nëse e shikojmë grafikun në faqen 17, shohim se kemi një vlerësim më të ulët për 7,84%, krahasuar me vitin 2014.

Sa i përket informimit dhe komunikimit, nga të dhënat e pasqyruara në tabelë, nga përgjigjet e marra nga organizatat buxhetore, shihet se kemi një vlerësim me 2,62 pikë dhe nëse shihet grafiku, shohim se kemi një vlerësim më të ulët për 6,67% krahasuar me vitin paraprak. Monitorimi është një komponentë e rëndësishme e sistemit të brendshëm dhe nëse e analizojmë këtë komponentë, shohim se menaxhmenti i organizatave buxhetore duhet të jetë prioritet me qëllim të përmirësimit në mënyrë të vazhdueshme të sistemit të brendshëm.

Monitorimi është vlerësuar me 2,35 pikë dhe nëse e krahasojmë me vitin 2014, shohim se kemi një vlerësim më të ulët për 9,97%. Në raport shihet se funksionimin e auditimit të brendshëm gjatë vitit 2015 e kanë ushtruar 71 njësi të auditimit të brendshëm në nivel qendror dhe lokal, ndërsa janë krijuar 53 komitete të auditimit, që do të thotë se kemi ende disa komuna dhe agjenci të pavarura, që nuk e kanë krijuar komitetin e auditimit.

68 njësi të auditimit të brendshëm kanë dorëzuar planin strategjik dhe vjetor në njësinë qendrore të harmonizimit, ose shprehur në përqindje 95,77%, krahasuar me vitin paraprak, që do të thotë se kemi një rritje prej 1,5%

Njësitë e auditimit të brendshëm kanë kryer 489 auditime të brendshme, ose 0,41% më shumë se vitin 2014. Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave ka dhënë disa rekomandime të cilat do të ndihmojnë në përmbushjen e obligimeve dhe detyrave për njësinë qendrore të harmonizimit, si dhe organizatave buxhetore, me qëllim të përmirësimit të parimeve dhe standardeve të kontrollit të brendshëm dhe auditimit të brendshëm. Faleminderit!

KRYESUESI: Zonja Baftija, replikë a? Ke të drejtë.

BESA BAFTIU: Faleminderit, kryesues!

Sa për informim, ky raport në komision ka kaluar diku në maj, e tani jemi në muajin gusht. Ajo që e kam thënë qëndron. Për atë që pati ankesa kolegu, atëherë nëse vetëm kryetarit i lihen të gjitha punët, çfarë logjike ka që është nënkryetari i parë dhe nënkryetari i dytë? Faleminderit!

KRYESUESI: Kundër-replikë, zoti Sadriu.

ALI SADRIU: ...e që në maj është shqyrtuar dhe është debatuar, por konkluzat dhe rekomandimet janë nxjerrë në fund të muajit qershor dhe roli dhe rëndësia e kryetarit është e paevitueshme, sepse ai thërret seancat dhe ai e determinon shkallën e intensitetit të punës.

Është shumë e vërtetë që nënkryetarët e kryejnë funksionin, por s'mund t'ua kryejnë juve me 5-6 muaj, qoftë për qejf, qoftë për detyrë. Ju thashë herën e parë, kryetarin e komisionit e keni pasur në Amerikë për çështje private një 3 muaj, herën e dytë s'keni marrë pjesë fare në Kuvend dhe disa muaj pastaj kryetarin tjetër e keni çuar dhe faktikisht kemi mbajtur me të 3 takime dhe asgjë më shumë.

Prandaj, kolege, nuk e dhashë për vlerësim, mendoj se diskutimi im është një kontribut i mirë për "Vetëvendosjen", sepse ky komision i dedikohet pikërisht opozitës dhe funksionimi i këtij komisioni i jep shumë argumente për të diskutuar dhe korrigjuar procesin e Qeverisë. Nuk korrektohen me deklaratat për opinion, por me punë konkrete. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Beqaj e ka fjalën.

HAJDAR BEQAJ: Faleminderit, kryesues!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

U tha edhe nga parafolësit, realisht Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike është një ndër komisionet shumë me rëndësi dhe pikërisht kjo ndoshta është arsyeja pse udhëhiqet nga opozita dhe mendoj, se në këtë rast opozita e ka mundësinë që për mes këtij komisioni ta shikojë dhe ta bëjë një kontroll ndaj Ekzekutivit, sepse u pa këtu edhe në raport, se ka nevojë për përmirësime.

Ne si komision më 22 qershor e kemi shqyrtuar raportin e Qeverisë për vitin 2015, në këtë rast më 22 qershor i kemi dhënë edhe rekomandimet tona, ku të gjithë anëtarët e komisionit, si pozitë, si opozitë, kemi qenë unikë në këto rekomandime. Edhe sot i mbështetim dhe në të njëjtën kohë kërkojmë nga të gjithë deputetët që t'i mbështesin, me qëllim që të rritet niveli i kontrollit të brendshëm, sepse është në interes të qytetarëve të jenë më transparentë për çdo cent i parasë publike, që shpenzohet, të jenë të informuar edhe qytetarët.

U tha edhe nga shumë anëtarë këtu të komisionit, u lexuan rekomandimet nga nënkryetari dhe anëtarët e tjerë të komisionit. Unë do të ndalem edhe një herë te sfidat kryesore gjatë vitit 2015, që ishin dobësitë në procesin e planifikimit dhe ekzekutimit të buxhetit, mangësitë në zbatimin e Ligjit të prokurimit publik, mangësinë në Ligjin e pagave dhe Ligjin e shërbyesve civilë, në veçanti në fushën e rekrutimit të stafit, menaxhimin e pasurisë, menaxhimin e stafit, raportimin e të hyrave, krijimi i obligimeve financiare, e të tjera.

Ekzistimi i një numri të madh të institucioneve dhe agjencive të pavarura, që janë të vogla në aspektin financiar, personeli i pasurive dhe shërbimi financiar, e ku këto shërbime mund të kryhen si shërbime të përbashkëta. Kjo mund të arrihet duke shpenzuar fondet publike në mënyrë më ekonomike dhe më efektive.

Përdorimi i aplikacioneve të ndryshme softuerike ka ndikuar që të mos kemi informata të plota të regjistrimit të pasurisë publike.

Një shqetësim që konsideroj se duhet të jetë edhe për deputetët, edhe të pozitës edhe të opozitës, është mosimplementimi i rekomandimeve të dhëna nga auditorët e brendshëm nga menaxhmenti mbetet një ndër sfidat kryesore.

U tha këtu se funksionin e auditimit të brendshëm gjatë vitit 2015 nuk e kanë zbatuar shumë organizata buxhetore, që janë me rëndësi të veçantë, siç është Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale, Paneli Zgjedhor për Ankesa e Parashtresa, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbyesit Civilë të Kosovës, Zyra e Rregullatorit të Ujit dhe Mbeturinave, Autoritetet e Aviacionit Civil, Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës, Autoriteti Rregullativ i Komunikimit Elektronik e Postar, Zyra e Rregullatorit të Energjisë, Komisioni për Ndihmë Juridike, Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Komuna e Mamushës, e Zubin Potokut, e Zveçanit, Komuna e Hanit të Elezit, Komuna e Klllokotit dhe Komuna e Parteshit.

Ne kemi disa komuna që realisht, dhe fatkeqësisht nuk kanë hiq auditor të brendshëm apo nuk kanë krijuar as komitetet. Unë konsideroj se duhet të rritet niveli i përgjegjësisë edhe në nivel lokal e në nivel të Qeverisë qendrore me qëllim që të kemi një kontroll më të mirë të parasë publike dhe të menaxhimit të interesave publike.

Është edhe një sfidë e cila do të na përcjellë edhe vitin e ardhshëm, e që unë konsideroj se moszbatimi i vendimeve nga institucionet, në këtë rast të nivelit edhe qendror, të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbyesit Civilë, është e papranueshme edhe për ligjet, sepse është vepër penale.

Konsideroj se qeveria, në këtë rast ministri, të shqyrtojë dhe të komunikohet edhe në nivelin e Qeverisë, sepse këto vendime nuk kemi nevojë t'i kemi në gjykata, por duhet ta respektojmë këshillin si organ të pavarur dhe e kemi obligim ligjor ta respektojmë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Hasani, Bulliqi dhe... Po duket se s'do të kemi kuorum.

Meqë s'kemi kuorum, do të vazhdojmë me pikën tjetër.

15. Shqyrtimi i raportit të Fondit të Kursimeve Pensionale për vitin 2015

Komisioni Funkcional për Buxhet e Financa e ka shqyrtuar raportin vjetor të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për vitin 2015 dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Ftoj kryetarin e Komisionit për Buxhet, zotin Naser Osmani, të marrë fjalën. Nuk është këtu. Kush e merr fjalën në vend të tij, për ta arsyetuar raportin me rekomandime. Fjalën e ka zonja Gaxherri.

BESA GAXHERRI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë!

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar raportin vjetor të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për vitin 2015.

Raporti vjetor i Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për vitin 2015 është dorëzuar në Kuvend në pajtim me Ligjin për fondet pensionale të Kosovës.

Raporti përmban të dhëna për financimin dhe shpenzimet e fondit, duke përfshirë edhe aktivitetet, investimet, kontributet dhe pensionimet.

Pjesë e raportit vjetor është edhe raporti i Auditorit të Pavarur dhe pasqyra financiare për vitin 2015.

Fondi aktivitetet e veta i realizon përmes financimit nga taksat menaxhuese, të miratuar nga Kuvendi, i cili në vitin 2015 është miratuar në vlerë prej 0.485%, prej të cilës 0.40% për shpenzimet investuese dhe 0,085% për shpenzimet operacionale.

Fondi investon shumicën e mjeteve përmes fondeve të hapura investuese, të cilat menaxhohen nga kompanitë e specializuara apo aset menaxher, që operojnë në tregjet globale financiare.

Mjetet në menaxhim të fondit deri në vitin 2015 ishin 1.229.000.000. Ndërkaq, vetëm në vitin e kaluar mjetet u rritën për 141,6 milionë euro, apo 13% krahasuar me periudhën paraprake.

Nga mjetet totale në menaxhim 1 miliard e 84,7 milionë, euro apo 94,3% janë të investuara në tregjet financiare globale, ndërsa 95,6 milionë euro janë të investuara brenda tregut të Kosovës, apo 5,7%, prej të cilave 89,6 milionë euro janë të investuara në fletobligacionet e Qeverisë së Kosovës nga 54,7 milionë euro sa ishin të investuara në vitin 2014.

6 milionë euro të afatizuara në bankat komerciale në vend, ndërsa 50.9 milionë euro të mjeteve ishin të depozituara në Bankën Qendrore të Kosovës si të paimvestuara.

Nga mjetet e investuara, Fondi në vitin 2015 ka shënuar kthim bruto të investimeve prej 29.6 milionë euro. Ndërkaq, pas zbritjes së tarifave, kthim neto i mjeteve të investuara është 23.7 milionë euro.

Kthimi bruto i investimeve prej themelimit e deri në fund të vitit 2015 ka shkuar në 240 milionë euro.

Ajo që është për t'u vlerësuar pozitive, është diversifikimi gjeografik i investimeve të mjeteve dhe në institucione apo instrumente financiare të vendeve me rejting apo siguri më të madhe të kthimit të fitimit, gjë që ka ndikuar edhe në ruajtjen, respektivisht kthimin pozitiv të mjeteve të investuara, përkundër asaj se ka pasur kriza apo luhajtje financiare në tregjet globale.

Sa i përket kontribuuesve, në fund të vitit 2015 numri i llogarimbajtësve ishte 507 963, ndërsa kontribuues aktivë 297 466. Kontributet e arkëtuara gjatë vitit 2015 kanë qenë 137,5 milionë euro, që shënuan rritje për 6,8% krahasuar me vitin paraprak. Gjatë vitit janë pensionuar 4.438 persona, të cilët kanë tërhequr 19.3 milionë euro.

Me qëllim të përmirësimit të funksionimit të Fondit dhe organizatave të saj, mbrojtjen sa më të mirë të investimeve të kontribuuesve, por edhe dinamizmin e investimeve, me qëllim synimit të performancës më të mirë në operim dhe menaxhim të mjeteve, Fondi paparaqitur disa rekomandime për nevojën e ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit aktual për Fondet Pensionale të Kosovës, të cilat janë vlerësuar pozitive edhe nga komisioni dhe do të trajtohen me kujdes me rastin e shqyrtimit të ndryshimeve dhe plotësimeve të Ligjit pas procedimit në Kuvend.

Siç theksuam më lart, Fondi aktivitetet e tij i zhvillon në bazë të tarifave vjetore që i miraton Kuvendi. Të hyrat e përgjithshme të gjeneruara nga Fondi në vitin 2015 ishin prej 5 933 771 euro, nga të cilat prej 5,8 milionë euro kanë ardhur nga tarifat kurse të ardhurat jotarifore janë rreth 270 000 euro.

Shpenzimet e përgjithshme kanë qenë 5 725 256 euro, prej tyre shpenzime për investime kanë qenë 4 442 773 euro, që lidhen me kostot e investimit të mjeteve pensionale në tregjet globale dhe brenda vendit. Ndërkaq shpenzimet operationale kanë qenë 1.282.483 euro.

Lidhur me menaxhimin e shpenzimeve nga raporti i Auditorit të Pavarur kemi vlerësuar pozitiv, gjë që jep një siguri më të madhe në menaxhimin e shpenzimeve të mjeteve.

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar raportin vjetor të Fondit të Kursimeve Pensionale për vitin 2015 dhe ka vlerësuar se mjetet e Fondit janë investuar në pajtim me dispozitat e Ligjit për Fondin Pensional të Kosovës dhe me qëllim të rritjes së fitimit në investim vetëm të interes të pjesëmarrësve dhe të shfrytëzuesve.

Gjatë investimeve janë marrë parasysh siguria e Fondit Pensional, shumëllojshmëria e investimit, fitimi maksimal në përputhje me sigurinë e Fondit Pensional dhe mirëmbajtja e likuiditetit adekuat, gjë që tregon edhe performanca pozitive në kthimin e mjeteve të investuara.

Si rrjedhojë, raporti vjetor i Fondit i përmbush kushtet ligjore për raportim dhe komisioni njëzëri i ka rekomanduar Kuvendit që ta miratojë këtë raport. Faleminderit për vëmendje!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk është paraqitur askush të flasë. Zonja Murtezi, a doni të flisni? Flet në emër të Grupit!

LABINOTË DEMI-MURTEZI: Faleminderit për fjalën, nënkryetar i Kuvendit!

Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së dhe bashkëpunëtorët e koalicionit, e mbështesim dhe vlerësojmë lart raportin vjetor të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për vitin 2015 dhe meqë duhet të miratohet me votë, ftojme që deputetët ta përkrahin dhe ta miratojnë këtë raport pune. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka tjerë të paraqitur për fjalë. Tash, do të ishte mirë t'i votojmë këto dy raporte sa ka kuorum?

Së pari, po e votojmë pikën e pesëmbëdhjetë të rendit të ditës, që është:

15. Shqyrtimi i raportit vjetor të Qeverisë së Republikës së Kosovës për funksionimin e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm të Financave Publike në Sektorin Publik të Kosovës për vitin 2015

Lus deputetët dhe regjinë të bëhen gati për votim. Votojmë tash!

65 deputetë kanë votuar, 55 janë për, 9 kundër dhe 1 abstenim.

Pika e gjashtëmbëdhjetë e rendit të ditës ishte:

16. Shqyrtimi i raportit të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për vitin 2015

Lus regjinë dhe deputetët të bëhen gati për votim. Votojmë tash! Faleminderit!

Me 53 vota për, 8 kundër dhe 1 abstenim, miratohet.

Tash meqenëse jemi në votim, e kemi propozimin e Grupit Parlamentar për zëvendësimin e anëtarëve të komisioneve parlamentare. Besoj se kalon shpejt.

Grupi Parlamentar i PDK-së ka propozuar zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare, si në vijim:

- Deputeti Elmi Reçica propozohet për kryetar të Komisionit të Punëve të Jashtme, në vend të ish-deputetit Enver Hoxhaj,
- Deputetja Luljeta Veselaj-Gutaj propozohet anëtare e Komisionit për Punë të Jashtme,

- Deputeti Fatmir Xhelili propozohet anëtar në Komisionin për Integritet Evropian në vend të deputetes Luljeta Veselaj-Gutaj,
- Deputeti Adem Grabovci zëvendësohet në Komisionin për Buxhet e Financa nga deputeti Shukri Buja.

Besoj se është vendim i partisë dhe është në rregull, miratohen.

Kalojmë në pikën e shtatëmbëdhjetë të rendit të ditës:

17. Shqyrtimi i Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për mbrojtjen nga dhuna familjare

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione ka bërë mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për mbrojtjen nga dhuna familjare dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin me rekomandime.

Raportuesja e Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, deputetja Mexhide Mjaku-Topalli, e merr fjalën për arsyetimin e raportit me rekomandime.

MEXHIDE MJAKU-TOPALLI: I nderuar kryesues,

I nderuar kryetar,

Të nderuar kolegë deputetë!

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, në bazë të nenit 73 të Rregullores së Kuvendit ka bërë mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për mbrojtje nga dhuna në familje.

Komisioni në mbledhjen e mbajtur më 30.6.2016 vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë rekomandim.

I rekomandohet Kuvendit që ta miratojë raportin për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për mbrojtje nga dhuna në familje, me rekomandimet si në vijim:

1. Të ndryshohet dhe të plotësohet Ligji Nr. 03/L-182 për mbrojtje nga dhuna në familje.
2. Qeveria e Republikës së Kosovës të krijojë një fond emergjent për strehimoret ekzistuese për këtë vit, deri sa të krijojë një linjë të rregullt buxhetore për shërbimet për viktimat e dhunës në familje, duke i përfshirë këtu të gjitha fazat e trajtimit.
3. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal të arrijë memorandum bashkëpunimi me komuna në të cilat gjenden strehimoret në minimum për pagesën e shërbimeve komunale të strehimore.
4. Këshilli Gjyqësor i Kosovës të caktojë gjyqtarë të veçantë, të cilët do të bëjnë trajtimin e rasteve të dhunës në familje.

5. Ministria e Drejtësisë, në Bashkëpunim me Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe me Këshillin Prokurorial të Kosovës, të përgatisë trajnime adekuate me qëllim të profesionalizimit të vazhdueshëm të gjyqtarëve dhe prokurorëve lidhur me këtë çështje.

6. Qeveria e Republikës së Kosovës në afatin sa më të shkurtër të miratojë strategjinë për mbrojtje nga dhuna në familje për vitin 2016-2020, në kuadër të së cilës do të parashihej krijimi i një databaze unike për rastet e dhunës në familje nga institucionet kompetente.

7. Ministria e Punëve të Brendshme të sigurojë linjë të veçantë telefonike për raportim të dhunës në familje, në pajtim me nenin 24, paragrafi, 3 pika 1 të Ligjit Nr. 03/L-182 për mbrojtje nga dhuna në familje, si dhe të organizojë fushata sensibilizuese për promovimin e kësaj linje telefonike.

8. Në qendra për punë sociale dhe në stacione policore të hapen dhoma të veçanta për kontaktim.

9. Qendrat për punë sociale të mundësojnë përdorimin e veturave për punëtorët socialë, të cilët merren me trajtimin e rasteve të dhunës në familje, dhe

10. Ministria përgjegjëse të zbatojë dispozitat e Ligjit për shërbimin civil të Kosovës si dhe dispozitat e Ligjit për pagat e nëpunësve civilë për pagesat për punë jashtë orarit për punëtorët socialë.

Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së fjalën e ka zonja Kajtazi.

LIRIJE KAJTAZI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë!

Sot kemi një raport të sjellë nga monitorimi i Ligjit për mbrojtje nga dhuna në familje, të cilin e ka bërë Komisioni për të Drejtat e Njeriut dhe Lidhja Demokratike e Kosovës e ka shqyrtuar kujdesshëm si një problem i cili preokupon mjaft atë dhe shoqërinë në tërësi.

Ne si komision monitorimin e kemi filluar nga prezenca apo raportimi i koordinatorit nacional për mbrojtje nga dhuna në familje, pastaj edhe udhëheqësi i Zyrës për mbrojtje të viktimave pranë Zyrës së Kryeprokurorit, e po ashtu kujdesshëm një ditë më parë kemi pasur edhe raportin e Institucionit të Avokatit të Popullit dhe të gjithë këta mekanizma flasin për një shtim të rritjes së dhunës. A kemi vetëdijesim për raportim, apo kemi shtim të dhunës, kjo është çështje komplekse për t'u deklaruar, e megjithatë ajo që mbetet dhe dominion te ne është shqetësimi për një rritje të shifrave të tilla.

Njohja, diagnostikimi, vlerësimi, raportimi dhe gjykimi është kompleks, prandaj edhe në këtë drejtim inkorporon një zinxhirë të tërë të institucioneve dhe, siç u tha edhe nga kolegja, nga rekomandimet del se koordinimi në mes këtyre institucioneve është jashtëzakonisht i nevojshëm dhe, siç e kemi vërejtur, edhe shifrat nganjëherë nuk përputhen nga institucioni në institucion dhe jodomosdoshmërisht duhet të shkojë ndoshta në secilin raportim, nga se mund të jetë institucion i

caktuar ai i cili ndihmon në ndaljen e dhunës dhe të mos ecë tutje, por megjithatë është parë se është tepër e nevojshme të koordinohet nga rasti i kryerjes së dhunës e deri te ajo që quhet riintegrim i viktimës dhe që është tepër e nevojshme, por ka edhe një kosto mjaft të lartë.

Nëse shohim edhe këtë se sa është kostoja për ta bërë integrimin e viktimave me investimin tonë si shoqëri për të parandaluar dhunën, shohim e është tepër e nevojshme të fokusohemi si shoqëri në këtë drejtim në mënyrë që të mos vijmë deri te çështjet e tilla, nga se janë shifra që s'krahahen.

Krejt kjo flet për një kontekst social në marrëdhëniet familje - shoqëri, aksesit në shërbime dhe mundësia, motivimi dhe përballja me jetën dhe mundësitë që ne si institucione krijojmë nga ajo që quhet pushtet, të cilin dikush e abuzon qoftë si pushtet ekonomik apo forma të tjera të dominimit, të cilën ne e shprehim në shoqëri.

Është shumë me rëndësi të merren të gjitha masat në përmirësimin e perceptimit të shoqërisë ndaj këtij fenomeni dhe besoj se ne tashmë jemi të njoftuar se është duke u përgatitur strategjia e re nacionale dhe Plani i veprimit 2016-2026 për dhjetë vjetët e ardhshme dhe strategjia e tillë patjetër duhet t'i ketë të gjitha këto pika në mënyrë që të inkorporojë të gjithë atë që quhet shqetësim i përgjithshëm dhe t'i definojë qartë detyrat e secilit institucion.

Për fat të keq, duhet filluar nga perceptimi mbi dhunën në familje dhe nga të gjitha anketat e prezantuara shihet se më shumë se 1/3 e popullatës shohin si të nevojshme dhunën në familje, bile një pjesë tyre e sheh shumë të panevojshme përzierjen e institucioneve në këtë drejtim, duke e trajtuar si problem të brendshëm familjar apo edhe si nevojë që ndoshta në relacione prind - fëmijë, si një nevojë për ta qetësuar një fëmijë ndoshta një shuplakë është shumë e nevojshme, apo të mos themi edhe në raportet bashkëshortore.

Për fat të keq, kjo pranohet nga anëtarët e familjes, e nganjëherë edhe nga të dy palët.

Prandaj, është tepër me rëndësi të shihet modeli i sjelljes sonë në familje e shoqëri, çka e ka shkaktuar atë model, çka vazhdon ta mbajë, sa ka arritur kuadri ligjor që ta ndërrojë këtë model të sjelljes, apo se ne insistojmë për zbatimin e këtyre ligjeve, por është tejet me rëndësi, sepse i kemi rastet e viktimave të dhunës në familje, të cilat nuk po përmendi me emër dhe kjo flet se në cilin drejtim është adresuar dhuna më shumë dhe është gjithëherë me e prekur gjinia femërore, por pa i anashkaluar kategoritë e tjera. Janë problemet me të moshuarit, me fëmijë dhe relacione të tjera në familje dhe më gjerë.

Mirëpo, e rëndësishme është se përveç kuadrit ligjor të ketë njohuri, siç u tha edhe në një nga rekomandimet këtu, në ngritjen e kapaciteteve të profesionistëve që kishte të bëjë me pjesën e gjyqësisë, edhe zbatimin e konventave ndërkombëtare, nga se nganjëherë qëllimisht mbyllen sytë dhe nuk kërkohet ky standard i aplikimit të konventave, të cilat e pasurojnë kuadrin tonë ligjor, i cili merret me këtë çështje.

Prandaj, LDK-ja vazhdon të insistoje në këto gjëra, të cilat do të kishin ofruar një shoqëri më të shëndoshë dhe, si të tillë, një anëtar të shoqërisë shumë më produktiv dhe një jetë më të mirë.

Rekomandimet janë ato të cilat janë në funksion të kësaj çështjeje dhe do t'i votojmë. Faleminderit për vëmendjen!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së e ka fjalën zonja Salihe Mustafa.

SALIHE MUSTAFA: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë!

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka shqyrtuar raportin e Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione për monitorimin e zbatimit të Ligjit kundër dhunës në familje.

Kemi analizuar të dhjetë rekomandimet e dhëna nga Komisioni Funkcional dhe në vazhdimësi do të përkujdesemi që këto rekomandime të zbatohen nga institucionet përgjegjëse.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Baftija, në emër të “Vetëvendosjes”, e ka fjalën.

BESA BAFTIJA: Faleminderit, kryesues!

Edhe Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” e ka shqyrtuar këtë raport dhe do të votojë për këto rekomandime, të dala nga ky komision, me shpresë se këto rekomandime do të zbatohen, e jo të mbesin në sirtar, sikurse që kanë mbetur shumë rekomandime të dala nga ky Kuvend. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Njomza Emini e ka fjalën.

NJOMZA EMINI: Faleminderit, kryesues!

I nderuar ministër,

Kolegë deputetë!

Ndonëse problemet me të cilat po përballemi janë të shumta dhe situata nuk është ideale, megjithatë kërkoj pak vëmendje kur bie fjala te gratë, që vazhdimisht dhunohen nga persona të ndryshëm.

E gjykoj të nevojshme iniciativën për ngritjen e strehimoreve si dhe rishikimin e ligjit në raport me dhunën familjare, më specifikisht, dhunës ndaj grave bashkëshortore.

Rastet flagrante të vrasjeve të nënave në sy të fëmijëve nuk mund të mbeten vetëm histori të shkruara nëpër gazeta e të dënuara nëpër rrjetet sociale.

Shteti ynë, ndër tjera, duhet të reagojë në çështjen e sigurisë së grave duke forcuar ligjin që ndalon dhe e ndëshkon dhunën, si dhe të mendohet për funksionalitetin e strehimoreve si dhe linjave të këshillimit për gratë që vuajnë nga dhuna.

Deri më tani nuk është vepruar për viktimat, të cilat unë nuk dua t'i përmend, por të gjithë i dimë se nuk janë të arrestuar vrasësit për këto zonja që veç janë të ndjera dhe për të cilat edhe familjarët presin përgjigjen nga institucionet tona.

Po ashtu unë kërkoj nga Qeveria e Republikës së Kosovës që të mbështesë financiarisht viktimat e dhunës ndaj familjeve, sepse qendrat apo edhe këshillimoret nuk mund të funksionojnë vetëm përmes projekteve që aplikojnë, por duhet të jetë një buxhet që në momentin kur ushtrohet dhunë ndaj grave, ato të kenë një shtëpi të sigurt, sepse ka raste që familjarët nuk i pranojnë dhe ato duhet të jenë të siguruar.

Edhe një herë kërkoj një përkushtim, sepse tani ka ardhur momenti i fundit që të ndahet buxheti për strehimore dhe nëse nuk i mbështesim ne, atëherë do të ketë raste edhe më shumë të dhunës ndaj grave në familje. Faleminderit për vëmendjen!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Salih Morina e ka fjalën.

SALIH MORINA: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Mendoj se komisioni e ka bërë një punë të mirë dhe ka nxjerrë shumë rekomandime, me të cilat edhe presim implementimin.

Si e gjetur në kuadër të këtij raporti është edhe pika 12 kur është theksuar se Ministria e Arsimit, në bazë të Udhëzimit Administrativ Nr. 34/2014 në funksionimin e shërbimit pedagogjiko-psikologjik në shkolla e ka paraparë pranimin e psikologut dhe pedagogut nëpër shkolla, duke pasur parasysh rëndësinë dhe rolin e pazëvendësueshëm.

Ne si Komision për Arsim kemi kërkuar nga ministri i Arsimit në këtë rast që ky udhëzim administrativ është shumë i nevojshëm dhe vendosja e psikologëve nëpër shkolla do të ishte shumë e nevojshme dhe njëkohësisht do të ndikonte pozitivisht sa i përket implementimit të këtij ligji.

Prandaj, kërkojmë që Ministria e Arsimit ta implementojë këtë ligj, sepse raporti pedagog në shkolla do të thotë se një pedagog e përfaqëson tri shkolla dhe mendoj se është i pamjaftueshëm. Duhet që çdo shkollë ta ketë pedagogun e vet dhe po ashtu duhet që çdo shkollë ta ketë edhe psikologun dhe kisha menduar që ndoshta do të ishte mirë të jetë njëri prej rekomandimeve, të cilat i ka hartuar ky grup punues. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.)

KRYETARI: Faleminderit! Zonja Mufera e ka fjalën, nga Grupi Parlamentar “6+”.

MUFERA ŞINIİK: Faleminderit, kryetar!

Ayni şekilde bu raporu “6+” Parlamenter Grubu da düzenli bir şekilde incelemiştir ve aynı zamanda Kosova Eğitim Bilim ve Teknoloji Bakanlığı tarafından her okulda pedagogların ve psikologların olmasını zamanından bu yana önermişiz ve bunun da takibini yapmaktayız. “6+” Parlamenter Grubunun her okulda birer pedagog ve birer psikologa ihtiyaç duyulduğunu her seferinde vurguladık gene aynı şekilde bunu bakanlıktan bekleyerek Raporu kabul ediyoruz. Teşekkür ederim.

KRYETARI: Faleminderit! Tani është në radhë votimi e raportit për monitorimin e mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit për mbrojtjen nga dhuna në familje.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Konstatohet se Kuvendi e miratoi raportin me rekomandime me 67 vota për.

Jemi në pjesën e fundit të seancës. E kemi të gjithë deputetët para veti Deklaratën e përbashkët të Kuvendit, e cila është bërë nga përfaqësuesit e grupeve parlamentare. Do të ftoj deputeten Blerta Deliu-Kodra që ta lexojë edhe një herë dhe pastaj e nxjerrim në votim për ta aprovuar.

Zonja Tërmkolli dhe zoti Hamiti, ndërkohë, e kanë kërkuar fjalën. Urdhëroni, zoti Hamiti, pastaj e merr fjalën zonja Tërmkolli.

SABRI HAMITI: Faleminderit, zoti kryetar!

Së pari, është mirë që janë marrë vesh për këto katër fraza të gjithë deputetët. Kanë mund të merren vesh pa të gjithë atë diskutim, shumë në mënyrë elegante.

E dyta, meqë kërkohej shumë elegancë, ju them se në këto katër fraza, meqë po nxjerrin lëvizhja gjuhësie, janë 10 gabime në shqip. Por, kjo s'është me rëndësi.

Është me rëndësi se unë jam në fazën e purizmit gjuhësor që unë e dëgjova me kujdes, tërë kohën, një orë i kam dëgjuar të gjithë.

Ajo që është me rëndësi, meqë është në dy gjuhë dhe na është dhënë në dy gjuhë, nuk është identik teksti dhe nuk është identik në një pikë që është shumë me rëndësi, se fraza e parë në shqip thotë që “mbrëmë është kryer mbi Kuvendin e Republikës së Kosovës”, e serbisht thotë “nad zgradom Skupštine Republike Kosova”, që është krejt tjetër send. Nuk është hiç e njëjta gjë.

Unë mendoj se është kjo e para, në shqip, e vërteta në bazë të asaj që kam dëgjuar gati një orë diskutime, por serbisht thotë e ka sulmuar shtëpia - objekti, jo Kuvendi. Sulmi i Kuvendit është tjetër. Faleminderit!

KRYETARI: Kisha lutur shefin e Grupit Parlamentar të Listës serbe ta interpretojë këtë çështje të cilën profesori e tha, pra të deklarohet se pajtohet dhe ta fusim në vend të “ndërtesës” “Kuvendi”. Kjo është. Kemi të bëjmë me atë se në vend të “ndërtesës” të jetë “Kuvendi”

SLAVKO SIMIĆ: Hvala predsedniče!

Mislim da ovde ne vitim nikakvu grešku da piše tako. Ovde na srpskom piše “nad zgradom Skupštine Republike Kosova”. Znači “izvršena je sinoć nad zgradom Skupštine”.

KRYETARI: Do të jetë vetëm të hiqet “zgrada” dhe të mbetet “skupština”. Ajo është për shkak të identitetit të dyja deklaratave.

SLAVKO SIMIĆ: Ali, ne vidim nikakov problem, neka piše samo “nad Skupštinom” i to je to.

KRYETARI: Është e njëjta, vetëm të jetë identike për shkak të përkthimit. Pra, e kryem këtë pjesë. Tani zonja Tërmkolli e ka fjalën, le të bëhet gati zoti Bajrami dhe zoti Beqa.

MELIHATE TËRMKOLLI: Faleminderit, zoti kryetar, edhe për më herët, për respektin që e treguat.

Unë mendoj që në këtë, si po i thotë Sabri Hamiti “frazë”, edhe unë po i besoj, natyrisht se është njeri i lëmit, në këtë pjesën e dytë, mendoj se nuk është çështja vetëm gjuhësore, por edhe ajo që e tha Sabriu nuk është vetëm gjuhësore, është substanciale.

Unë mendoj se duhet të shtohet një fjali, nga e cila nuk mund të ikim asnjëherë. Pas kësaj “ky është një sulm kundër shtetit të Kosovës, të interesave të qytetarëve tanë dhe kundër qëllimeve dhe vlerave politike e demokratike”.

Mendoj se duhet të shtohet kjo fjalë këtu, “që afirmojnë subjektet tona politike”.

KRYETARI: Atëherë, ne do ta kemi parasysh kur ta vëmë në votim, e konstatojmë edhe me këtë shtesë.

(Ndërhyrje)

OK, më falni! Zoti Bajrami e ka fjalën! Pastaj zoti Beqa le të bëhet gati dhe prapë profesori. Mendova ta marrësh fjalën në fund... Po, urdhëro, zoti Hamiti, e keni fjalën.

SABRI HAMITI: Veç të mos ketë keqkuptime, sepse unë u thashë “frazë”, por fraza në kuptimin sintaksor janë fraza, më shumë se një fjali, ai është kuptim sintakse, të mos merret si kuptim i keq. Sepse, në kuptimin e zakonshëm, nëse thuhet fraza, i bie që s’vlejnë gjë. Jo! Po sintaksisht janë kaq, fraza. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Bajrami!

ĆERIM BAJRAMI: Zahvaljujem se predsedniče!

Profesor Hamiti je u pravu, s obzirom da je sintaksa i interpunkcija i sve ostalo bosanskog i srpskog jezika ista.

Molim vas da me saslušate kako treba deklaracija na ovom jeziku da izgleda ispravno.

“Mi, izabrani predstavnici naroda”, ispravna je, zapeta “snažno osuđujemo kriminalni napad izvršen sinoć na Skupštinu Republike Kosova”.

Dakle, dalje “To je napad protiv “d” je malo “države”, “D” treba veliko “Države Kosova”, s obzirom da će ovo ići u medijima, “interesa naših građana i protiv ciljeva i političkih vrednosti”, stoji “što”, što je totalno neispravno... “koje afirmišu naše političke subjekte”.

“Pozivamo institucije sigurnosti da preduzmu”, a ovde stoji “da preduzimaju”, što je neispravno “sve potrebne mjere za rasvetljavanje ovog krivičnog napada, i stoji dalje “dok” ne ispravno je, “a da kriminalce izvedu pred lice pravde”. Ne može “pred pravdom”.

“Skupština Republike Kosova takode poziva sve građane zemlje da sarađuju i pomognu, a ne “pomažu” istražne i pravosudne organe za rasvetljavanje ovog kriminalnog akta. Zahvaljujem!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Beqa.

HAJDAR BEQA: Faleminderit, kryetar!

Unë do të ndalem te paragrafi 3. Më shumë teknike, por mendoj se e kompletom më mirë këtë paragraf, kur u bëjmë thirrje institucioneve të sigurisë të zëvendësohet me “u bëjmë thirrje organeve të rendit dhe të sigurisë”, sepse konsideroj që është në harmonizim edhe me Kodin Penal të Republikës së Kosovës dhe Kodin e Procedurës Penale. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit shumë! Atëherë, së shpejti, shefat e grupeve parlamentare, përkatësisht përfaqësuesit. Me cilin variacion jeni, na tregoni shpejt.

Ajo, u morëm vesh se largohet nga përkthimi i gjuhës serbe, që ishte “zgrada” e mbetet veç “skupstina”.

Pra, a pajtohem me deklaratën, të cilën e kemi në gjuhën shqipe, dhe e vëmë në votim.

Atëherë, urdhëro, zonja deputete, lexojeni dhe shkojmë në votim. Dëgjoni, në zë gjithë ditën, veç kur t’u bie në mend mos e thoni, se unë këtë e thashë hapur, e as nuk lajmëroheni, e në moment të caktuar kur do të aprovohet, e kërkoni... Urdhëroni! Zonja Tërmkolli prapë e ka kërkuar fjalën!

MELIHATE TËRMKOLLI: Është mirë të jemi pak më seriozë dhe këto fjalë dhe shprehje që po i përdorni nuk është hiq mirë, jo “le” jo “s’le”. Kjo fjali, merreni dhe e analizoni pak, është shumë esenciale, për mendimin tim. Nëse doni ta futni, pranoni, nëse jo, hiq nuk ka problem. Por, do ta shihni se është shumë esenciale, është shumë esenciale, sepse nuk është njësoj “vlerat politike” dhe “vlerat politike demokratike”. Vlera politike ka pasur edhe nazizmi, por jo vlera politike demokratike.

Jo, jo! Ju lutem, mos flisni pallavra. Më falni! Dhe, s’ka kurrgjë këtu të keqe, urdhëroni, pranoni si të doni.

KRYETARI: Faleminderit! Zonja Gaxherri, urdhëroni!

BESA GAXHERRI: Unë paraprakisht pajtohem me kolegët e mi. Këtu po e aprovojme një deklaratë dhe s’është që jemi duke e bërë namin, për duhet ta bëjmë në nivel.

Përveç vërejtjeve të kolegëve, në veçanti të zonjës Tërmkolli, unë pasusin e tretë, kur thotë “u bëjmë thirrje institucioneve të sigurisë”, do të kisha thënë të jetë “kërkojmë që institucionet e sigurisë” se ne s’ka nevojë të bëjmë thirrje, por le të jetë “ne kërkojmë nga institucionet e sigurisë të ndërmarrin masa të duhura dhe sa më parë të zbardhin këtë sulm qyqar”, e tjera, e tjera.

Domethënë, pasusi i tretë, nuk fillon “i bëjmë thirrje”, por me “kërkojmë”.

KRYETARI: Vetëm pak, për hir të korrektësisë. Janë dy propozime, duhet t'i aprovonit ose s'i aprovonit.

Është njëra: “vlera politike demokratike”, a doni ta fusim këtë a jo?

Atëherë, e çoni dorën kush është për po. Administrata, le t'i numërojë votat. Pra, të shkojmë kështu, është më demokratike.

Ka kaluar propozimi “i institucioneve politike demokratike” i zonjës Tërmkolli.

E kemi edhe një propozim konkret: “U bëjmë thirrje institucioneve të sigurisë” është i zonjës Besa Gaxherri. Pra, “kërkojmë nga organet e sigurisë”, apo “nga institucionet e sigurisë”

Pra “kërkojmë nga institucionet e sigurisë”, a jeni për që ta bëjmë edhe këtë ndryshim?

Kush është për?

Sa s'janë për?

Atëherë, edhe kjo kalon.

I nderuar zoti Simiq, i keni parasysh dy dallimet, të cilat kanë ndodhur. Ka ndodhur tek pjesa e institucioneve “të vlerave politike demokratike” dhe në paragrafin 3, në vend “i bëjmë thirrje”, të jetë “kërkojmë”.

Janë prezentë 69 deputetë. Urdhëro, zonja Blerta Deliu-Kodra, e lexoni tash deklaratën e harmonizuar.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, kryetar!

Ne përfaqësuesit e zgjedhur të popullit dënojmë fuqishëm sulmin kriminal të kryer mbrëmë mbi Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Ky është një sulm kundër shtetit të Kosovës, interesave të qytetarëve tanë dhe kundër qëllimeve dhe vlerave politike e demokratike që afirmojnë subjektet tona politike.

Kërkojmë nga institucionet e sigurisë që të ndërmarrin masa të duhura dhe sa më parë të zbardhin këtë sulm qyqar, ndërsa kriminelët të vihen para drejtësisë.

Kuvendi i Republikës së Kosovës po ashtu u bën thirrje të gjithë qytetarëve të vendit që të bashkëpunojnë dhe të ndihmojnë organet e drejtësisë në zbardhjen e këtij akti kriminal.

KRYETARI: Faleminderit! Deputetë, i zëni vendet, sepse do të votojmë në mënyrë elektronike.

Në sallë janë 69 deputetë.

Pra, lus regjinë e deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Do të thotë i kemi 68 deputetë që kanë votuar, të 68-tët janë për, prandaj konstatoj se u miratua deklarata politike.

Faleminderit dhe mirupafshim në seancën e radhës!

E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë